

Partitë Politike

Funksioni dhe Organizimi në Shoqëritë Demokratike

Wilhelm Hofmeister dhe Karsten Grabow

Kapitulli mbi Shqipërinë, nga **Afrim Krasniqi**

Përktheu:

GC&DA LLC Gjilan, Kosovo
Blerina Starova Zlatku

Redaktoi:

Afrim Krasniqi

Text © 2017 Konrad Adenauer Stiftung

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sistemet e rikthimit, apo transmetohen në çfarëdo forme dhe me asnjë mjet, elektronik, mekanik, fotokopjim, regjistrim pa pëlqimin paraprak të autorëve.

Përgjegjësia për faktet dhe opinionet e shprehura në këtë publikim bie ekskluzivisht mbi kontribuesit dhe interpretimet e tyre jo doemos reflektojnë mendimet apo politikat e botuesit.

Bordi i bibliotekës kombëtare, Singapor katalogimi i të dhënave të publikuara
Hofmeister, Wilhelm.

*Partitë politike: funksionet dhe organizimi në shoqëritë demokratike / Wilhelm
Hofmeister and Karsten Grabow. – Singapor: Konrad Adenauer Stiftung, 2011.*

ISBN:

Shtypur në shtypshkronjën West Print, Tiranë

Përmbajtja

Hyrje	4
1. PARTITË DHE SISTEMI PARTIAK	8
1.1. Çfarë është “partia politike”?	9
1.2. Kriteret për identifikimin e partive politike	10
1.3. Përse ekzistojnë partitë politike?	12
1.4. Funksionet e partive politike	14
1.5. Sistemet e partive politike	16
1.6. Tipologjia e partive politike	18
1.7. Partitë dhe ideologjitë	22
2. MENAXHIMI MODERN I PARTIVE POLITIKE	24
2.1. Organizimi dhe anëtarësimi	25
2.2. Anëtarët e një partie politike	30
2.3. Rekrutimi i anëtarëve të rinj	32
2.4. Edukimi dhe trajnimi i anëtarëve të partisë	34
2.5. Programet e partive politike	36
2.6. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm	37
2.7. Demokracia brenda-partiake	43
2.8. Konfliktet brenda-partiake dhe zgjidhjet e konflikteve	46
2.9. Kuota për gratë dhe minoritetet	47
2.10. Financimi i partive	49
3. PARTITË POLITIKE: MARRËDHËNIA E TYRE ME SHOQËRINË CIVILE DHE GRUPET E INTERESIT	54
3.1. Partitë dhe shoqëria civile	55
3.2. Partitë dhe grupet e interesit	57
4. PARTITË POLITIKE NË PARLAMENT DHE QEVERI	60
4.1. Grupet parlamentare	63
5. LIDERSHIPI POLITIK	64
5.1. Dilema të lidërsip-it politik	68
5.2. Mësimet e udhëheqësve politikë	69
6. SFIDAT E PARTIVE POLITIKE NË REGJIMET DEMOKRATIKE	72
6.1. Partitë politike dhe ndryshimet sociale	73
6.2. Kriteret për qëndrueshmëri dhe sukses të rolit të partive	78
7. KONKLUZION: NUK KA DEMOKRACI PA PARTITË POLITIKE	82
8. PARTITË POLITIKE NË SHQIPËRI	84
8.1. Zhvillimi i partive politike në Shqipëri	85
8.2. Partitë politike më të rëndësishme në Shqipëri	88
8.3. Koalicionet politike në Shqipëri	90
8.4. Ideologjitë e partive në Shqipëri	91
8.5. Demokracia brenda-partive në partitë shqiptare	93
8.6. Organizimi i brendshëm i partive shqiptare	95
8.7. Perspektiva të ardhshme e partive shqiptare	95
9. SHËNIME DHE REFERENCA	97

“Padyshim se të gjitha mendimet dhe veprimet e qenies njerëzore shpeshherë lidhen me kohën dhe ndryshimin e gjendjes. Por, nëse formojmë parti politike, e cila është e bazuar vetëm në kërkesat dhe qëllimet afatshkurtra, atëherë një parti e tillë do të jetë sterile dhe jetëshkurtër. Veçanërisht partitë, ose, thënë më mirë, sidomos partitë politike, në qoftë se dëshirojnë të jetojnë gjatë, duhet të ndërtohen në thellësi. Ato duhet të bazohen në vlera të përjetshme”.

Konrad Adenauer

Hyrje

Shqipëria e sotme është një republikë parlamentare e bazuar në sistemin e zgjedhjeve të lira dhe periodike.

Ajo është anëtare në NATO dhe ka statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Evropian. Progresi i saj është i brishtë, por krahasuar me 27 vite më parë, - është i jashtëzakonshëm. Ajo ishte një shoqëri e mbyllur, pa liri mendimi dhe organizimi, hermetike ndaj ideve të reja, refuzuese e perëndimit, lindjes, tregut të lirë, konkurrencës dhe besimit në Zot. Në vitet e ndryshimit qytetarët kishin pritshmëri të larta për cilësinë dhe shpejtësinë e jetësimit të sistemit demokratik. Pas më shumë se dy dekadash e gjysmë këto pritshmëri janë ulur dhe shumica e qytetarëve janë të ndërgjegjshëm se jetësimi i demokracisë funksionale kërkon kohë, energji, punë, sakrificë, angazhim dhe vullnet të palëkundur nga dy aktorët kryesorë: qytetarët votues dhe politikanët vendimmarrës.

Qytetarët dhe përfaqësuesit e tyre janë në marrëveshje besimi periodik, marrëdhënia e tyre i jep jetë pluralizmit dhe sistemit konkurrues, idetë dhe aktet e tyre formësojnë procesin politik, sinkronia pozitive midis tyre përcakton ritmin e reformave dhe të progresit. Për më shumë se katër dekada kjo marrëdhënie ishte vertikale dhe nominale: PPSH dhe udhëheqësi i saj u identifikuan me shtetin, kombin, popullin, Kushtetutën, ligjin dhe shoqërinë. Sfidë për të krijuar një marrëdhënie të re horizontale dhe të besimit tëndërsjellë, është e mbetet sfida kryesore e demokracisë së re në Shqipëri.

Në tërë këtë proces kanë rol thelbësor partitë politike, si institucione përfaqësuese, mobilizuese, ndërmjetësuese dhe formuese në vullnetin politik. Shqipëria sot numëron një numër të madh të partive politike, rreth 66 prej tyre konkurrojnë rregullisht në proceset e fundit zgjedhore, rreth 5-8 parti përfaqësohen rregullisht në parlament, sistemi është i hapur dhe asnjëra prej dy partive të mëdha politike nuk arrin të sigurojë e vetme mazhorancën qeverisëse. Shqipëria ka nene specifike në Kushtetutë mbi partitë politike, rolin dhe kornizën bazë të funksionimit të tyre. Shqipëria ka gjithashtu një legjislacion në pasurim të vazhdueshëm mbi partitë politike, aktivitetin, organizimin dhe funksionimin e tyre. Ekzistenca e tyre është tregues pozitiv, por ende i pamjaftueshëm për të krijuar sistem të besueshëm e funksional përfaqësimi. Ekzistojnë një numër çështjesh dhe elementësh ku mund dhe duhet të bëhen përmirësime, siç ekzistojnë një numër përgjegjësish, të cilat duhen marrë e përmbushur me seriozitet të lartë nga partitë, por edhe qytetarët si burim i legjitimitetit dhe i fuqisë së tyre përfaqësuese.

Një nga çështjet me më rëndësi mbetet pasurimi i kulturës politike. Një shoqëri e aftë të marrë vendime cilësore mbi politikën, i paraprin dhe mbetet garanci e fortë për institucione demokratike përfaqësimi. Një shoqëri apatike dhe pa interes për standarde më të larta të kulturës politike përbën ushqimin kryesor për një sistem partiak jo përfaqësues, klientelist dhe rrezik për vetë shoqërinë dhe sistemin politik e qeverisës. Një prej elementëve thelbësorë të formësimit demokratik është edhe njohja e thelluar e koncepteve, modeleve, praktikave dhe përvojave më të mira mbi rolin e partive politike në një shoqëri, organizimin dhe funksionin e tyre në shoqëri dhe sistemin politik. Partitë i japin jetë e shpirt procesit politik. Veprimtaria politike bashkon idetë dhe vlerat me bartësit e tyre, - organizatat politike, partitë dhe grupimet civile. Ajo kërkon institucione funksionale e përfaqësuese që bëjnë lidhjen midis ideve dhe aktorëve politikë e civilë, si dhe kërkon qytetarë aktivë, të cilët përmes pjesëmarrjes i japin jetë e legjitimitet institucioneve.

Legjislacioni shqiptar përcakton qartësisht se partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Ato duhet të kenë organizim demokratik, duhet të jenë transparente, dhe e realizojnë funksionin e tyre përmes ndikimit në jetën politike, përmes pjesëmarrjes dhe përfaqësimit. A janë de facto të tilla? A ka aspekte që duhen përmirësuar apo ndryshuar? A janë demokracia përfaqësuese dhe partitë politike koncepte statike që arrihen dhe mbeten të pandryshueshme, apo janë koncepte në ndryshim e evoluim? A është demokracia një sistem shterues apo një sistem në sprovë të vazhdueshme, në konkurrencë e në test aftësie e bilanci? Këto dhe të tjera pyetje të kësaj natyre na tregojnë rëndësinë e madhe që merr debati publik e profesional mbi partitë politike, mbi demokracinë, mbi përfaqësimin dhe mbi rolin e aktorëve brenda e jashtë tyre.

Shqipëria politike përgjatë një shekulli ka kaluar në sisteme pa parti politike, sistemin e partisë-shtet dhe sisteme pluraliste konkurruese. Nuk ka dyshim se shumica absolute e qytetarëve kanë bindjen e plotë se sistemi pluralist, me gjithë defektet, eksperimentet dhe problematikat, mbetet bilanci më i suksesshëm shekullor në cilësinë e shtetit, të jetës qytetare dhe përfaqësimit të tyre. Ekzistenca e partive politike përbën parakusht për jetësimin e lirisë dhe përfaqësimit, për procesin e "politikës" si art, shkencë, mision e shërbim. Vetëm partitë kanë potencialin të krijojnë lidhje të fortë, solide dhe të verifikueshme midis qytetarëve e sistemit politik, kryesisht vetëm ato kanë forcën e mobilizimit të qytetarëve, tëpërçimit të ideve, debatit dhe pritshmërive publike në vendimmarrje. Modeli

klasik i demokracisëdirekt merr vlerë në aspekte të veçanta të ushtrimit të demokracisë, sistemi klasik përmes partive politike konkurruese luan rol gjenerues, të vazhdueshëm e të qëndrueshëm për çdoçështje dhe nëçdo kohë.

Kur partitë nuk e kryejnë si duhet funksionin e tyre ato kthehen në pengesë, por sistemi konkurrues i detyron ato të reformohen, të përmirësohen dhe të synojnë të mbeten pasqyrë e nivelit dhe kërkesave të shoqërisë në evoluim. Ky është një proces i vazhdueshëm, kompleks dhe që kërkon investim cilësor në kulturën politike e demokratike si tek partitë ashtu edhe tek qytetarët. Shqipëria e tranzicionit është një dëshmi e këtij realiteti dhe kësaj nevoje.

Për të kontribuar në këtë drejtim Fondacioni Konrad Adenauer, zyra për Shqipërinë paraqitet përpara publikut shqiptar me botimin e parë të kësaj natyre mbi partitë politike. Ky botim profesional ofron një kapitull specifik mbi historinë, aktualitetin dhe problematikën e sistemit partiak dhe partive politike në Shqipëri. Por më shumë se kaq, ky botim ofron praktikat më të mira të funksionit, organizimit dhe rolit të partive politike në një shoqëri demokratike. Ai ju vjen në ndihmë brezave të rinj, studentëve, aspirantëve të politikës, medias, publikut të interesuar, por mbi të gjitha edhe vetë anëtarëve të partive politike për tu njohur më mirë dhe më në detaje më standardet më të larta të politikës si mision e shërbim në një shoqëri moderne të hapur e konkurruese.

Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) gjithmonë dhe kudo në botë, është angazhuar për promovimin e të drejtave të njeriut, të demokracisë, të vlerave dhe zbatimin e tyre, si dhe për promovimin e institucioneve të sundimit të së drejtës dhe të principeve të ekonomisë sociale të tregut. Për momentin Fondacioni Konrad Adenauer mbështet më shumë se 200 projekte në mbi 120 vende në mbarë botën, me përfaqësues zyrtarë nga Gjermania dhe të punësuar lokal, të cilët ndihmojnë në drejtim të realizimit të masave të edukimit politik dhe këshillimit. Zyra e KAS në Shqipëri është vendosur në vitin 2009.

Fondacioni Konrad Adenauer
Republika e Shqipërisë

1.

Partitë dhe Sistemet Partiake

1. Partitë dhe Sistemet Partiake

1. 1. Çfarë është “partia politike”?

Partitë politike janë forma të veçanta të organizimit shoqëror. Ato nuk duhet të ngatërrohen me shoqatat, federatat dhe klubet shoqërore. Një përkufizim shumë i njohur mbi partitë politike vjen nga studiuesi amerikan i shkencave politike Antony Downs, i cili shkruan: *“Një parti politike është një ekip i burrave dhe grave që kërkojnë të ushtrojnë funksionin qeverisës përmes fitimit të pushtetit në një palë zgjedhje të rregullta”* 1. Studiuesi italian Giovanni Sartori, i cili ligjëroi për një kohë të gjatë në Universitetin Kolumbia në New York dhe është një nga hulumtuesit më të njohur në botë mbi partitë politike, e ka përkufizuar një parti si: *“një grupim politik i identifikuar me një emërtim zyrtar, që konkurren në zgjedhje, dhe që përmes tyre ka aftësi e kapacitet të vendos kandidatë për postet publike.”*

Edhe këto përcaktime tregojnë disa dallime në të kuptuarit e partive politike: ato theksojnë pjesëmarrjen në zgjedhje dhe interesin që të fitojnë mandate dhe poste publike si elementë thelbësorë karakteristik për partitë politike. Partitë politike duhet patjetër të plotësojnë disa kritere të tjera, të cilat mund të përmbliken si në vijim.



1. 2. Kriteret për identifikimin e partive politike

- Një parti përpiqet për të influencuar në formimin e opinionit politik dhe synon të ketë një ndikim të përgjithshëm politik. Influenca aktive e opinion-bërjes synohet për një periudhë të gjatë kohore ashtu edhe në një hapësirë më të gjerë dhe se nuk duhet të përqendrohet në nivel lokal apo në një çështje të vetme.
- Një parti është një bashkim i qytetarëve bazuar në anëtarësim individual dhe duhet të ketë numrin minimal të anëtarëve që përcaktohet nga ligji, në mënyrë që të mbetet i qartë serioziteti i synimeve të veta dhe mundësia e suksesit.
- Një parti duhet të demonstrojë dëshirën, që në mënyrë të vazhdueshme të marrë pjesë në përfaqësimin politik të qytetarëve përmes zgjedhjeve. Kjo cilësi e dallon partinë nga sindikatat, organizatat jo qeveritare dhe iniciativat e tjera, të cilat nuk duan të marrin ndonjë përgjegjësi politike për sektorët më të mëdhenj, por tentojnë të kenë një ndikim specifik, si dhe atyre që nuk marrin pjesë në zgjedhje.
- Një parti duhet të jetë organizatë e pavarur dhe permanente: ajo nuk duhet të formohet vetëm për një palë zgjedhje dhe pastaj të pushojë së vepruari.
- Një parti duhet të synojë dhe të ketë vullnet të paraqitet publikisht.
- Një parti, jo domosdoshmërisht duhet të fitojë vende në parlament, por ajo duhet të përmbushë të gjitha kriteret e tjera.

Në këtë mënyrë partitë mund të kuptohen si bashkime permanente të qytetarëve që bazohen në anëtarësim të lirë dhe një program, të cilat mundohen, që nëpërmjet zgjedhjeve me ekipin e tyre të udhëheqësve, të zënë pozicione kryesore politike në qeverisjen e vendit, në mënyrë që të materializojnë premtimet e tyre për zgjidhjen e problemeve thelbësore. Koncepti i zgjedhjeve nënkupton garën e së paku dy partive.

Partitë, jo vetëm që mundohen të marrin pjesë në formimin e opinionit politik, por ato aspirojnë gjithashtu të marrin pjesë në përfaqësimin e qytetarëve në parlament. Ky qëllim nënkupton se partitë marrin pjesë në zgjedhje. Kontributi politik i një partie si dhe “pesha” e vet politike është e lidhur ngushtë me zgjedhjet. Vullneti i votuesve ka rëndësi të konsiderueshme për partitë.

Tipike për partitë është “shpirti luftarak” - gatishmëria e tyre për veprim politik dhe përballje politike, si dhe aspirata e tyre për të udhëhequr dhe ruajtur pushtetin qeverisës. Kjo konkurrencë mes partive është një instrument për të fituar pushtet politik dhe i gjithë organizimi i një partie është në fund të fundit në funksion të këtij qëllimi. Vetëm ato parti, që marrin pjesë në mënyrë të suksesshme në garën elektorale mund të fitojnë poste për përfaqësim politik. Ky qëllim është edhe stimuli kryesor për të marrë pjesë në aktivitetet e partisë dhe që rrit interesin tek një parti sidomos pasi ajo arrin të bëhet pjesë e qeverisë.

Edhe roli i opozitës, ndonëse më pak atraktiv sesa partia në qeveri, ofron elemente interesante për pjesëmarrje aktive. Partitë politike janë gjithnjë qendra/vende për debate dhe diskutime rreth reformave politike dhe ndryshimeve politike. Të interesuarit për politikë në të shumtën e kohës e gjejnë një parti që reflekton perceptimet e tyre, parti në opozitë apo në pushtet. Partitë në opozitë ushtrojnë një funksion të rëndësishëm në sistemet demokratike si një “watchdog” të politikave qeveritare dhe si një alternativë politike për të ardhmen. Opozita mund të konsiderohet si e tmerrshme, por është esenciale për funksionimin e demokracisë.

Në dallim nga grupet e interesit, një parti pritet të mbajë qëndrim në të gjitha çështjet e rëndësishme për qeverinë. Një pritshmëri është që partitë të propozojnë pikëpamjet e tyre në politikat e jashtme, ekonomike, politika sociale, në politikat e rinisë dhe politikat civile etj. Në mënyrë që t’i përmbushë këto kërkesa, secila parti duhet të ketë një program, në të cilin shprehet pozicioni i saj themelor në fusha të ndryshme. Për më tepër, pritet që një parti të ketë një organizim të qëndrueshëm.

1. 3. Përse ekzistojnë partitë?

Brenda çdo shoqërie ekzistojnë opinione, nevoja, pritje dhe pikëpamje të ndryshme për problemet ditore, gjithashtu ekzistojnë pyetje të "mëdha" mbi organizimin e shoqërisë, normat dhe procedurat. Diçka e ngjashme si vullneti i përbashkët i qytetarëve ose e mira e përbashkët e paracaktuar nuk ekziston. E kundërta, në çdo shoqëri ka interesa rivale, të cilat shpesh përplasen fort me njëra tjetrën. Në mënyrë që të ndërmjetësojmë konfliktin paqësisht, formimi i pikëpamjeve politike duhet të ndodh në një proces të hapur të debatit midis opinioneve të ndryshme. Për këtë, është i nevojshëm një minimum i bindjes së përbashkët. Ky është sensi i vërtetë i demokracisë. Ai bazohet në parimin se secili qytetar ka të drejtë të përfaqësojë opinionin dhe bindjen e vet në një garë paqësore të pikëpamjeve.

Ky supozim i konfliktit të interesave brenda çdo shoqërie, të cilat në parim janë legjitime, quhet pluralizëm apo "teoria e konkurrencës" e demokracisë. Sipas kësaj teorie, formimi i opinionit politik në një shoqëri pluraliste arrihet nëpërmes një procesi të hapur të konkurrimit mes interesave heterogjene. Për shkak të larmisë së opinioneve dhe konflikteve sociale nuk ka zgjidhje të përsosur për problemet. Vendimet duhet të merren në bazë të pëlqimit dhe aprovimit të shumicës së qytetarëve. Megjithatë, kjo nuk mund jetë "tirani e shumicës", që fyen rregullat demokratike dhe shkel të drejtat e patjetërsueshme të njeriut. Edhe vendimet e shumicës mund të kenë mangësi ose të jenë të padrejta. Prandaj, mbrojtja e veçantë dhe e garantuar me kushtetutë e minorancës politike nga njëra anë, si dhe nga ana tjetër pranimi i votimit ose i humbjes në zgjedhje nga pala humbëse, me kusht që zgjedhjet të jenë (kryesisht) të lira dhe të ndershme, - janë elemente themelore të këtij koncepti të demokracisë.

Brenda kontekstit të menaxhimit në mënyrë demokratike të konfliktit të interesave, partitë politike përfaqësojnë interesa të veçanta. Vetëm atëherë kur interesat e kundërta politike shprehen publikisht dhe partitë u njohin gjithashtu partive të tjera të drejtën për të përfaqësuar interesa të veçanta, dhe kur palët pajtohen me principet e lojës politike, si për shembull, nëse ato bien parimisht dakord për një kushtetutë demokratike, - atëherë në një shoqëri është e mundur që të zgjidhen konfliktet dhe të arrihen kompromise të arsyeshme politike.

Natyrisht, gjatë këtij procesi liritë dhe të drejtat e partive duhet të garantohen. Kjo do të thotë se krijimi i partive politike duhet të jetë i lirë nga kufizimet politike. Megjithatë, mund të ketë disa kufizime sa i përket krijimit të partive, të cilat në mënyrë të hapur kundërshtojnë kushtetutën

demokratike të një shteti. Në parim qytetarët duhet të kenë të drejtë të krijojnë një parti, të jenë pjesë e një partie, dhe të shprehin mendimet e tyre lirshëm në to. Liria e partive gjithashtu përfshin edhe nocionin, se askush nuk mund të detyrohet me forcë të aderojë në një parti të veçantë apo të qëndrojë në parti në kundërshtim me dëshirën e tij, - siç ka pasur dhe që mund të ketë raste në disa vende. Afirmimi i diversitetit të partive është standard i njohjes së demokracisë pluraliste.

Ky koncept konkurrues i demokracisë qëndron përballë vizionit të homogjenitetit, i cili nënkupton unitetin e vullnetit të qytetarëve. Filozofi politik francez Jean-Jacques Rousseau (1712–78) është krijuar i këtij vizioni, i cili në teori e mohon legjitimitetin e konflikteve dhe e përcakton demokracinë si një identitet i qeverisë dhe i qytetarëve. Ky koncept nuk e pranon tërësisht pluralizmin e partive. Ato nuk konsiderohen si legjitime pasi në mënyrë të pashmangshme manipulojnë “vullnetin e përbashkët” me sjelljen e tyre të veçantë. Kjo teori nuk toleron devijimet nga e mira e përbashkët e imponuar dhe e detyrueshme. Megjithatë, është e qartë se ky koncept është karakteristikë e shteteve totalitare, ku ndalohet shumëllojshmëria e partive dhe ku “vullneti i përbashkët” përcaktohet vetëm nga një elitë e vogël sunduese. Si pasojë, shtetet totalitare janë identifikuar me teorinë e Rousseau. Duhet të theksohet se edhe vetë Rousseau nuk ka mundur të sqarojë sesi ky “mirëkuptim” do të zbulohet dhe të vendoset. Duhet të kemi parasysh se shoqëritë moderne karakterizohen nga shumëllojshmëria e interesave dhe e pikëpamjeve. Ato kanë nevojë për partitë politike, si institucione me rol të rëndësishëm në përfaqësimin e kësaj shumëllojshmërie të interesave brenda sistemit politik.



1. 4. **Funksionet e partive politike**

Për të marrë pjesë me sukses në proceset politike dhe për të kontribuar në konsolidimin e demokracisë, partitë politike duhet të tregojnë disa kapacitete të tyre. Në shkencat politike këto kapacitete quhen “funsione”.

Funksionet e partive politike²

- Ato artikulojnë dhe bashkojnë interesa sociale: Partitë shprehin pritjet e publikut dhe kërkesat e grupimeve sociale në sistemin politik (= funksioni i opinion-bërjes politike).
- Ato rekrutojnë staf politik dhe përgatisin gjeneratat e ardhshme të politikanëve: Ato përzgjedhin personat dhe i prezantojnë ata si kandidatë në zgjedhje (= funksioni i përzgjedhjes).
- Ato hartojnë programe politike: Partitë integrojnë interesa të ndryshme brenda projektit të përgjithshëm politik dhe i transformojnë në programe politike, për të cilat ato bëjnë fushata elektorale për të marrë pëlqimin dhe mbështetjen e shumicës (= funksioni i integritit të interesave).
- Ato promovojnë mobilizimin politik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve: Partitë krijojnë një lidhje midis qytetarëve dhe sistemit politik; ato mundësojnë pjesëmarrjen politike të individëve dhe të grupimeve me perspektivën e suksesit. (= funksioni i mobilitetit dhe pjesëmarrjes).
- Ato organizojnë qeverinë. Ato marrin pjesë në zgjedhje në mënyrë që të fitojnë dhe të kryejnë ndryshime politike. Normalisht, në demokracitë e bazuara në konkurrencën e partive politike, një pjesë e mirë e autoriteteve qeveritare dalin nga partitë politike (= funksioni i ushtrimit të pushtetit politik).
- Ato kontribuojnë në legjitimitetin e sistemit politik: në themelimin e lidhjeve mes qytetarëve, grupimeve sociale dhe sistemit politik, partitë kontribuojnë në mbështetjen e vendosjes së sistemit politik në vetëdijen e qytetarëve dhe në aktorët e tjerë shoqërorë (= funksioni i legjitimitetit).

Në shoqëritë moderne, procesi i formimit të opinionit politik është një proces shumëformësh: mediat masive, organizatat shoqërore, shoqatat, iniciativat e qytetarëve, komunitetet fetare dhe format moderne të komunikimit elektronik nëpërmjet internetit, sms, facebook-it, twitter-it dhe mjeteve të tjera virtuale, ushtrojnë ndikim të madh në opinionet politike dhe në vendimet politike. Megjithatë, partitë politike janë ende ndërmjetësuesit kryesorë në funksionin për të mbledhur opinionet e publikut dhe t'i përfaqësojë ato në procesin e vendimmarrjes politike. Në fund të këtij procesi partitë marrin vendimet politike përmes përfaqësuesve të tyre në parlament dhe në qeveri. Duke ndjekur aktivitetin e partive, perceptimin dhe vlerësimin e argumenteve të tyre gjatë debateve politike, qytetarët mund të orientojnë politikisht veten e tyre në raport me partitë. Gjithashtu, përmes angazhimit në parti politike, çdo qytetar mund të ushtrojë ndikim në procesin e vendimmarrjes politike.

Krahas kandidatëve në zgjedhje, programi politik është oferta e një partie, të cilin ajo ua ofron votuesve. Programet e partisë përmbushin në veçanti, dy funksione kryesore: nga njëra anë, ato duhet të artikulojnë interesat e popullatës (partitë si "organe" të qytetarëve) dhe nga ana tjetër, ato orientojnë dhe ndikojnë në opinionet e qytetarëve (partitë si "formuese" të vullnetit publik; shih gjithashtu pikën 4.2). Në lidhje me programin e partisë, votuesit mund të vlerësojnë nëse një parti ka ndjeshmërinë e mjaftueshme për problemet shoqërore dhe nëse ajo është e aftë të ofrojë propozime të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve dhe të sfidave.

Partitë opozitare kanë funksionin e oponencës/kritikës ndaj qeverisë, të kontrollojnë atë dhe të paraqesin alternativa konstruktive. Ky funksion ka një rëndësi të madhe për një demokraci, sepse pa opozitë, qeveria shfaq tendencën e kalimit në vetëkënaqësi dhe arrogancë, si dhe dështon në kërkimin e alternativave.

Me përmbushjen e këtyre funksioneve, partitë politike ofrojnë shërbime të rëndësishme për një shoqëri të organizuar në mënyrë demokratike. Cilësia e "ofertës", - pra mënyra sesi ato përputhen me funksionet e tyre, - ndikon në mënyrë vendimtare në reputacionin dhe potencialin e partive politike.

1. 5. Sistemet e partive politike

Të gjitha partitë në një vend formojnë sistemin e partive politike. Sistemi partiak reflekton strukturën e marrëdhënieve midis partive të veçanta në raport me njëra - tjetrën.

Përbërja e një sistemi partiak ndikohet kryesisht nga dy faktorë. Në njërin anë është struktura e konflikteve sociale dhe interesave. Konfliktet klasike janë, p.sh., ato midis kapitalit dhe punëtorit ose midis partive laike dhe atyre me orientim fetar. Në anën tjetër partitë dhe ligjet zgjedhore gjithashtu ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm në konfigurimin e sistemeve partiake në varësi sa liberal, sa i lirë dhe sa kufizues ka qenë krijimi i partive të reja politike, si dhe nëse sistemi zgjedhor lehtëson ose jo përfaqësimin e një numri më të madh të partive në parlament.

Në periudhën para - demokratike ekzistenca e një partie nxiti në fund të fundit krijimin e një partie tjetër. Gjatë gjithë historisë, sistemet partiake në parim janë zhvilluar përgjatë linjave sociale dhe/apo ideologjike të konflikteve.


Sistemet partiake mund të klasifikohen nga kritere të ndryshme. Më i njohuri lidhet me numrin e partive që konkurrojnë për pushtet, faktor që shërben si kriter për përshkrimin e një sistemi partiak. Bazuar në këtë kriter ne mund të dallojmë sistemin njëpartiak, dypartiak dhe shumëpartiak. Në sistemin "një partiak" dominon vetëm një parti dhe praktikisht nuk ka konkurrencë politike midis partive. Sistemi "një partiak", siç është shprehur më lart, është në kontradiktë me veten e vet, pasi një "parti" duhet të jetë vetëm pjesë e një grupi më të gjerë. Sistemet njëpartiake për shkak të kësaj cilësie karakterizohen nga shtypja e konkurrencës politike dhe të lirive demokratike. Sistemi "dypartiak" nënkupton se dy parti dominojnë konkurrencën politike, kurse partitë e tjera më të vogla luajnë një rol dytësor. Në një "sistem shumëpartiak", më shumë sesa dy parti kanë ndikim në garën politike.³

Ekzistenca e një sistemi dypartiak ose shumëpartiak varet nga disa faktorë të ndryshëm: tradita politike, zhvillimi i institucioneve politike, rrethanat socio-ekonomike, rëndësia e ndarjeve rajonale/lokale, si dhe kushtet etnike ose fetare. Specifikat e ligjit zgjedhor mund të kenë ndikim të caktuar, por jo vendimtar, në formësimin e sistemit partiak. Sistemet mazhoritare të votimit (i pari fiton) e favorizojnë më shumë krijimin e një sistemi dypartiak (ose një sistem të përbërë nga vetëm disa parti dominuese), ndërsa sistemi

proporcional i votimit është më shumë në favor të një sistemi shumëpartiak. Megjithatë, nuk ka lidhje qartësisht të dukshme midis sistemeve elektorale dhe partiake.

Sistemi i qeverisjes ndikon në zhvillimin e partive dhe sistemeve partiake për aq kohë sa një sistem parlamentar ofron më shumë ndikim për partitë politike, pasi qeveria del direkt nga parlamenti i dominuar nga partitë. Në një sistem presidencial është kreu i qeverisë, presidenti, i cili zgjidhet direkt nga qytetarët dhe në këtë mënyrë, legjitimiteti i tij nuk është i bazuar kryesisht tek parlamenti. Përveç kësaj, ai kryesisht ushtron, krahas parlamentit, edhe funksionet legjislative dhe të tjera, dhe ai gjithashtu ka të drejtën e vetos për vendimet e Parlamentit apo edhe autoritetin për të shpërndarë parlamentin. Pra, nga ky këndvështrim, në sistemet presidenciale partitë luajnë një rol minor. Nga ana tjetër, në sistemet presidenciale ndarja e pushteteve është zakonisht më e dukshme për shkak se partitë nuk janë të lidhura aq ngushtë me qeverinë.

Në sistemet parlamentare identifikimi dhe sidomos marrëdhëniet midis qeverisë dhe partisë / partive në pushtet janë shumë më të forta. Gjithashtu edhe në një sistem presidencial, Presidenti ka nevojë për aprovim të akteve të tij nga parlamenti dhe një mazhorancë parlamentare. Pavarësia relative nga qeveria, të cilën partitë gëzojnë në një sistem presidencial, ka rëndësi të konsiderueshme. Numri i partive të përfaqësuara në parlament është i ndikuar vetëm pjesërisht nga sistemi i qeverisjes. Kjo është më tepër një çështje e ndarjeve shoqërore, eventualisht edhe e ndarjeve etnike dhe ndarjeve të tjera në një vend, nga struktura e konflikteve dhe e interesave, si dhe nga sistemi zgjedhor.



1. 6. Tipologjia e partive politike

Ashtu si sistemet partiake edhe vetë partitë politike mund të dallohen në bazë të kriterëve të caktuara. Tipologji të tilla ndihmojnë për të klasifikuar shumëllojshmërinë e fenomeneve sociale, në mënyrë që t'i kuptojmë ato më mirë. Për të identifikuar partitë mund të marrim në konsideratë tiparet karakteristike në mënyrë që të vihen në dukje elementët e përbashkët dhe dallimet midis partive të ndryshme.

Partitë mund të klasifikohen në përputhje me një numër kriteresh të ndryshme: sipas nivelit të tyre të organizimit, sipas objektivave të tyre socio-politike, sipas klasave shoqërore që ato duan t'i përfaqësojnë ose sipas raportit të tyre ndaj sistemit politik. Disa parti mund të klasifikohen edhe në bazë të emrave të tyre, të cilat shpesh shprehin objektiva të veçanta socio-politike me të cilat partitë duan të identifikohen. Sipas emërimit të tyre, partitë tregojnë sesi ato duan të perceptohen dhe kjo nënkupton, sesi ato dëshirojnë të klasifikohen. Kjo konfirmon se klasifikimi apo ndërtimi i tipologjive nuk është një ushtrim i thjeshtë akademik, por pjesë e garës politike të partive.

Tipologjitë fillimisht u shfaqën në funksion të sistemeve shumëpartiake në Evropë, por gjithashtu mund të aplikohen në rajone të tjera. Disa prej tipologjive paraqiten në vijim të tekstit.

1. 6. 1. Dallimi i partive nga shkalla e organizimit të tyre

Partitë elektorale: partitë e tilla nuk i kushtojnë rëndësi rritjes së anëtarësisë, por janë veçanërisht aktive në periudhën zgjedhore. Lidhja e votuesve me një parti të tillë është zakonisht e dobët.

Partitë me anëtarësi: partitë e tilla kërkojnë anëtarësi të gjerë, mundësisht në të gjitha zonat e vendit. Tradicionalisht, janë partitë popullore dhe partitë laburiste ato që përpiqen të kenë një strukturë të mirë-organizuar të partisë dhe një anëtarësi të gjerë ("partitë politike masive"). Kjo formë organizimi mundëson financimin e partisë me kuotat e anëtarësimit.

Për sa i përket kritereve socio-politike, të cilat janë aspiratë e partive politike, mund të bëjmë dallimin midis atyre partive që kërkojnë ndryshime sociale apo politike në kuadër të rendit ekzistues demokratik si dhe partive, të cilat përqipen për ndryshime me anë të mjeteve radikale, ekstremiste apo revolucionare. Grupi i parë përbëhet nga partitë konservative, liberale, kristiandemokratike, socialdemokrate, pjesërisht socialiste dhe gjithashtu nga partitë që identifikojnë veten me besim fetar ose fe, për sa kohë ato nuk kanë pikëpamje ekstremiste. Në grupin e dytë bëjnë pjesë kryesisht partitë ekstreme të majta e të djathta, dhe midis tyre, përveç të tjerash edhe partitë komuniste.

Partitë konservative: parti të tilla duan ta ruajnë rendin e “miratuar” ose ta rivendosin atë; ato janë skeptike për ndryshime dhe risi, për shembull në lidhje me perceptimet dhe rolin e familjes apo modelet alternative të jetës (p.sh. martesave në të njëjtën gjini). Ato gjithashtu nuk e duan transferimin e sovranitetit kombëtar në institucionet ndërkombëtare, por janë të ndërgjegjshme se idetë, vlerat dhe parimet tradicionale nuk mund të vijojnë pa pasur reforma të moderuara.

Partitë liberale: parti të tilla i përkrahin të drejtat e lirisë individuale dhe theksojnë karakterin demokratik të kushtetutës. Tradicionalisht, ato janë parti anti-fetare dhe kryesisht angazhohen për një ekonomi të tregut të lirë.

Partitë social demokratike: parti të tilla kryesisht shfaqen si lidhje e ngushta me lëvizjet e punëtorëve, dhe konceptet e tyre politike bazohen në barazinë shoqërore të njerëzve; ato i njohin të drejtën shtetit që të ketë një rol të fortë rregullues në ekonomi dhe në shoqëri.



Partitë socialiste: parti të tilla shfaqen në një lidhje të ngushtë me pjesë të lëvizjeve të punëtorëve, por ato përfaqësojnë një qasje më radikale për arritjen e barazisë sociale; heqja e pronësisë private për mjetet e prodhimit dhe një ekonomi e udhëhequr nga shteti janë ndër objektivat kryesore të këtyre partive.

Partitë fetare: janë forma të veçanta të partive që karakterizohen nisur nga objektivat e tyre socio-politike. Në mbarë botën një numër i madh i partive janë të bazuara ca më shumë e ca më pak në bindje fetare. Këto janë parti kristiane apo kristian-demokrate, islamike dhe hindu, të cilat i bazojnë programet e tyre në vlerat dhe standardet e fesë apo besimit të tyre.

Kjo mund të çojë në dallime të konsiderueshme në programet politike dhe objektivat politike të partive të tilla, në varësi se si parti të veçanta e konsiderojnë qëndrimin e fesë së tyre përkatëse në raport me të drejtat individuale të njeriut, liritë individuale ose demokracinë politike. Partitë evropiane kristian-demokrate, p.sh. angazhohen për liritë individuale, solidaritetin social dhe drejtësinë, vetë-përgjegjësinë qytetare dhe për një rol të kujdesshëm të shtetit nën monitorimin e aktorëve ekonomikë dhe shoqërorë.

Partitë e ekstremit të djathtë: partitë e tilla predikojnë ideologji nacionaliste, që shpesh përzihen me një ideologji të paqartë etnike dhe perceptime të mundshme raciste.

Partitë komuniste: parti të tilla propagandojnë diktaturën e proletariatit dhe besojnë në paracaktimin e historisë.

Partitë popullore: parti të tilla tentojnë të marrin në konsideratë interesat dhe nevojat e sa më shumë grupeve shoqërore që është e mundur dhe në këtë mënyrë, tentojnë të integrojnë brenda tyre sa më shumë qytetarë që mundën nga grupe me origjinë të ndryshme sociale brenda nivelit të partisë së tyre, si dhe të bashkojnë aspiratat e ndryshme politike e sociale në programin e tyre partiak.

Partitë të interesit të veçantë: partitë e tilla ndihen përgjegjëse dhe përfaqësuese për interesat e një grupi shumë të veçantë (një grupi social, fetar apo rajonal) dhe nuk pretendojnë të jenë njëlloj përfaqësuese për të gjitha pjesët e tjera të popullsisë.

Partitë në përputhje me sistemin: parti të tilla pranojnë sistemin politik, në të cilin ato punojnë dhe dëshirojnë që ta stabilizojnë rendin politik ose ta përmirësojnë atë gradualisht me anë të reformave.

Partitë që kundërshtojnë sistemin politik: parti të tilla nuk i pranojnë parimet bazë të sistemit të tyre politik dhe përpiqen për ndryshim të sistemit, kryesisht me propozime programore agresive.

Partitë politike rrallë përputhen plotësisht me ndonjërin nga këto klasifikime. Ka tranzicion të ndryshëm dhe forma të përziera. Një parti me anëtarësi të madhe apo masive, për shembull, mund të jetë një “parti interesi” nëse përfaqëson vetëm interesat e caktuara të një grupi shoqëror apo sektori (klasës punëtore p.sh). Për më tepër, mund të ketë edhe kritere të tjera: p.sh. parti qeveritare dhe opozitare, parti rajonale, parti protestuese, etj. Megjithatë klasifikimi na mundëson identifikimin e tipareve kryesore të një partie, gjë që është një element i rëndësishëm në procesin e konkurrencës politike.

Ideologjitë dhe pikëpamjet e veçanta mbi botën kanë domethënie të madhe për partitë politike. Ideologjitë janë vizione gjithëpërfshirëse mbi shoqëritë dhe zhvillimet shoqërore, të cilat përmbajnë shpjegime, vlera dhe qëllime për zhvillimet e kaluara, të tashme dhe të ardhshme. Ideologjitë frymëzojnë dhe justifikojnë veprimet politike dhe shoqërore. Ato janë një element thelbësor për orientimet politike. Termi “ideologji” është përdorur dhe ende përdoret kryesisht nga majtistët, partitë komuniste dhe socialiste, për t’i karakterizuar pikëpamjet e tyre mbi botën dhe pozicionet politike. Megjithatë, edhe rrjedha të tjera të mendimit politik mund të emërohen si “ideologji”, si p.sh liberalizmi, konservatorizmi, nacionalizmi apo fashizmi.

Nganjëherë, ka komente lidhur me “jo-ideologjizimin” e supozuar të politikës. Kjo i referohet faktit se në ditët e sotme shumë parti i theksojnë rrënjët e tyre ideologjike më pak se sjelljet e tyre pragmatike në lidhje me sfidat politike dhe shoqërore. Megjithatë konceptet e sipërpërmendura, e bëjnë të qartë se ideologjitë kanë ende një rëndësi të konsiderueshme për identifikimin e pikëpamjeve mbi botën dhe mbi pozicionet politike. Ne asnjëherë nuk e kemi arritur “fundin e ideologjive”, siç është deklaruar nga politologu amerikan Francis Fukuyama në fund të Luftës së Ftohtë. Ai supozoi se demokracia liberale do të zbatohet përfundimisht përkundër të gjitha formave të tjera të qeverisjes, dhe në këtë mënyrë, të gjitha debateve ideologjike mund tu vijë fundi.⁴

Ata që janë apo që do të angazhohen politikisht duhet t’i njohin përplasjet e ndryshme ideologjike. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për përcaktimin e pozicionit politik për vetvete, por edhe për vlerësimin e pikëpamjeve tjera politike dhe në rast nevojë, edhe për luftimin e tyre.

PASQYRA E IDEOLOGJIVE

Ideologjitë e bazuara tek individi

Liberalizmi, Neo-Liberalizmi, Konservatizmi, Demokracia Kristiane

Ideologjitë e bazuara tek barazia

Socializmi, Komunizmi, Marksizmi, Leninizmi, Stalinizmi, Maoizmi, Trotskizmi, Euro-komunizmi, Neo-Marksizmi, Anarkia

Ideologjitë e bazuara tek kolektiviteti

Socializmi, Socializmi Demokratik, Demokracia Sociale, Komunizmi, Marksizmi, Socializmi Kombëtar

Ideologjitë e bazuara tek përkatësinë etnike apo kombësia

Nacionalizmi, Sionizmi, Rajonalizmi, Pan- Arabizmi, Pan- Sllavizmi, Fashizmi, Neo-Fashizmi, Fashizmi Klerik, Socializmi Kombëtar, Racizmi, Imperializmi, Kolonializmi, Darwinizmi Social

Ideologjitë e bazuara tek tradita

Konservatizmi, Demokracia Kristiane, Neo-Konservatizmi

Ideologjitë e bazuara tek feja

Socializmi Kristian, Demokracia Kristiane, Fashizmi Klerik, Islamizmi, Neo-Hindizmi, Sionizmi

Ideologjitë Totalitare

Socializmi Kombëtar, Komunizmi, Islamizmi, Marksizmi – Leninizmi, Stalinizmi, Maoizmi, Pol-Potizmi

Ideologji të tjera

Politikat e gjelbra, Ekologjizmi, Internacionalizmi, Kozmopolitanizmi, Pacifizmi, Republikanizmi, Humanizmi, Feminizmi

2.

**Menaxhimi
Modern i
Partive Politike**

2. 1. Organizimi dhe anëtarësimi

Që të jetë e suksesshme në garën politike dhe të ketë një efekt mbi formimin e mendimit politik, një parti ka nevojë për organizim të përhershëm. Për sa i përket ndërtimit institucional të një partie ekzistojnë modele të ndryshme. Organizim në baza individuale, që nënkupton anëtarësimin e drejtpërdrejtë të individëve, shumë parti janë të organizuara në formë të decentralizuar në bazë të degëve lokale, sipas zonave të banuara apo rretheve, ose në nivel komunal. Nivelet më të larta të organizimit partiak zakonisht ndjekin strukturën e shtetit.

2. 1. 1. Nivelet e organizimit të partisë

- Komitete në bazë ose nivel komune (sipas zonës së banimit ose komunës)
- Organizimi në nivel qarku ose në një zonë zgjedhore
- Organizimi rajonal (sipas shtetit federal, rajonit ose departamentit)
- Organizimi në nivel kombëtar

Figure 1: Niveli i organizimit të partive politike

Organet partitë	Anëtarët ose kuvendi i delegatëve (Konventa e partisë)	Bordi i drejtorëve	Gjykata partiake
Organizimi kombëtar	Konventa e kombëtare e partisë	Bordi kombëtar Bordi ekzekutiv	Gjykata partiake kombëtare
Organizimi rajonal	Konventa rajonale e partisë	Këshilli rajonal	Gjykata partiake rajonale
Organizimi në rrethi / qarku / në zona elektorale	Kuvendi i delegatëve të rrethit	Këshilli i rrethit	Gjykata partiake e rrethit
Organizimi lokal / komitetet lokale	Kuvendi i anëtarëve	Këshilli lokal	

Organizimi lokal i partisë ka rëndësi të veçantë për një parti të qëndrueshme dhe aktive. Përmes tij anëtarët mund të jenë aktiv politikisht në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë ata kanë një lidhje më të thellë me partinë e tyre dhe politikën në përgjithësi. Organizatat lokale partiake duhet që të kryejnë takime të rregullta të anëtarësisë dhe të mbështesin, promovojnë dhe integrojnë anëtarët (e rinj). Ata duhet të ftohen në takimet e partisë, të qarkut dhe aktivitete shoqërore, si dhe në diskutimet mbi çështjet politike lokale dhe iniciativat lokale, për shembull, për rindërtimin e banimeve, ndërtimin apo shtrimin e rrugëve, shkollave, zonave për biznes etj.

Organizatrat lokale dhe rajonale të partisë duhet që të kenë konventën e tyre politike, të zgjedhin kandidatët për zgjedhje lokale dhe rajonale, të koordinojnë aktivitetet e partisë në nivel lokal dhe rajonal, dhe të mbajnë kontakte me organizatat jo-partiake në nivel lokal (të tilla si komunitetet fetare, shoqatat qytetare dhe profesionale, etj). Ato duhet gjithashtu të përcaktojnë pozicionet e tyre lokale partiake (në përputhje me programin kryesor të partisë) dhe programeve të qeverisjes lokale. Së fundi, anëtarët në nivel lokal gjithashtu kryejnë fushata për zgjedhjet lokale, rajonale ose kombëtare.

Strukturat organizative lokale të partive kontribuojnë në politikat konkrete (partiake), të cilat janë më afër qytetarëve. Pa to, anëtarët dhe simpatizuesit e një partie do të kishin perceptim të dobët mbi pikëpamjet politike të liderëve dhe udhëheqësve të tyre. Strukturat organizative lokale janë “baza e demokracisë partiake”. Politikanët drejtues nga nivelet e larta të


partisë, parlamentit apo të qeverisë duhet që të marrin pjesë rregullisht në takimet e organizuara me partinë në degët lokale.

Struktura e partisë në nivel qarku apo në nivel shtetëror duhet që normalisht të përputhet me strukturën e nivelit të lartë të partisë. Përveç kësaj, në nivel qarku ose kombëtar, zakonisht ekziston një Këshill Ekzekutiv i zgjedhur, i cili përbëhet nga kryetari, një apo dy zëvendës kryetarë, si dhe një arkëtar (shih figurën 2 dhe figurën 3). Nivelet e tjera të larta të organizimit të partisë (rajonale apo kombëtare) zakonisht përbëhen nga sekretari ose sekretari i përgjithshëm, të zgjedhur nga konventa përkatëse e partisë. Për shkak se drejtuesit e partisë, ndonjëherë si rezultat i aktiviteteve të tyre të shumta si deputetë, ministra, kryeministra ose presidentë, veprojnë më shumë në rolin e "pjesës së shquar" të partisë, sekretari i përgjithshëm është "pjesë ekzekutive e partisë". Sekretari i përgjithshëm udhëheq selinë e partisë në punët e përditshme të partisë, është përgjegjës për komunikimet e partisë brenda dhe jashtë saj, dhe gjithashtu është përgjegjës për promovimin e diskutimeve rreth programit dhe organizimin e fushatave elektorale.

Ligjet/statuset e partive demokratike kërkojnë që pozicionet e bordit në të gjitha nivelet partiake, të zgjidhen nga votime të rregullta brenda-partiake që mbahen në konventat apo kongreset e partisë. Ky rregull i referohet konventave partiake në nivel dege, qarku ose shteti si dhe në nivel kombëtar. Nëse është e mundur, në rastin e organizimit lokal, të gjithë anëtarët e partisë duhet që të marrin pjesë në zgjedhjen e drejtuesve lokalë. Në nivelet e tjera të partisë, mund të ekzistojë një sistem zgjedhor për përfaqësuesit. Formalisht Konventat e partisë janë organet më të larta vendimmarrëse në çdo nivel të organizimit partiak. Anëtarët e bordit / kryesisë në mesin e tyre zgjedhin Bordin Ekzekutiv, Kryesinë, e cila është qendra kryesore e organizimit partiak në nivel rajonal, lokal dhe në nivel kombëtar. Në mënyrë të ngjashme, kandidatët për emërimet politike dhe postet publike (për shembull, kandidatët për deputet, për kryetar të bashkisë, guvernatorët, kryeministrat e rajoneve apo shteteve federale, kryeministri/ja ose presidenti/ja e shtetit) duhet që të legjitimohen përmes zgjedhjeve të brendshme partiake.

Partitë duhet të udhëhiqen në mënyrë profesionale dhe duhet të jenë të pajisura me teknika moderne të komunikimit. Selia qendrore e partisë është në krye të organizimit të partisë. Selia e partisë është baza ku vendoset kryetari i partisë si dhe këshilli i partisë. Ajo duhet që të ketë disa departamente "teknike" që përqendrohen në çështje të caktuara për të përgatitur qëndrimet e partisë mbi temat aktuale të debateve politike dhe t'u sigurojë informacione e argumente anëtarëve të partisë dhe

përfaqësuesve të saj. Përveç kësaj, selia e partisë duhet të kujdeset për komunikimin dhe prezantimin publik të partisë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, selia e partisë duhet të organizojë dhe realizojë fushatat elektorale.



Komunikimi dhe koordinimi i selisë së partisë me kryesinë e grupit parlamentar dhe parlamentarët është i një rëndësie të veçantë. Në perceptimin e publikut të gjerë, ata janë përfaqësuesit më të rëndësishëm të një partie dhe kanë ndikim vendimtar në imazhin e saj publik. Në shumicën e vendeve degët lokale të partisë gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm. Prandaj, komunikimi i përhershëm dhe i rrjedhshëm si dhe koordinimi me grupet lokale, merr po të njëjtën rëndësi për një parti politike.

Skema e strukturës dhe e organeve të partisë

Nuk ka ndonjë model unik thelbësor për organizimin e partive politike. Në disa shtete ka ligje që përcaktojnë kriteret kryesore që partitë duhet të përmbushin. Kryesisht, në veçanti këto i referohen respektimit të procedurave demokratike brenda partisë për zgjedhjen e udhëheqësve të partisë dhe disa elementeve të përgjithshëm organizativ. Për sa i përket përbërjes dhe kompetencave të partisë, ekziston një numër i madh i modeleve organizative.

Organizimi hierarkik i një partie politike shpesh korrespondon me ndarjen administrative të një vendi, d.m.th, partitë kanë struktura lokale, organizata në komunë / bashki ose në qark, kanë struktura në provinca ose në rajone, dhe në fund kanë edhe një strukturë e organizim kombëtar. Një numër partish politike bëjnë edhe ndarje në funksionet midis strukturave, të ngjashme me ndarjen e tre pushteteve brenda shtetit: gjykata brenda partisë për zgjidhjen e konflikteve (gjyqësori), e cila mund të ndëshkojë dhe madje përjashtojë anëtarët e partisë për veprimet që mund të dëmtojnë imazhin publik të saj; Asamblenë e Përgjithshme ose Konventat e Partisë (Legjislatura); dhe Ekzekutivin e Partisë (Ekzekutivi). Disa parti kanë gjithashtu një bord të zgjeruar me përfaqësues të organizatave të tjera në varësi të partisë. Struktura e partive është paraqitur në diagramin e mësipërm. Figura 1 ilustron ndarjen komplekse gjeografike dhe funksionale të një partie politike (duke mos përfshirë organizatat ndër-partiake dhe grupet e veçanta partiake). Gjithashtu ajo tregon rrugët legjitime të vendimmarrjes brenda partisë, në përputhje me parimin e legjitimitetit demokratik të liderëve nga pozitrat më të ulëta deri tek ato më të larta në hierarkinë partiake.

Përveç komiteteve/asambleve të përgjithshme, shumë prej partive politike kanë struktura të tjera, komisione, komitete teknike dhe grupe pune me detyra specifike, për shembull, për diskutimin e çështjeve programore (politikat ekonomike, politikat e brendshme, politikat e jashtme etj), si dhe për pjesëmarrjen e grupeve specifike (të rinj, gra, sindikata, politikanë lokalë, qytetarë të klasës së mesme, ndërmarrës, të moshuar etj). Këto struktura luajnë një funksion të rëndësishëm në jetën e brendshme të partive dhe imazhin e tyre të jashtëm. Nga njëra anë ato plotësojnë dhe rregullojnë parimin rajonal të anëtarësimit dhe të integritetit të anëtarëve sipas interesave të tyre të veçanta, kualifikimeve të tyre profesionale

apo statusit të tyre social. Brenda partisë, këto struktura luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe formimin e mendimit politik. Nga ana tjetër, strukturat/komitetet japin kontribut të rëndësishëm për të kontaktuar me grupe shoqërore të ndryshme, proces, përmes të cilit u tregohet atyre se shqetësimet e tyre janë marrë parasysh dhe janë të përfaqësuara nga partia.

Në disa vende partitë kanë promovuar krijimin e organizatave të reja në mjedisin e tyre, të cilat kryejnë aktivitete politike edukative për anëtarët e partisë dhe qytetarët e interesuar, si dhe mbështesin zhvillimin e programit dhe koncepteve të partisë përmes hulumtimit dhe konsulencës. Institucionet më të njohura të këtij lloji janë fondacionet politike në Gjermani.

2. 2. Anëtarët e një partie politike

Anëtarët janë pjesa themelore e çdo partie dhe përbëjnë lidhjen më të rëndësishme të tyre me shoqërinë. Partitë moderne dhe të suksesshme kërkojnë një numër të madh të anëtarëve, të cilët synohet të jenë nga pjesë të gjëra të grupeve shoqërore. Fuqia e anëtarëve ka një efekt të drejtpërdrejtë në formimin e opinionit brenda partisë. Në ditët e sotme anëtarësimi i drejtpërdrejtë i personave është një mënyrë e zakonshme e anëtarësimit në një parti.

Gjithsesi kanë ekzistuar dhe ende ekzistojnë parti me rregulla e praktika të tjera anëtarësimi. Njësitë bazë të partive komuniste, për shembull, janë organizuar shpesh përmes qelizave të përbashkëta dhe sipas profesionit të anëtarëve të saj në kompani dhe në zyrat publike. Partia Laburiste Britanike, është shembulli më i njohur i anëtarësimit kryesisht indirekt. Deri në vitet 1990, partia kishte 350,000 anëtarë me anëtarë direkt dhe rreth 4 milion anëtarë "indirekt", këta të fundit të njohur si "sindikatat e atashuara" si dhe organizata të tjera. Këta anëtarë paguanin një kontribut në Partinë Laburiste dhe kontrollonin 50% të votave në konventat e partisë.

Anëtarët e një partie kanë ndikim më të madh politik sesa qytetarët, të cilët nuk i përkasin ndonjë partie. Ata mund të marrin pjesë në formimin e opinionit brenda një partie, e cila mund të jetë në pushtet ose mund të arrijë të fitojë pushtetin. Një parakusht për këtë formë të pjesëmarrjes është ai, sipas të cilit partitë të ofrojnë mundësi të mjaftueshme për diskutime brenda partisë dhe formësimin e mendimit politik.

Edhe në rastin kur demokracia brenda partisë dhe formimi i opinionit politik funksionojnë në mënyrë të përkryer, ndodh që jo të gjithë anëtarët e partisë të jenë në gjendje ose të gatshëm që të marrin pjesë në mënyrë aktive në të gjitha vendimet e rëndësishme të një partie. Për më tepër, në nivelin lokal, pjesëmarrja aktive dhe kontributi në punën e partisë realizohet kryesisht nga një grup i vogël i anëtarëve. Këta janë kryesisht “zyrtarët politikë”, që fitojnë pozita politike për shkak të mandateve të fituara elektorale dhe që falë mandatit të tyre, kanë edhe informacion më të detajuar politik dhe pushtet vendimmarrës. Megjithatë, ekzistojnë mundësi të ndryshme për pjesëmarrje aktive nga anëtarët e “zakonshëm” që i tejkalojnë kufijtë përtej shpërndarjes së pankartave apo billbordeve gjatë fushatave zgjedhore. Ata kanë mundësi të marrin pjesë në diskutimet e brendshme politike, si dhe u mundësohet që edhe vetë ata të organizojnë forume politike. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, ata përzgjedhin kandidatët e partisë për zgjedhje (për fat të keq, kjo nuk është praktikë në të gjitha partitë, por në partitë e organizuara në mënyrë demokratike anëtarët duhet të marrin pjesë në zgjedhjen e kandidatëve!), dhe padyshim, çdo anëtar i partisë duhet të ketë shansin për të konkurruar për mandat zgjedhor.

Politikat lokale tashmë njihen si fusha ku anëtarët e partisë shpesh mund të kontribuojnë në mënyrë aktive, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe për organizimin e partisë. Për më tepër, politika lokale është një “mjedis trajnimi” i rëndësishëm i politikës, ku anëtarët e partisë kualifikohen për pozita më të larta.

Deputetët dhe anëtarët e qeverisë janë zakonisht anëtarët e shquar të partisë. Ky vlen për dy rastet, edhe në nivel kombëtar dhe në atë lokal. Në shumë parti këta politikanë ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë dhe në shumë raste edhe ndikim dominues. Dallimet në opinione midis personave me mandat përfaqësues dhe udhëheqësve të partisë janë mjaft të shpeshta në të gjitha nivelet e një partie. Në raste të konfliktit, delegatët dhe zyrtarët politikë të qeverisë mund të heqin dorë përkohësisht nga udhëzimet e partisë për shkak të dispozitave kushtetuese (për shembull, “mandati i pavarur”). Në praktikën politike ky konflikt është zgjidhur përmes bashkimit personal të partisë dhe të mandatit. Parlamentarët kryesorë dhe përfaqësuesit e qeverisë (nëse ata janë ministra në qeverinë qendrore ose kryetarë bashkie ose drejtorë të autoriteteve lokale), zakonisht janë të pranishëm edhe në bordin ekzekutiv dhe komitetet kryesore të tjera të partisë.

2. 3. Rekrutimi i anëtarëve të rinj

Partitë me një bazë të madhe të anëtarësimit kanë shanse më të larta pjesëmarrjeje me sukses në garën politike, për të fituar zgjedhjet dhe për të ushtruar ndikim në formimin e opinionit politik. Por si mundën partitë të fitojnë anëtarë të rinj?

Shumë njerëz janë të interesuar në politikë, sepse e dinë që kushtet e tyre të jetesës janë të përcaktuara nga vetë partitë, prandaj dëshirojnë të kontribuojnë dhe marrin pjesë në mënyrë direkte në vendimmarrje. Shumë prej këtyre qytetarëve presin që vetë partitë tu afrohen atyre.

Kontakti personal është mënyra më e mirë për t'iu afruar qytetarëve të interesuar politikisht dhe për t'i bindur ata që t'i bashkohen një partie. Një vizitë në shtëpi, e cila është përgatitur me kujdes dhe kryhet me edukatë dhe maturi, mund të lehtësojë vendimin e njerëzve që të bashkohen me një parti. Personi "promovues" duhet që të sjellë dhe të prezantojë disa dokumente të partisë: publikime të partisë (për shembull, programin politik dhe programin e fundit elektorale), një letër prezantuese nga lideri partiak, një formular të anëtarësimit, disa materiale reklamuese dhe materiale të tjera të partisë.

Një tjetër formë atraktive e tërheqjes së anëtarëve të rinj është ajo me anë të organizimit të aktiviteteve publike, prezantimeve ose debateve publike, festimeve për ngjarje të veçanta, dhe aktiviteteve kulturore, ku mund të ftohen për të marrë pjesë qytetarët, të cilët mendohet se janë më afër programit politik të partisë.

Diskutimet publike mbi tema të politikës lokale në përgjithësi tërheqin vëmendje të madhe dhe i japin partisë mundësinë për të prezantuar qëndrimin e saj politik dhe për të fituar mbështetës e anëtarë të rinj.



Format e integritit në parti të atyre që nuk janë anëtarë

- Sigurimi i informacioneve të rregullta dhe të plota për personat që nuk janë anëtarë por janë të interesuar për lidhje me politikat dhe aktivitetet e partisë (kushti: partia duhet që të ketë informacione për personat e interesuar për aktivitetet e saj).
- Pjesëmarrja e “anëtarëve të pavarur” në grupe pune, grupe projektuese ose komisione, gjithnjë duke u dhënë atyre të drejtë vote, të drejtën për peticione dhe të drejtën për të folur për grupet e tilla të punës në Konventat e Partisë.
- Sondazhe dhe pyetësor anëtarësimi bazuar në tema specifike dhe vendimmarrjet lidhur me drejtimin politik.
- Zgjedhjet paraprake (primare) për drejtuesit e partisë dhe për kandidatët; për këtë arsye, të gjithë anëtarët duhet që të jenë pjesë e këtyre vendimmarrjeve mbi personin, përmes zgjedhjeve në parti.
- Kandidimin e atyre që nuk janë anëtarë në listat e partisë, gjë që është veçanërisht e mundur në nivelet lokale.

Partitë politike duhet që të evitojnë fushatat e shtrenjta reklamuese për të tërhequr anëtarë të rinj ose për të paguar individë “promovues” për anëtarë të rinj. Përvoja tregon se lidhja midis kostove dhe përfitimeve ka një raport jo të favorshëm kur një parti përpiket që të tërheq anëtarë të rinj përmes reklamave. Pagesa e reklamave shpesh çon në një qëndrim kur të dyja palët, anëtarët e rinj dhe reklamuesit, janë më të interesuar në interesat financiare sesa në cilësinë e politikave dhe programit të një partie. Vetëm ato parti, të cilat në mënyrë të sinqertë përpiqen të trajtojnë problemet specifike, të zhvillojnë koncepte afatgjata dhe të mbështeten në vlera themelore, arrijnë tu ofrojnë anëtarëve potencialë një perspektivë reale për pjesëmarrje dhe një perspektivë të qartë për fitimin e pushtet politik, arrijnë të jenë më atraktive.

Partitë duhet që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë bazës së të dhënave të anëtarëve të saj, - dhe nëse është e mundur, duhet të kenë një bazë të të dhënave për qytetarët e interesuar, të cilët nuk janë anëtarë të partisë.

Menaxhimi korrekt i database dhe freskimi i saj ka një rëndësi shumë të lartë, pasi mund të përdoret për qëllime të ndryshme (si shpërndarja e informacioneve politike, gjetja e fondeve dhe mbështetja gjatë fushatës

elektorale). Përveç adresës postare, numrit të telefonit, adresës elektronike, adresës në facebook, adresës së twitter dhe të dhënave të profesionit të secilit anëtar, duhet të përshihen në database edhe informacione shtesë rreth interesave të veçanta të secilit anëtar, eksperiencës së tij apo të saj në fusha të ndryshme dhe anëtarësimi i tij apo saj në organizata ose shoqatave të tjera. Kjo i mundëson partisë, që në mënyrë specifike, të informojë anëtarët mbi tema të veçanta dhe t'i mobilizojë ata për aktivitete politike në fushat e tyre të interesit.

2. 4. Edukimi dhe trajnimi i anëtarëve të partisë

Në demokracinë moderne, partitë politike, udhëheqësit dhe anëtarët e saj duhet që vazhdimisht të përballen me çështje dhe pyetje të reja dhe të pozicionohen në funksionet e zhvillimeve aktuale dhe ndryshimeve shoqërore. Prandaj është e domosdoshme që partitë të ndërmarrin hapa paraprakë në mënyrë që të përgatitin përfaqësuesit e saj dhe anëtarët për sfida të reja, si dhe për marrjen e përgjegjësisë brenda dhe jashtë partisë. Kjo është detyra e edukimit politik.

Edukimi politik brenda partisë është i suksesshëm sidomos kur u adresohet anëtarëve të rinj të partisë. Programet e trajnimit duhet që të fokusohen në tre fusha:

Menaxhimi modern i partive politike

- Çështjet e trajnimit politik:
- Vlerat themelore dhe parimet e partisë.
- Të kuptuarit e çështjeve politike (politikat lokale, ekonomike dhe sociale etj).
- Përgatitjet për aktivitet politik brenda partisë, dhe për marrjen e funksioneve politike në parlament (retorika politike, përgatitja e funksioneve, trajtimi i medieve, promovimi i anëtarësisë, kryerja e fushatave zgjedhore dhe mbledhja e fondeve).

Shumë parti kanë një përfaqësues për trajnime brenda partisë, i cili është përgjegjës për zhvillimin e programeve bashkëkohore dhe të vazhdueshme, për masat edukative politike, si dhe për monitorimin e zbatimit të tyre.

Pjesëmarrja e liderëve të shquar partiakë në këto aktivitete edukuese kontribuon në zgjerimin e interesit të anëtarëve (ndoshta edhe të medias, në rastet kur aktivitete të tilla janë të hapura për publikun). Këto lloj aktivitesh japin impulse të rëndësishme për angazhimin në parti dhe për partinë. Për këtë arsye, liderët e partisë duhet që të investojnë kohë dhe përpjekje për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të tilla.

Në përgjithësi, puna edukative brenda një partie mund të orientohet në skemën në vijim:

- Organizimi i një programi trajnues koherent dhe i vazhdueshëm
- Përgatitja e një ekipi trajnues
- Përcaktimi i objektivave të trajnimit
- Zhvillimi dhe hartimi i materialeve të përshtatshme për forma të ndryshme të trajnimit
- Përzgjedhja e pjesëmarrësve
- Planifikimi i masave dhe hartimi i kostove dhe organigramës
- Caktimi i lektorëve dhe ndihmësve

Në shtete të ndryshme partitë kanë krijuar programe të veçanta për edukimin politik.

Institucionet për trajnim dhe edukim politik më afër partive politike

Në shumë shtete, partitë politike kanë krijuar institute të veçanta për edukimin politik të anëtarëve të saj, të cilat rregullisht ofrojnë aktivitete trajnuese për anëtarët e partisë (duke përfshirë kurse, seminare, qendra të veçanta trajnuese, analiza dhe publikime). Institucione të tilla përfshijnë, për shembull, fondacionin Konrad Adenauer (KAS) në Gjermani (www.kas.de), Forumin për Zhvillimin Civil (FOR) në Poloni (www.for.org.pl/pl), Institutin Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Institutin Republikan (IRI) në SHBA (www.ndi.org, www.iri.org), Fondacionin Rafael Preciado Hernándezas (FRPH) në Meksikë (www.fundacionpreciado.org.mx), Qëndrën Demokratike për Komunitetin (CDC) në Kili (www.cdc.cl) dhe Institutin Youido (YDI) në Republikën e Koresë www.ydi.or.kr

2. 5. Programet e Partisë Politike

Programet e partisë përmbushin funksione të ndryshme. Programi themelor i partisë përbën identitetin e partisë dhe ofron një orientim të përgjithshëm për qytetarët dhe votuesit mbi parimet dhe idetë kryesore të partisë. Me programin e saj partia legjitimon ekzistencën e saj dhe shpjegon se si ajo dallon nga partitë e tjera. Programi i partisë ilustron qëllimet politike dhe vlerat themelore, kërkesat dhe propozimet e një partie.

Programi i partisë e dallon veten nga dokumentet e tjera të partisë, të tilla si programi zgjedhor, i cili përmban sugjerime e kërkesa specifike në kontekstin e zgjedhjeve të caktuara, prandaj për këtë arsye ai duhet që të ripunohet periodikisht. Një program partiak ka karakter afatgjatë dhe nuk i referohet çështjeve të një debati aktual politik. Kjo duhet të bëhet nga programi zgjedhor ose plani i veçantë i veprimit, të cilat janë të shkruara në një perspektivë afat-shkurtër, për qëllime elektorale dhe qëllime të tjera në debatet aktuale publike.

Çdo parti politike duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë hartimit të programit të saj themelor. Ajo duhet të ftojë një numër të lartë të ekspertëve të saj në përpunimin e tij ose të paktën në miratimin e tij. Sa më shumë anëtarë që integrohen në procesin e hartimit të programit të partisë, aq më i mirë do të jetë dhe aq më mirë do të mbrojnë linjat themelore të partisë në diskutime publike.

Për të hartuar dhe aktualizuar programin e vet partiak, shumë parti zgjedhin të formojnë një komision të posaçëm, i cili vendos mbi temat që duhet të përmenden në program dhe hartojnë një draft të parë, i cili mund të paraqitet në strukturat e tjera ose në grupet e ekspertëve. Një program i avancuar i draftit mund të paraqitet për diskutim tek të gjithë anëtarët e partisë. Nëse programi i ri diskutohet dhe miratohet përfundimisht nga Konventa Kombëtare e partisë, ajo do të arrijë kështu një shkallë të lartë të ndërgjegjësimit publik.

Përveç programeve të tyre të përgjithshme, disa parti kanë gjithashtu **programe të veçanta** ose **dokumente që përcaktojnë pikëpamjet e tyre politike** në lidhje me politika të veçanta, duke përfshirë, për shembull politika ekonomike, të energjisë, politika gjinore, të rinj ose familje, politika rurale dhe kulturore. Një aspekt i veçantë i bërjes më atraktive të këtyre programeve ose dokumenteve me qëndrime politike është se ato mund të konsultohen me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të atyre sektorëve, të cilëve

ato u drejtohen. Kjo kontribuon në një marrëdhënie të fortë midis partisë dhe këtyre sektorëve.

Programi zgjedhor hartohet për zgjedhje të veçanta politike dhe mund të përmbajë propozime dhe kërkesa në lidhje me aktivitetet e ardhshme që një parti mund të zhvillojë pas formimit ose hyrjes në qeveri. Programet elektorale duhet të shkruhen para çdo zgjedhjeje. Normalisht, ato janë shkruar në kontakt të ngushtë me kandidatët kryesorë të një partie, të cilët janë përgjegjës për shprehjen e pikëpamjeve të tyre politike në publik.

Në shumë vende, një numër i madh partish nuk bëjnë përpjekje të forcuara në zhvillimin e një programi partiak dhe i kushtojnë atij pak vëmendje, pasi ato identifikohen më shumë përmes përfaqësuesve të tyre se sa programeve. Megjithatë, ato nuk duhet të nënvlerësojnë rolin e një programi gjithëpërfshirës për profilizimin dhe identifikimin e anëtarëve të saj me partinë. Programi i partisë shpalos pikëpamjet themelore të partisë para anëtarëve të partisë dhe përfaqësuesve të saj, si dhe ndaj qytetarëve dhe votuesve. Kjo dëshmon edhe nëse një parti mund të përkthejë shqetësimet shoqërore në propozime dhe programe politike. Prandaj dhe secila parti duhet t'i japë rëndësi të madhe hartimit të një programi koherent. Për më tepër, diskutimi për programin e një partie duhet të bëhet në një kornizë më të gjerë kohore, me qëllim të përditësimit të programit të partisë, duke ofruar kështu një mundësi për të zhvilluar debate mbi programin brenda partisë dhe me grupime të tjera shoqërore.

2. 6. Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm

Komunikimi i "mirë" ka rëndësi themelore për çdo parti politike. Kjo përfshin komunikimin me votuesit dhe shoqërinë, ashtu edhe komunikimin e brendshëm me anëtarët e saj brenda partisë. Vetëm ato parti me një sistem efikas të komunikimit të brendshëm janë të afta për komunikim efikas të jashtëm.

Komunikimi mbi qëllimet politike dhe synimi për marrjen e pëlqimit publik gjithmonë ka qenë pjesë e kritereve kryesore për leadership-in politik në demokraci. Që prej fillimeve të demokracisë moderne partiake, kushtet dhe realizimi i komunikimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Sot ka kërkesa të tjera të reja në lidhje me komunikimin dhe leadership-in publik. Kjo nuk i referohet vetëm disa aspekteve të njohura si "menaxhimi mediatik", por gjithashtu edhe aktivitetet e ndryshme, të tilla, si garancia e "aftësisë së medieve" në vendimmarrjet e mëdha, prezantimi strategjik

i informacioneve në media ose përshtatja e strukturave të partisë ndaj presionit të intensifikuar kohor përmes mas mediave të komercializuara. Ndryshimi i pritshmërive të shoqërive demokratike, të cilat janë të lidhura me legjitimitetin, janë po aq të rëndësishme: legjitimiteti i pushtetit politik sot është shumë më i lidhur me aftësitë e komunikimit sesa disa dekada më parë. Retorika e lidhshpimit, në këtë kontekst, ka një rëndësi të veçantë.

2. 6. 1. Komunikimi me shoqërinë

Komunikimi profesional ndërmjet vendimmarrësve politikë dhe publikut është rritur në mënyrë progresive në një faktor pushteti. Prandaj, pushteti politik është përcaktuar si një produkt i kapacitetit për të ndikuar në opinionin publik dhe në aftësinë për të siguruar pozitën e dikujt në pushtet nëpërmes vendimeve të favorshme, të zgjuara dhe strategjike.⁶

Shtrirja dhe efektiviteti i mesazheve të transmetuara në media është rritur ndjeshëm. Politikanët e orientojnë vetveten në klimën e opinionit politik; persona shumë të rëndësishëm politikë komunikojnë drejtpërdrejtë me publikun përmes TV-së, radios, shtypit dhe mediave të reja si Facebook-u, Twitter-i dhe mjete të tjera, pa pasur nevojën e strukturës së tyre partiake. Lidhja me ekspertët e marrëdhënive me publikun (gazetarët, anketuesit dhe konsulentët), dhe shkëputja nga organizimi partiak çon në një vetëvlerësim të lartë dhe ndonjëherë, në mbivlerësim të marketingut politik në krahasim me axhendën reale të aktivitetit të partisë. Si rezultat, qëllimet personale afatshkurtra strategjike shpesh dominojnë kundër qëllimeve afatgjata strategjike organizative⁷. Kjo e forcon udhëheqjen në parti dhe në grupin parlamentar, por në të njëjtën kohë, drejtuesit dhe anëtarët në nivelet më të ulta të organizimit partiak humbin hapësirën dhe shansin për vendimmarrje dhe pjesëmarrje.

Ndryshimi i modeleve të komunikimit të elitës politike, brenda saj dhe me qytetarët, kërkon aftësi mediatike, si kërkesë themelore e komunikimit politik në demokracinë mediatike. Në kushte të tilla, udhëheqje politike do të thotë, "krijim i vazhdueshëm i shumicës nga grupe të ndryshme të interesit. Racionaliteti objektiv i masave të planifikuara ecën përpara bashkë me komunikimin politik dhe aplikimin e racionalitetit të zbatimit. Prandaj shpesh lidhshpimi politik është më shumë paraqitje pragmatike se sa menaxhim hierarkik"⁸.

Lidhshpimi nën rrethanat e komunikimit mediatik ka "prodhuar modelin e ri të politikanit - star". Ai e diferencon vetveten nga të tjerët duke qenë "zbavitës" dhe "krijues", "mendjemprehtë" dhe "gazmor", një "tip fituesi"

dhe “pro-TV-së”, dikush “që mund të zhvilloj spektakël në media”. Në këtë rast, kemi të bëjmë me kërkesat për të fituar prestigj dhe pushtet përmes televizionit. Megjithatë, sa i përket kapaciteteve të menaxhimit efektiv të tyre, këto karakteristika përbëjnë vetëm kualifikimet periferike”.⁹ Në shumicën e rasteve këto kualifikime i mundësojnë politikanit-star që të tërheqë vëmendjen e publikut në situata të caktuara. Megjithatë, ata përfaqësojnë vetëm një pjesë minimale të këtyre karakteristikave që janë të nevojshme për të komunikuar dhe zbatuar reformat. Ata aktorë që mbështeten vetëm në këto aftësi, shumë shpejt do të kenë probleme në ruajtjen e besueshmërisë së tyre. Ata do të humbasin vëmendjen e publikut po aq shpejt sa e arrijnë atë. Aktorë të tillë “mund t’i japin shkëlqim të jashtëm ushtrimit të pushtetit, por nuk e mundësojnë apo e sigurojnë atë nga brenda. Kjo kërkon aftësi të ndryshme”.

Reformat kërkojnë aktorë politikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë publicitet dhe ta përdorin vëmendjen publike në mënyrë strategjike, por mbi të gjitha ato kanë nevojë për politikanë realistë që shfaqin këmbëngulje për të ndryshuar strukturat, nëse këto nuk janë të përshtatshme për të zgjidhur problemet aktuale. Nëse partitë gjithnjë shkojnë drejt një autoriteti më të lartë ekzekutiv të aktorëve kryesorë dhe, nëse ato ose parlamenti ose institucionet e tjera legjitime, janë të privuara nga pushteti ose janë zëvendësuar nga ekspertë të mirë-paguar, atëherë këto institucione vetëm sa kanë reduktuar kapacitetet e tyre për ndërmarrjen e ndonjë reforme. Për më tepër, qytetarët humbasin besimin e tyre në këto struktura (partitë, shoqatat, madje edhe media). Prandaj, reformatorët politikë duhet që të gjejnë guximin për të iniciuar procese të ndryshimeve në institucione shoqërore dhe më tej, për t’i zbatuar këto ndryshime. Shpërndarja e shpejtë e këtyre organizatave vetëm sa mbulon nevojën për ndryshime ndër-organizative, dhe në këto raste, zgjidhjet pragmatike janë të nevojshme!

Institucionet shoqërore nuk mund të keqpërdoren si ofruese të imazheve për individë politikanë. Në fakt, institucionet demokratike duhet të përdoren për të transmetuar çështjet politike. Kjo kërkon komunikim në mënyrë që njerëzit të identifikohen me të. Megjithatë, komunikimi i suksesshëm i reformave nuk zë vend vetëm në mendjen e atyre që kanë lidhje me të, por gjithashtu edhe në institucione demokratike: prandaj, një qeveri e suksesshme në demokraci parlamentare kërkon lidhshmëri politike të fokusuar brenda dhe jashtë partisë. Kjo kërkon këmbëngulje për të komunikuar qartë vendimet tek qytetarët dhe për të siguruar mbështetje nga institucionet e përfshira. Unë supozoj se votuesit janë më të mençur sesa analistët e marrëdhënieve me publikun!

Komunikimi i jashtëm mund të përfshijë çdo gjë në ofertën e tij nga komunikimi masiv modern dhe marketingu politik. Komunikata të rregullta për shtyp, konferenca shtypi dhe publikimi i buletineve dhe qëndrimeve janë bazat për komunikimin e partisë. Në ditët e sotme interneti ka një rëndësi të veçantë për komunikim modern të partisë. Faqja e internetit të partisë duhet të përditësohet vazhdimisht. Prezenca e partive politike në komunitetet sociale moderne në internet, të tilla si, Facebook dhe Twitter, është e domosdoshme, në mënyrë që një parti të japë mesazhet e saj dhe t'i prezantojë liderët e tyre për publikun e gjerë. Degët rajonale të partisë duhet të kenë faqen e tyre të internetit për të komunikuar çështjet me rëndësi lokale dhe rajonale. Platformat vizuale si You tube mund të përdoren për të shpërndarë mesazhet e partive dhe po ashtu, të prezantojnë figurat e tyre drejtuese.

Përveç kësaj, organizimi i aktiviteteve masive, të tilla si, kongrese dhe seminare, janë një mjet i rëndësishëm për forcimin e kontaktit me anëtarët dhe përfaqësuesit e organizatave shoqërore apo lokale, me udhëheqësit rajonalë dhe kombëtarë. Prania e liderëve partiakë në emisione televizive dhe radio, si dhe në Facebook dhe Twitter, janë mjete të tjera të rëndësishme për komunikimin e partisë.

Pavarësisht se të gjitha këto forma të komunikimit mund të jenë të rëndësishme, nuk ka dyshim se një diskutim i afërt i një anëtari të "thjeshtë" të partisë me fqinjin e tij, kolegun apo shokun e tij, është një instrument gjithashtu i rëndësishëm për kontaktin e përditshëm dhe komunikimin e partisë me shoqërinë e gjerë. Ky lloj i komunikimit të jashtëm mund të jetë efektiv vetëm atëherë sa vetë komunikimi brenda partiak është efektiv.

Partitë janë hallkë lidhëse ndërmjet shoqërisë dhe shtetit. Në mënyrë që të zgjidhen dhe të formulojnë kërkesat politike për të fituar shumicën e qytetarëve dhe votuesve, palët duhet të dinë shqetësimet e shoqërisë. Prandaj kontakti i vazhdueshëm me grupe të shumta sociale dhe shoqata është i nevojshëm. Ky kontakt, i cili është rezultat i kontributit ose i anëtarësisë së anëtarëve të partisë në organizata të tjera, duhet të jetë formalisht i organizuar nga partia në intervale të rregullta kohore në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Duke bërë kështu, një parti dërgon një sinjal të rëndësishëm në drejtim të grupimeve shoqërore.

Një aspekt është i qartë: të gjitha përpjekjet drejt komunikimit teknik ose individual do të jenë të padobishme në qoftë se një palë nuk është e angazhuar në aksione politike që krijojnë besueshmëri dhe janë të orientuara për të mirën e përbashkët. Pa koncepte afatgjata dhe përmbajtje

konkrete, të gjitha përpjekjet e komunikimit, edhe nëse ushtrohen në një mënyrë profesionale, do të perceptohen si një shfaqje bosh.

2. 6. 2. Komunikimi brenda partisë

Komunikimi i brendshëm i partisë është po aq i rëndësishëm sa edhe komunikimi i jashtëm i partisë. Komunikimi i brendshëm për një parti është i rëndësishëm jo vetëm për të informuar anëtarët e saj, por edhe për të paraqitur qëndrimet partiake përballë shoqërisë. Ky është një funksion shumë i rëndësishëm i anëtarëve të "thjeshtë". Prandaj, çdo lidërsip i partisë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të përpiqet të ndërtojë një sistem efikas të komunikimit ndaj anëtarëve të saj.

Në shumë parti, komunikimi i brendshëm i partisë nuk bëhet në mënyrë efektive. Tek ato ka mungesë të informacionit të rregullt për anëtarët, lidhur me çështjet kryesore të aktualitetit politik. Por, si mundet që anëtarët e partisë të përfaqësojnë ose mbrojnë qëndrimet e partisë së tyre në qoftë se ata nuk janë të informuar aq sa duhet mbi këto qëndrime?

Nganjëherë, ekziston një mungesë e kushteve themelore për komunikim efektiv. Shpesh ndodh që organizatat rajonale të partisë nuk kanë një listë aktuale të koordinatorëve lokalë të partisë dhe të anëtarëve me të dhëna të plota mbi adresën dhe postën elektronike, etj. Gjithashtu ata nuk kanë dijeni për interesat e veçanta të anëtarëve të tyre ose pjesëmarrjen e tyre në organizata të tjera, tek të cilat ata mund të transformohen në "ambasadorë" të rëndësishëm të partisë ndaj klubeve dhe shoqatave të tilla. Prandaj, kërret e partive, duhet që gjithmonë të përpiqen të përmirësojnë komunikimin brenda partisë dhe atë ndërpartiak. Në këtë kontekst, disa aktivitete kanë një rëndësi të veçantë:

- Mbledhje të rregullta të anëtarëve të partisë në nivel lokal me ofrimin e informacioneve dhe diskutimin e zhvillimeve të rëndësishme dhe vendimeve brenda partisë.
- Planifikimi dhe koordinimi i një plani vjetor për komunikim ndërmjet niveleve të ndryshme të organizatës partiake.
- Zgjedhja apo emërimi i një strukture përgjegjëse ekzekutive përgjegjës për komunikim në të gjitha nivelet e organizimit të partisë dhe koordinimi efektiv në mes stafeve përgjegjëse të komunikimit. Në nivel kombëtar sekretari i përgjithshëm dhe i

emëruari i veçantë për komunikim brenda partisë duhet të jenë përgjegjës për komunikim të brendshëm efektiv. Në nivel rajonal duhet të emërohen persona me funksione të ngjashme.

- Në të gjitha nivelet e organizimit të partisë duhet të përgatiten raporte periodike të brendshme mbi zhvillimet e brendshme dhe të jashtme. Raportet duhet që të dorëzohen në nivelet më të larta të partisë.
- Publikimi i raporteve periodike mbi anëtarësinë ose i revistës/gazetës së partisë, të cilat duhet të shpërndahej në mesin e të gjithë anëtarëve të partisë.
- Mbulimi i tyre duhet të përfshijë tema aktuale politike, të cilat shqyrtohen nga partia, si dhe informacione të rëndësishme mbi ngjarjet brenda partisë; për më tepër, një hapësirë e caktuar duhet t'i jepet anëtarëve të partisë për të kontribuar në diskutime.
- Vlerësim i vazhdueshëm i efikasitetit të komunikimit të brendshëm.



2. 7. Demokracia brenda partive politike

Demokracia brenda-partiake është e nevojshme në mënyrë që të rritet ndikimi dhe kontributi i qytetarëve të përfshirë politikisht në një parti. Një shtet demokratik nuk mund të qeveriset nga parti me struktura jodemokratike. Prandaj në shumë vende ekzistojnë udhëzuesit ligjorë, të cilat detyrojnë partitë të respektojnë procedurat demokratike në proceset e tyre të brendshme. Megjithatë, në realitet, kjo gjë shumë shpesh shpërfilllet.

Në shumë vende, kushtetuta apo ligjet, i ngarkojnë partitë që të zhvillojnë proceset e tyre të brendshme sipas procedurave demokratike. Megjithatë, pavarësisht nga dispozita të tilla ligjore, ndikimi i anëtarëve të “thjeshtë” të partisë është relativisht i kufizuar edhe nga grupi i anëtarëve që janë me të vërtetë të fuqishëm, çfarë do të thotë se ndikimi i tyre është zakonisht i vogël. Një arsye për këtë gjendje është edhe mungesa e interesimit në mesin e vetë anëtarëve për të marrë pjesë në mënyrë më aktive. Në raste të tjera, burokratizimi i aparatit partiak ka rezultuar në krijimin e një distance të caktuar – deri edhe në tjetërsim, midis udhëheqësve të partisë dhe anëtarëve të partisë. Kjo ndodh për disa arsye, si p.sh, për shkak të natyrës së veçantë të demokracisë moderne, e cila kërkon procese të shpejta të vendimmarrjes, dhe nga ana tjetër, nuk lejon procese të gjata të votimeve brenda partisë. Megjithatë, përvoja tregon se ata që investojnë kohë dhe kontribut në punët e partisë, në fakt, mund të fitojnë ndikim të madh brenda partisë.



Ligji i hekurt i oligarkisë

Në një punim klasik shkencor mbi partitë Robert Michels e ka identifikuar që prej 1911 “ligjin e hekurt të oligarkisë” (“sundimin e pakicës”)¹⁰. Sipas studimit, secila organizatë në mënyrë të pashmangshme krijon një klasë sunduese, të cilën ajo nuk mund ta kontrollojë në mënyrë efikase për një periudhë afatgjatë. Rrjedhimisht, liderët e partisë dhe strukturat e partisë bëhen gjithnjë e më shumë të pavarura, duke përfitur nga përparimet në teknologjinë e informimit dhe rritjen e profesionalizmit të politikës. Akumulimi i përgjegjësive dhe monopolizimi i fuqisë janë simptomat e rritjes të oligarkisë, gjë që përbën një problem për formimin e mendimit demokratik brenda partisë. Përmirësimi në procedurat demokratike dhe në shkëmbimin e pikëpamjeve mund të kontribuojnë në largimin e strukturave të ngurta të partisë.

Ndikimi i komisioneve lokale të partive në formësimin e mendimit politik dhe procesin e vendimmarrjes të partisë ndryshon në varësi nga natyra e problemeve aktuale. Nuk kanë askund dhe përherë ndikim në përzgjedhjen e kandidatëve për parlament. Megjithatë kjo ndryshon nga vendi në vend.

Shumë parti në vende të ndryshme të botës ankohen për mungesën e demokracisë brenda partisë, kryesisht për shkak të rënies së numrit të anëtarëve. Shumë parti po kërkojnë të zbatojnë politika më atraktive për anëtarët aktualë dhe të gjejnë stimulime për simpatizantët që t'i bashkohen partisë së tyre.

Një mundësi është që partitë të hapen në drejtim të simpatizantëve jo anëtarë dhe tu lejojnë atyre mundësinë e pjesëmarrjes në nivele të ulëta të partisë. Megjithatë, përvoja tregon se aktivitetet e simpatizantëve jo anëtarë në parti janë të pakta. Gjithashtu ekziston rreziku që përfitimet individuale nga anëtarësimi në parti do të ulen nëse simpatizantët që nuk janë anëtarë marrin të drejta të njëjta, si dhe marrin pjesë, për shembull, në vendimet brenda partisë mbi zgjedhjen e kandidatëve. Në çdo rast, baza e partisë duhet të marrë pjesë në vendimet brenda partisë. Kjo, qoftë direkt përmes sondazheve me anëtarët dhe procedurave të votimit, apo në formë indirekte me delegatë, - secila parti duhet të vendosë në bazë të rethanave të tyre.

Të dy mënyrat janë forma legjitime të demokracisë brenda partiake, edhe në ditët e sotme, por tendenca e përgjithshme është në favor të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në vendimmarrje të anëtarëve të partisë. Është e rëndësishme që procesi i përzgjedhjes së liderëve të partisë dhe kandidatëve për zgjedhje të respektojë kriteret demokratike. Kjo parimisht duhet të bëhet duke zbatuar modelin nga “poshtë-lart”; çfarë do të thotë se çdo parti apo pozicion i zgjedhur është legjitimuar nga organi përkatës zgjedhor brenda partisë. Në shumicën e rasteve ky organ është Asambleja e partisë, e cila mund të jetë në nivel lokal, rajonal, apo kombëtar. Kjo mënyrë e emërimit i mundëson drejtuesit, të krijojnë lidhje me rivalët potencialë brenda partisë dhe me ata që kanë legjitimitet nga partitë tjera.

Respektimi i demokracisë brenda partiake nënkupton

- Promovimin e pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve të partisë në çështjet e brendshme të partisë.
- Mundësinë që anëtarët të shprehin pakënaqësitë e tyre në kuadër të partisë.
- Mundësi për pjesëmarrje të grupeve të veçanta brenda partisë (për shembull, gratë, të rinjtë, dhe njerëzit e klasës së mesme).
- Tolerancë në drejtim të mendimeve të ndryshme, përderisa ato bëhen në limitet e lejuara të programit bazë të partisë.
- Dakordësi me rregullat dhe rregulloret për pjesëmarrje në anëtarësim, si dhe proceset e vendimmarrjes brenda partisë.
- Respekti i udhëheqësve të partisë ndaj anëtarëve “të thjeshtë” të partisë.

Demokracia brenda-partiake, gjithashtu nënkupton, që grupi fraksion apo individual brenda partisë duhet të jetë i aftë të shprehë në një masë të madhe në publik pikëpamjet dhe polemikat e tij. Një parti nuk duhet të trembet nga kjo, pavarësisht se konfrontimet e hapura të dallimeve në mendime dhe konfliktet, në disa raste në imazhin e partisë dhe në mendjen e qytetarëve votues shihen shenjë e dobësisë, besueshmërisë së vogël dhe e mungesë së unitetit brenda partisë.

Në rastin më ekstrem, mund të ndodhë që pozicionet e ndryshme të palëve të jenë aq larg njëra - tjetrës sa sjellin shterimin e energjive të politikanëve dhe ndaj, polemikat e brendshme ndërhyjnë në vizionin programor të

partisë. Në anën tjetër, dallimet e brendshme i japin jetë diskutimeve politike. Prandaj, një shenjë e fuqisë së një partie mund të jetë rasti kur një parti pranon dallimet në mendime dhe nuk i ndalon ato për shkak të nevojës për unitet. Për sa i përket debateve brenda partisë dhe polemikave ato mund të jenë një demonstrim i një jete të gjallë në parti, dhe në rast të tillë, gjatë fushatave zgjedhore partitë duhet të evitojnë konfliktet brenda partiake dhe të prezantojnë veten më një profil politik të unifikuar. Në fushata elektorale të gjitha forcat e partisë duhet të jenë të koncentruara. Për konkurrentët në garat brenda partisë, kjo do të thotë, lënie anash e ndjenjave personale dhe respektimi i votës për pretendentët. Megjithatë, shpesh mund të vërehet e kundërta. Ata kandidatë që kanë humbur në garat brenda partiake ndonjëherë krijojnë partitë e veta politike apo platformat zgjedhore, duke dëmtuar marrëdhëniet e tyre me partitë e tyre të vjetra, pa përfituar domosdo përparësi të konsiderueshme personale.

2. 8. Konfliktet brenda partiake dhe zgjidhjet e konflikteve

Brenda partive, konfliktet mund të ndodhin kohë pas kohe – për shkak të perceptimeve të ndryshme, si dhe për shkak të rivaliteteve personale për pozita drejtuese dhe ndikim. Këto rivalitete janë të pashmangshme dhe legjitime, por duhet të diskutohen në mënyrë korrekte. Brenda partive ka gjithmonë një konkurrencë për fuqi dhe ndikim; kjo është pjesë e aktivitetit të përditshëm. Megjithatë, në fund, konfliktet e brendshme duhet të vendosen brenda kufijve të demokracisë dhe procedurave transparente. Është shumë e rëndësishme që, të gjithë ata që janë të përfshirë në konflikte të tilla t'i respektojnë vendimet demokratike të partisë.

Në disa vende, anëtarë nga më të njohurit të partive, të cilët gjithashtu mund të kenë mandate në parlament apo të zënë poste të tjera publike, kanë tendencë të braktisin partitë e tyre në rastet kur konfliktet e brendshme partiake nuk zgjidhen në favor të tyre. Kjo nuk e dëmton vetëm partinë, por gjithashtu është një shembull i sjelljeve të këqija demokratike. Në fund të fundit, demokracia nënkupton parimin se duhet të respektohet shumica, edhe nëse pozita personale është “vetëm” mendimi i pakicës.

Organet formale për zgjidhjen e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve brenda-partiake janë mbledhjet e partisë dhe konventat, ku dallimet në mendime mund të diskutohen dhe të vendosen në mënyrë demokratike. Instanca e fundit për të vendosur mbi mosmarrëveshjet, normalisht, jo mosmarrëveshjet politike, - janë gjyqet partiake, të cilat në disa shtete

janë të përcaktuara me ligj ose nga statutet e vetë partive. Këto gjykata partiake kanë përgjegjësinë që konfliktet të mund të zgjidhen nga brenda partisë, dhe jo para gjykatave publike. Gjyqet partiake kryesisht kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet statusore për anëtarët dhe të drejtën e votimit, rishikimin e brendshëm të procedurave të votimit dhe çështjeve të tjera të brendshme apo edhe sanksioneve kundër anëtarëve, sjellja e të cilëve nuk është në pajtim me linjën e partisë dhe që mund të kenë shkelur statusin apo vlerat thelbësore të partisë.

Përveç këtyre formave formale të zgjidhjeve dhe ndërmjetësimit të konflikteve, partitë shpesh zbatojnë gjithashtu forma më “të buta” të ndërmjetësimit të konflikteve në mes të grupeve rivale dhe individëve. Format më të njohura janë, oferta e ndarjes së pushtetit duke i ftuar rivalët në poste të caktuara. Ilustrim i kësaj praktike është ftesa e Presidentit Barak Obama për rivalen e brendshme Hillary Clinton që të jetë sekretare e shtetit. Ai gjithashtu e ka ftuar ekspertin e njohur të partisë rivale, republikanin Robert Gates, që të bëhej sekretar i mbrojtjes. Parimi i vjetër “përçaj dhe sundo” nuk e ka humbur rëndësinë e tij. Ai ndihmon për të mbrojtur pozitën e vet të pushtetit dhe shpesh ofron për të gjitha palët e përfshira një situatë të ashtuquajtur “fito - fito”.

Konfliktet brenda-partiake dhe dallimet ideologjike brenda-partiake mund të zbuten nga ftesa e grupeve të brendshme rivale dhe përfaqësuesit e tyre në nivelin e menaxhimit të partive politike, - ku liderët e partive janë në gjendje të vendosin një formë të arsyeshme të bashkëpunimit, e cila çon në përfitim të gjithë partisë. E njëjta gjë vlen për përpjekjet që të integrohen përfaqësuesit e grupeve të ndryshme brenda-partiake në strukturat partiake apo në pozitat më të larta drejtuese. Kjo formë e integritit të negociuar në menaxhimin e partisë është provuar të jetë më e suksesshme se marrëveshjet e kuotave për fraksionet, të cilat janë më të formalizuara dhe më të kontestuara. Megjithatë, marrëveshjet e kuotës mund të kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin e përfaqësimit të grupeve të caktuara në kuadër të një partie.

2. 9. Kuota për gratë dhe pakicat

Pavarësisht se shumica e kushtetutave në botë përcaktojnë trajtimin e barabartë të burrave dhe të grave, në mbarë botën gratë janë të nën - përfaqësuara në partitë politike dhe në funksionet udhëheqëse politike. Në shumë vende janë duke u bërë përpjekje që të arrihet një pjesëmarrje më e madhe e grave në politikë. Një kontribut nxitës është adresimi i një kërkesë themelore për këtë qëllim.

Në mënyrë që t'i jepet grave një hapësirë më e madhe për kontribut politik dhe përfshirje, në shumë vende është krijuar një kuotë statusore për gratë me anë të rregulloreve të ndryshme. Zakonisht, qëllimi është që gjatë zgjedhjeve të rezervohet një numër minimal i posteve partiake dhe pozitive drejtuese për gratë. Përvoja tregon se rregulloret me kuota të tilla, - aty ku ato funksionojnë, - mund të kontribuojnë në praktikë për një përqindje më të lartë të grave në politikë.

Sidoqoftë, përvoja gjithashtu ka treguar se rregulloret me kuota shpesh nuk jetësohen në praktikë, kështu që rezulton se në tërësi nuk ka më shumë gra sesa më parë në parlamente. Prandaj, duhet bërë përpjekje të mëdha që të sigurohet se kuotat femërore të hyjnë në fuqi dhe që të ketë një rritje të përqindjes së grave në politikë, kryesisht në parlament. Arritja e këtij qëllimi lidhet gjithsesi me kulturën politike dhe kërkon kohë për tu arritur.

Disa parti aplikojnë rregulla me kuota, përmes të cilave u garantojnë pakicave të caktuara bashkëpunim e përfaqësim të përshtatshëm në kuadër të nivelit dhe forcës që ato përfaqësojnë. Politikat, për t'u garantuar përfaqësimin e pakicave etnike, bëhen në dy forma: kuotat për emërimin e kandidatëve në partitë politike dhe kuota e rezervuar legjislativ. Rezervimi legjislativ përfshin rezervimin e mandateve për grupe të caktuara minoriteti dhe se vetëm anëtarët e këtyre grupeve mund të votojnë për përfaqësuesin e tyre.

Kjo praktikë çon në hartimin e një liste të veçantë për votuesit që u përkasin pakicave. Ky sistem nuk është shumë i favorshëm në një shoqëri multikulturore pasi pengon çfarëdo iniciative për shkrirje politike midis komuniteteve. Pjesëmarrja e pakicave etnike apo racore në parlamente shpesh ngre pyetjen se, në çfarë niveli janë të përfaqësuar këto grupe në parti dhe në parlamente, dhe se, në çfarë mase ato mund të ndikojnë në politikë dhe në vendimmarrje.



Ka pasur përpjekje të rëndësishme mes partive politike për rritjen e përkrahjes nga pakicat etnike. Ata rekrutohen në parti përmes krijimit nga partitë politike të strukturave për bashkëpunim ndëretnik, në mënyrë që të rritet profili politik në kuadër komuniteteve etnike. Kjo mund të luaj një rol të rëndësishëm në zgjedhjet lokale, sepse nëse pakicat etnike nuk marrin pjesën e tyre në përfaqësim, asnjë parti që synon qeverisjen, nuk do të mund të marrë përkrahjen e tyre.

2. 10. **Financimi i partive**

Partitë politike kanë nevojë për burime financiare në mënyrë që të vazhdojnë funksionimin e tyre efikas në frymën e ndikimit në shoqëritë demokratike, që të sigurojnë ekspertizë, që të zhvillojnë programet e tyre dhe t'i bëjnë të njohura ato, që të mbajnë një strukturë organizative të qëndrueshme, të kultivojnë komunikimin me anëtarët dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, që të zhvillojnë fushatat elektorale. Në rastin ideal, ky financim duhet t'i mundësojë partive të vazhdojnë detyrat e tyre pa qenë financiarisht të varur në një grup interesi apo nga ndonjë person.

Roli dhe dobia e partive është e padiskutueshme për një sistem demokratik, ndaj edhe shumë vende demokratike ofrojnë mbështetje financiare shtetërore për partitë. Kjo përkrahje mund të jetë në formë të fondeve të drejtpërdrejta nga thesari (zakonisht si kompensim për shpenzimet e fushatave zgjedhore), apo në formë të përkrahjes jo të drejtpërdrejtë, përmes zbritjes të taksave të donacioneve për partitë.


Të ardhurat financiare

- Kuotat e anëtarësimit në parti janë burimi më pak i kundërshtuar në burimet e të ardhurave. Kuotat e anëtarëve janë shenjë e një marrëveshjeje midis anëtarëve dhe partisë së tyre. Pagesat nga anëtarësia nuk janë vetëm një burim i rëndësishëm financiar, por gjithashtu një shprehje e simpatisë për një parti. Fatkeqësisht, anëtarët e varfër shpesh nuk mund të përballojnë pagesën e tarifave. Gjithashtu, kur ka praktika të paligjshme apo keqpërdorim të fondeve të partisë, ka edhe më pak vullnet nga anëtarët që të paguhet kuota. Prandaj, partitë politike duhet të japin llogari dhe të bëjnë transparencë për përdorimin e kuotave të anëtarësimit (si dhe të ardhurave të tjera). Edhe në vende të varfra, partitë duhet të mundohen që të mbledhin disa kuota të

vogla nga anëtarët e tyre, por ato duhet të ofrojnë disa shërbime për justifikimin e tyre. Kur nuk ka mënyrë për të mbledhur kuotat në formë të parave, gjithmonë ekziston mundësia e mbledhjes së "kuotave" në formën e shërbimeve për partinë.

- Kontributet financiare të deputetëve dhe taksat e zyrtarëve të emëruar nga partitë; këta persona kontribuojnë për partinë përtej kuotave të tyre të anëtarësimit, pasi ata i detyrohen partisë së tyre për mandatet apo postet e tyre në administratën publike etj.
- Të ardhurat nga biznesi, aktivitetet etj; disa parti zotërojnë biznese (për shembull, shtëpi botuese apo për shpërndarjen e dokumentacionit dhe të broshurave të partisë etj), apo kryejnë aktivitetet të tjera, nga të cilat gjenerojnë të ardhura. Në parim, zyrtarisht ato duhet të llogaritin të gjitha të ardhurat nga aktivitetet e tilla dhe kapitalet e tyre.
- Donacionet janë burimet më të debatuar publike të financimit të partive. Kjo vlen sidomos për partitë e mëdha, të cilat marrin një pjesë të rëndësishme të ardhurave të tyre përmes donacioneve. Shqetësimi lidhet me faktin se donatorët e mëdhenj ekonomikë mund të përpiqen të ushtrojnë ndikim politik përgjatë këtij procesi. Kjo do të kundërshtonte parimet e barazisë demokratike në vendimmarrje.
- Kreditë janë një burim i rëndësishëm, por problematik i financimit të partive politike. Kreditë krijojnë borxhe, dhe për shumë parti borxhet paraqesin një problem serioz. Nuk është e lehtë të zvogëlohen borxhet me mjete ligjore. Nëse është e mundur, partitë politike duhet të shmangin këtë burim të financimit. Në çdo rast, ato duhet zyrtarisht të llogarisin detyrimet e tyre ndaj institucioneve kredituese.
- Kompensimi i shpenzimeve për fushatën zgjedhore. Kjo është një praktikë e zakonshme e financimit publik të partive. Kompensimi i shpenzimeve të fushatave zgjedhore është zakonisht i lidhur me rezultatin e zgjedhjeve të një partie.

Figura 3: Burimet për financimin e partive politike



Parimet e financimit të partisë

- Partitë duhet që çdo vit zyrtarisht të deklarojnë gjendjen e tyre financiare, sidomos në rastet kur marrin fonde publike.
- Kuotat e anëtarësisimit duhet të jenë një pjesë e madhe e të ardhurave të partisë. Kuotat e anëtarësisimit nuk kanë vetëm efekt financiar, por gjithashtu përmirësojnë identitetin dhe i detyrojnë drejtuesit e partisë që të jenë më transparentë ndaj anëtarëve të tyre.
- Kontributet shtetërore për partitë duhet të respektojnë parimin e mundësive të barabarta, si dhe ndikimin e partisë në zgjedhje, shprehur nga rezultati i saj zgjedhor.
- Menaxhimi modern i partive politike

- Shuma totale vjetore e kontributit të shtetit duhet të jetë e përcaktuar.
- Në lidhje me kontributin shtetëror për partitë, shuma e donacioneve të saj duhet të jetë e përcaktuar.
- Kufiri i zbritjes së taksave për kuotat e anëtarësimit dhe donacionet duhet përcaktuar sa më i ulët që të jetë e mundur.
- Një numër limit, mundësisht i ulët, në lidhje me donacionet e partisë duhet të bëhet publike.

Mbledhja e fondeve për partitë

Financimi publik i partive nuk duhet të jetë burimi i vetëm e as burim kryesor i të ardhurave për partitë. Prandaj, partitë duhet të zhvillojnë aftësinë për të siguruar mjete të duhura të të ardhurave. Kjo është një detyrë qendrore për secilën parti dhe ky fakt, duhet të konsiderohet kur partitë krijojnë struktura dhe ndahen detyrat brenda tyre.


Në mënyrë që të mblidhen fondet, është e nevojshme një strategji, e cila duhet të zhvillohet nga financieri i partisë. Ai duhet të drejtojë dhe të koordinojë të gjitha aktivitetet për të mbledhur fonde; për më tepër, ai duhet të koordinohet me financierët rajonalë dhe lokalë të partisë. Në të gjitha nivelet e partisë, duhet të jetë një zyrtar për financa, posaçërisht përgjegjës për mbledhjen e fondeve.¹¹

Mbledhja e fondeve duhet të bëhet përmes një strategjie. Masat e mëposhtme, midis të tjerash, janë provuar si të suksesshme:

- Kërkesat personale për donacione të bëra nga liderët dhe anëtarët, ose nga persona të tjerë të afërt me partinë.
- Letrat personale që nxisin donacionet nga anëtarët dhe qytetarë të tjerë.
- Caktimi i një komisioni për sigurimin e burimeve financiare.
- Organizimi i aktiviteteve të veçanta (festa, koncerte verore, aktivitete tematike, etj), të cilat gjithashtu mund të përdoren për të kërkuar donacione.
- Thirrje adresuar qytetarëve për të kërkuar donacione.
- Vizitat në banesat e anëtarëve, në korporata dhe persona të tjerë, nga të cilët priten donacione.

Për sa i përket afrimit të anëtarëve të rinj donatorë, kontakti personal është provuar se mbetet metoda më e mirë për të kërkuar donacione. Megjithatë, për këtë është i nevojshëm një regjistër i mirë-administruar i anëtarëve dhe i simpatizantëve, i cili ndihmon në fokusimin direkt tek donatorët potencialë. Letrat masive jo individuale zakonisht prodhojnë shpenzime pa efekt. Donacionet gjithashtu mund të sigurohen në formë të punës vullnetare, duke ndihmuar të organizohen evenimente dhe aktivitete informuese, të njohura si “mbledhje votash në rrugë” gjatë fushatave zgjedhore, apo duke siguruar mjedise të mbledhjeve për partitë.

Veçanërisht e rëndësishme për donacionet në para është nevoja që partia t’i shpjegojë donatorëve qëllimin për të cilin do të përdoren donacionet. Kjo është një çështje e transparencës dhe në përgjithësi, e rrit gatishmërinë për të dhuruar. Partitë duhet gjithashtu t’i vlerësojnë donacionet në mënyrë të përshtatshme, për shembull, me një letër personale falënderuese, dhurata të vogla, të njohura si “dhurata rasti”, të tilla si lapsat, fletoret apo USB me logo të partisë, dhe informacione të përgjithshme mbi partinë. Megjithatë, partitë duhet të jenë të kujdesshme që të mos i harxhojnë burimet duke dhënë dhurata bujare. Të gjitha masat e lidhura me mbledhjen e fondeve duhet të përputhen me rregullat ligjore dhe duhet të respektojnë parimin e transparencës.



3.

**Partitë
Politike dhe
Marrëdhëniet
e tyre me
Shoqërinë Civile
dhe Grupet
e Interesit**

Që në gjenezën e tyre në shekullin XIX-të partitë politike kanë qenë fillimisht organizata shoqërore.

Në veçanti, partitë evropiane (perëndimore) u shfaqën si një shprehje e organizuar e konfliktit shoqëror dhe politik. Organizatat liberale, konservative, rurale dhe socialdemokrate u përpoqën të riafirmojnë pozitat e tyre dhe përmes organizimit të partive. Përmes pjesëmarrjes në zgjedhje, përfaqësimit në parlament dhe pjesëmarrjes në qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike, ato kërkuan që të zbatojnë reformat politike dhe shoqërore. Nga origjina e tyre, por edhe nga orientimi i tyre parlamentar dhe dëshira për të arritur në postet publike, dhe deri më sot, partitë politike janë të pozicionuara midis shoqërisë civile, parlamentit dhe qeverisë.

Në të vërtetë partitë politike mund të konsiderohen si organizata politike të shoqërisë civile, të cilat e përmbledhin interesin e një grupi të veçantë (apo disa grupeve), e artikulojnë dhe e përfaqësojnë atë. Përmes pjesëmarrjes në zgjedhje demokratike, grupet synojnë t'i bëjnë të njohura dhe t'i mbrojnë këto interesa tek përfaqësuesit dhe institucionet formale të politikës.

3. 1. Partitë dhe shoqëritë civile

Partitë zakonisht janë krijuar në dy forma: nga elita shoqërore të cilat mbledhin rreth tyre një grup të përkrahësve me ndikim që të mbrojnë pozitat e tyre, apo nga qytetarë, të cilët kërkojnë mbështetjen e personave me mendim të njëjtë në mënyrë që të arrijnë ndryshime politike dhe shoqërore. Në rastin e parë, kemi të bëjmë më shumë me një qasje nga lart-poshtë për ndërtimin e partisë, siç ka qenë rasti me partitë e para liberale, të cilat ishin të bazuara në komisionet zgjedhore vullnetare dhe konkurruese për përfaqësim parlamentar.

Këto mënyra të krijimit të partive politike nuk janë tipike vetëm në historinë e partive të Evropës Perëndimore në fund të shekullit XIX. Lëvizjet reformuese në ish-vendet komuniste të Evropës Lindore, si "Karta 77" në Çekosllovakë, "Solidarnos"; Lëvizjet për Sindikatën dhe Reformat Shoqërore në Poloni, apo Lëvizja Demokratike e Qytetarëve në ish-Gjermaninë Lindore, të tilla si "Iniciativa për paqe dhe të drejta të njeriut", "Forumi i ri"

dhe “Nisma demokratike”, janë krijuar nga shoqëria civile, dhe më pas janë kthyer në parti politike ose u janë bashkuar partive politike ekzistuese.

Që nga viti 1990, në kontekst të rritjes së kritikave të përgjithshme mbi partitë politike nga aktivistë socialë, por edhe nga studiues të shkencave sociale, - ka nisur një debat intensiv ndërkombëtar mbi konceptin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes. Ekzistonte një perceptim i përgjithshëm mbi krizën e demokracisë të fokusuar kryesisht në krizën e përfaqësimit dhe të institucioneve, dhe jo më pak edhe krizën e partive politike. Në kuadër të këtij debati, zgjerimi i pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë duket të jetë një kurë efikase për të zëvendësuar të gjitha parimet e papërcaktuara të përfaqësimit. Organizatat e shoqërisë civile, të tilla si, iniciativat qytetare apo “lëvizjet e reja shoqërore” (lëvizjet; paqësore, të grave, mjedisore, etj) janë bërë një sfidë për partitë duke pasur parasysh pamundësinë e vetë partive për të zgjidhur problemet ekzistuese dhe për shkak të çmobilizimit të anëtarëve të tyre. Numri i iniciativave dhe lëvizjeve të tilla, në shumë raste, të njohura si “lëvizje për një çështje të vetme”, është rritur ndjeshëm në dy dekadat e fundit. Në disa vende partitë e reja politike janë formuar duke pasur fokus të përqendruar vetëm në një apo disa çështje (partitë kundër imigracionit, “partitë e internetit” etj). Në disa raste, partitë politike tradicionale i kanë integruar brenda tyre çështjet e reja, si mbrojtja e mjedisit, energjia alternative, dhe zhvillimi i qëndrueshëm etj. Këto çështje në ditët e sotme janë pjesë e programeve të partive aktive. Në anën tjetër, disa nga lëvizjet e reja të shoqërisë kanë marrë përsipër funksionet partike, kryesisht për artikullimin dhe përfaqësimin e interesave shoqërore. Megjithatë, në vitet e fundit ka pasur shenja të zhgënjimit tek organizatat e shoqërisë civile lidhur me mundësitë dhe kapacitetet e tyre dhe rritjen e mbështetjes për nevojën e gjetjes së një balance të arsyeshme midis përfaqësimit dhe pjesëmarrjes. Tashmë është provuar se demokracia masive mund të funksionojë vetëm në formë të demokracisë përfaqësuese dhe partitë, në fund të fundit, janë të vetmet institucione që legjitimohen me pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e përgjithshme, duke arsyetuar përfaqësimin dhe legjitimitetin e tyre përmes pjesëmarrjes së tyre në këto zgjedhje.

Zakonisht organizatat e shoqërisë civile nuk janë në gjendje të provojnë përfaqësimin e tyre real (përveç rastit kur kemi shoqata me mbështetës qartazi të përcaktuar). Gjithashtu atyre ju mungojnë strukturat, proceset, përvojat dhe personeli i nevojshëm për të ushtruar funksionet klasike të partive politike, të tilla si, - legjitimimi, përzgjedhja e kandidatëve, dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, qeverisja demokratike. Organizatat e shoqërisë civile nuk mund t’i zëvendësojnë partitë politike.

Megjithatë duhet nënvizuar se organizatat e shoqërisë civile ofrojnë një kontribut të madh në proceset politike dhe në stabilitetin e demokracisë në çdo shoqëri. Një numër i madh i organizatave të shoqërisë civile si dhe rritja e rëndësisë së tyre në të gjithë botën, dëshmon se praktikisht, një pjesë e rëndësishme e qytetarëve dëshiron të marrë pjesë në proceset politike. Mirëpo edhe në fushën e organizatave të shoqërisë civile mund të vërehen tendenca të ngjashme si ato të partive politike: janë dobësuar institucionet tradicionalisht të fuqishme, siç janë; sindikatat e punëtorëve, numri i madh i organizatave nuk është domosdoshmërisht dëshmi e ndikimit më të madh të tyre, por një indikator i ndarjes së tyre; shumë nga këto organizata nuk janë transparente dhe nuk i respektojnë rregullat demokratike në procedurat e tyre të brendshme; ato janë zakonisht të dobëta për sa i përket organizimit dhe rrallëherë i përmbushin marrëdhëniet afatgjate me anëtarët e tyre; shumë shpesh identifikimi me to është jetëshkurtër. Pra, demobilizimi i partive kompensohet vetëm pjesërisht nga organizatat e shoqërisë civile.

Organizatave të shoqërisë civile mund të kryejnë funksione të caktuara, të cilat vlejnë gjithashtu edhe për partitë. Megjithatë, ato nuk mund të përmbushin funksionin më të rëndësishëm të partive; - pjesëmarrjen në zgjedhjet e përgjithshme, funksion, i cili jo vetëm që u siguron partive prezantimin në pushtetin politik, por në të njëjtën kohë u siguron atyre përfaqësim. Në dallim nga kjo, përfaqësimi i organizatave të shoqërisë civile mbetet i paqartë edhe pse ato janë në gjendje të lëvizin turma të mëdha për raste të veçanta. Organizatat shoqërore mund të dëshmojnë mbështetjen e tyre të vërtetë në shoqëri vetëm nëse transformohen në parti politike.

3. 2. Partitë dhe grupet e interesit

Grupet e interesit janë një formë e veçantë e organizimit të shoqërisë civile. Ato organizojnë dhe i artikulojnë interesat shoqërore të individit qytetar, të grupeve shoqërore apo të organizatave të tjera shoqërore, siç janë: shoqatat e bizneseve apo sindikatat. Në kontekstin e krijimit të politikave institucionale dhe të strukturave vendimmarrëse ato ushtrojnë funksione të artikulimit të interesave dhe të ndërmjetësimit. Ato kryejnë funksione të ngjashme si partitë politike. Megjithatë, fokusi i tyre shtrihet në një sektor të veçantë, ndryshe nga përfaqësimi i përgjithshëm politik dhe territorial i partive.

Grupet e interesit karakterizohen nga tipare të veçanta organizative dhe funksionale, si dhe nga modele të veçanta të marrëdhënieve me aktorët

e tjerë në sistemin politik, institucionet shtetërore, në media dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme, - me partitë politike.

Pavarësisht se grupet e interesit kryejnë disa nga funksionet e partive, ato mund të dallohen nga partitë me anë të tri karakteristikave kryesore:

- Ato nuk e përfshijnë veten në gara politike për vende në parlament.
- Misionet, objektivat, programet, aktivitetet dhe fushat e tyre të interesit janë zakonisht të kufizuara në çështje të veçanta apo shqetësime të grupeve të veçanta shoqërore, kurse partitë në përgjithësi, synojnë për një qëllim më të përgjithshëm si edhe kryejnë funksionet e përfaqësimit dhe integritit të grupeve të ndryshme shoqërore.
- Ato janë më të lidhura me ato grupe, interesat e të cilave përfaqësojnë. Për shembull, organizatat e biznesit janë të orientuara nga interesat e korporatave anëtare si dhe përfaqësuesit e tyre; sindikatat përfaqësojnë interesat e punëtorëve dhe aktivitetin e tyre, i cili kryesisht ka të bëjë me fushat e negociatave për pagat dhe kushtet e punës; ndërsa organizatat e tjera fokusohen në çështjet shoqërore dhe kulturore apo në çështjet mjedisore, siç janë shoqatat për mirëqenie, të cilat fokusohen në ofrimin e shërbimeve shoqërore.

Grupet e interesit nuk janë kurrsesi homogjene, dhe dallojnë jo vetëm sipas fushës së interesit, por gjithashtu edhe për nga madhësia, struktura, baza e fuqisë, ndikimi i mundshëm, strategjitë e tyre etj.

Rëndësia politike e grupeve të interesit varion nga fushë-veprimi i organizatave. Megjithatë, në kuadër të disa organizatave të caktuara përpjekja për të ndikuar në debatet dhe vendimet politike është pjesë thelbësore e qëllimit të tyre. Në përgjithësi, grupime të tilla përpiqen të ndikojnë në favor të tyre në disa parti të caktuara, në debate dhe vendime politike. Kjo parimisht mund të jetë e ligjshme, por mund të ndikojë në balancimin e interesave të shoqërisë, ashtu edhe brenda interesave sektorialë, sidomos në raste të tilla kur grupe të fuqishme të interesit përdorin në funksion të qëllimit burimet e tyre, - paratë apo aftësinë për të mobilizuar masa të mëdha, - për të ndikuar përmes tyre në vendime politike në favor të tyre.

Partitë zakonisht janë të orientuara të adresojnë shqetësimet kryesore të grupeve të organizuara (sidomos kur ato janë qeveri). Në të njëjtën kohë ato vetë sillen si aktorë në procesin e politik-bërjes të partive të tjera. Duke

ushtruar funksione të ndryshme, partitë dhe shoqatat, në këtë mënyrë, i nënshtrohen kushteve të përbashkëta të veprimeve. Marrëdhëniet midis grupeve të interesit dhe partive politike varen nga roli që një parti konkrete luan në sistemin politik.

Mes partive dhe grupeve të interesit ekziston një marrëdhënie e varësisë reciproke. Grupimet kanë nevojë për akses tek partitë në mënyrë që të kenë një lidhje të drejtpërdrejtë me to në procesin e politik-bërjes, ndërsa partitë përkrahen nga këto grupime gjatë proceseve zgjedhore. Përveç kësaj, grupimet e tilla kanë mundësi paraprake në procesin legjislativ për të influencuar tek burokracia ministrore, e cila në anën tjetër varet edhe vetë nga informacioni i këtyre grupimeve. Lidhur me këtë proces ekzistojnë forma reciproke të ndërvarësisë.

Mundësia që shoqatat të bëhen të rëndësishme përcaktohen jo vetëm nga kapacitetet e tyre organizative, por edhe nga kapaciteti i tyre për të përfaqësuar interesat edhe përmes konflikteve. Për shembull ato mund të organizojnë greva apo të ushtrojnë forma të tjera të presionit. Efektiviteti i kërcënimeve të tilla është subjekt i situatave të caktuara në sistemin politik. Për shembull, nëse një ndryshim i preferencave partiake mund të sjellë kërcënim për mazhorancën në parlament, atëherë kjo rrethanë rrit ndikimin e grupeve të interesit.

Ndikimi i grupeve të interesit në procesin e vendimmarrjes duhet të monitorohet nga afër dhe është një temë e vazhdueshme e analizave të shkencave politike. Për shembull, në Gjermani, ku ekziston një numër i madh i shoqatave, shumë kanë frikë se “fuqia e shoqatave” është një kërcënim për sovranitetin e shtetit. Këto ndjenja frike rezultojnë të jenë kryesisht të pabaza. Studimet empirike mbi miratimin e disa ligjeve të veçanta dolën në përfundim se në procesin legjislativ nuk kishte dëshmi të ndikimit të ndonjë grupi të caktuar dominues interesi. Megjithatë, në Gjermani, si në shumë vende tjera, procesi legjislativ është i ndikuar drejtpërsëdrejti nga ndikimi i grupimeve specifike në fushat e tyre përkatëse të politikës. Në shumë raste, shoqatat e mëdha të bizneseve ushtrojnë më shumë ndikim se ato të voglat.

Politikanët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë çështje. Për shkak të marrëdhënieve të veçanta në mes të partive politike dhe shoqatave, gjithnjë ekziston problematika, se interesi sektorial mund të tejkalojë interesin shoqëror. Përmes politikës institucionale dhe sistemit politik, duhet të monitorohet rigorozikisht kërkesa për transparencë mbi rregullat përkatëse në lidhje me veprimtarinë e shoqatave¹².

4.

**Partitë
Politike në
Parlament
dhe në Qeveri**

Një parti politike i arrin qëllimet e saj kryesore kur ajo fiton përfaqësim parlamentar ose edhe pjesëmarrje në qeverisje. Pothuajse ajo “ia ka dalë”; përfaqësuesit e saj janë ulur në parlament, ndoshta edhe drejtojnë qeverisjen; për një afat të caktuar partia e ushtron pushtetin, gëzon privilegjet e lidhura me pushtetin dhe më në fund mund të favorizojë klientët e saj. Megjithatë, puna e “vërtetë” fillon vetëm me hyrjen e suksesshme në parlament. Në varësi nga numri i vendeve në parlament që fiton një parti, ajo mund të formojë koalicione, të bëjë marrëveshje për koalicione, të krijojë një program të qeverisjes, të përballet me probleme të panumërta dhe, së paku, të zgjidhë një pjesë të konsiderueshme të këtyre.

Zgjedhjet bëjnë të mundur përfaqësimin e partive në parlamentin kombëtar, në parlamentin rajonal dhe në qeverisjen lokale. Grupet parlamentare të tyre synojnë të votojnë me sukses në parlament të gjitha qëndrimet që një parti deklaron se përfaqëson. Suksesi i këtyre përpjekjeve varet shumë nga ajo, sesa i madh është grupi parlamentar i partisë, dhe për rrjedhojë, sa është forca e saj proporcionale në mandate, si dhe nëse ajo bën pjesë në qeveri apo në opozitë. Qeverisë i nevojitet mazhoranca e parlamentit dhe kjo është arsyeja përse qeveria dhe forcat aleate në koalicionin qeveritar punojnë ngushtësisht së bashku. Në anën tjetër, partitë opozitare e kontrollojnë qeverinë, dhe prezantojnë alternativat e tyre konstruktive me projektet e qeverisë dhe të partive qeveritare.

Në modelin klasik të ndarjes së pushtetit, ka një ndarje të qartë midis ekzekutivit (qeverisë) dhe legjislativit (parlamentit). Megjithatë, në praktikë, ky model nuk funksionon në formën e një ndarjeje rigoroze të të dy pushteteve, por më shumë funksionon në kuptimin e një gërshetimi apo një ndarjeje të detyrave.

Kjo në veçanti vlen për sistemin e qeverisjes parlamentare, ku dega ekzekutive varet shumë në mbështetjen e parlamentit. Ndërmjet qeverisë dhe parlamentit, gjë që nënkupton shumicën e përkrahësve të qeverisë në parlament, ka një ndërvarësi të ndërsjellë, e cila gjithashtu imponon

një nivel të lartë të miratimit dhe të unitetit. Pa këtë unitet është gati e pamundur të ketë një qeverisje efektive. Secila qeveri duhet të përpiqet të arrijë një shumicë të gjerë dhe të qëndrueshme në parlament, dhe nëse është sistem dydhomësh atëherë në të dy dhomat e parlamentit. Kjo praktikë gjithashtu zbatohet tek qeveritë e parlamenteve rajonale dhe lokale.

Vetëm opozita parlamentare ka interes primar të zërë qeverinë në pozitë të vështirë. Në të kundërt, partia qeverisëse zakonisht përmbahet nga kritikata në drejtim të qeverisë "së saj" apo nga shprehja e kritikave të detajuara në kontekstin e projekteve të parealizuara. Në shumicën e vendeve ka takime të rregullta koordinimi midis udhëheqësve të strategjive të partive drejtuese / në koalicion, midis kreut të qeverisë dhe anëtarëve të kabinetit për koordinim mes qeverisë dhe grupeve parlamentare, si dhe për përgatitjen e procedurave të votimit në parlament. Parlamentarët e partive qeverisëse shpesh janë të mirë-informuar mbi projektet në proces nga kontaktet e tyre jo formale me anëtarët e qeverisë.



4. 1. Grupet parlamentare

Përfaqësuesit e partive përbëjnë grupet parlamentare në Kuvend. Liderët e partive dhe të grupeve zakonisht krijojnë grupe të lidhura ngushtë dhe të unifikuara përmes bindjeve thelbësore politike. Edhe pse mund të ndodhin tensione politike, grupet parlamentare zakonisht janë të vendosur në vetëpërbajtjen e tyre ndaj çfarëdo mendimi të kundërt me partinë. Konfliktet e vazhdueshme midis një partie dhe grupit të saj ndodhin në raste të rralla. Shefat e grupeve (drejtuesit e një grupit parlamentar apo fraksioni) zakonisht kanë një ndikim të madh në partinë e tyre. Përveç detyrave të tyre parlamentare, ata gjithashtu duhet të kontribuojnë në zbutjen e tensioneve mes partisë dhe grupit parlamentar.

Në grup parlamentar janë të nevojshme dhe legjitime, solidariteti dhe disiplina. Megjithatë, nuk mund të ketë detyrim të përhershëm për të gjithë deputetët, në mënyrë që ata t'i binden udhëheqësit të partisë së tyre. Shumica e kushtetutave demokratike në botë e garantojnë "mandatin e lirë" të deputetëve. Forma si "vijat e detyruara", "urdhrat" apo "udhëzimet" e një partie ndaj deputetëve të saj janë jo kushtetuese. Si në të kaluarën edhe sot vetëm partitë komuniste kanë ushtruar masa shtrënguese ndaj anëtarëve të tyre të parlamentit. Në raste të tilla parlamentarët janë "ushtarët" e vërtetë të partisë së tyre.

Megjithatë, kufijtë midis disiplinës në një grup parlamentar dhe masave shtrënguese ndaj tij janë disi të paqarta edhe në partitë demokratike. Nëse një parlamentar synon të jetë sërish kandidat për në parlament, ai do të përkrahë kursin e grupit në mënyrë që të merret në konsideratë në listën e kandidatëve dhe të përkrahët nga partia në fushatën e tij. Puna e parlamentarëve në sesionet plenare, në komisione dhe në panele të tjera të parlamentit, në shumicën e vendeve, karakterizohet në mënyrë thelbësore nga orientimi politik i një partie.



Leadership Politik

5.

Partitë politike kanë nevojë për udhëheqje politike të fuqishme.

Përveç përpjekjeve në lidhje me organizimin e tyre, strategjitë politike, komunikimin dhe programet, për sukses të vazhdueshëm partitë politike duhet të kenë liderë/lidershipin e duhur politik, të cilët duhet të jenë tërheqës për qytetarët dhe votuesit. Liderët politikë udhëheqin procesin e formimit të mendimit politik dhe të vendimmarrjes, si dhe u japin legjitimitet vendimeve.

Që nga kohërat e lashta, mendimtarët politik janë interesuar në lidhje me cilësitë e nevojshme të një lideri të "mirë" politik. Këto ide kanë evoluar që nga "mbretërit filozofë" të Platonit, deri tek pragmatizmi i Makiavelit (gjithçka, që shërben për marrjen dhe mbajtjen e pushtetit, është e pranueshme), deri tek teoritë moderne mbi elitën dhe konkurrencën, të zhvilluara nga shkolla e njohur italiane e sociologëve, si Vilfredo Pareto dhe Gaetano Mosca, të cilët u shfaqen në epokën e politikës masive. Këtu, këto perceptime të ndryshme mbi udhëheqësit politikë, vetëm sa mund të përmenden, por jo të sqarohen gjerësisht.



Në demokraci, udhëheqësit politikë legjitimohen përmes zgjedhjeve për të kryer procesin e opinion-bërjes politike dhe të vendimmarrjes. Varet nga rrethanat politike se në çfarë mase ata janë në gjendje të shfrytëzojnë këto kapacitete. Sistemi i qeverisjes ka rëndësi (nëse është sistem presidencial apo sistem parlamentar), ashtu si edhe karakteri i qeverisë, - nëse është e mbështetur nga një parti apo nga një koalicion i partive, apo edhe formati i shtetit, nëse është shtet unitar apo federal, etj. Gjithashtu fuqia (apo dobësia) e grupeve të interesit, si sindikatat apo shoqatat e punëtorëve dhe roli i ushtrisë janë gjithashtu faktorë që ndikojnë në formën dhe kapacitetin e lidershit politik. Pa marrë parasysh këto rrethana, udhëheqësit politik, duhet, në formën më ideale, të demonstrojnë disa kapacitete të caktuara.

Disa nga këto kapacitete janë të listuara më poshtë:

Kapacitet e udhëheqësve politike

- Parimet etike dhe morale, si dhe synimet e qarta politike që udhëheqin veprimet e tyre (të cilat duhet të jenë transparente në demokraci). Ndershmëria dhe besueshmëria janë dy vetitë kryesore për lidership, si edhe përgjegjshmëria ndaj qytetarëve.
- Ekspertizë politike që të jetë në gjendje të vlerësojë dhe të përcaktojë çështjet e rëndësishme për procesin politik dhe pasojat e saj politike dhe shoqërore.
- Kapaciteti për menaxhim në mënyrë që të drejtojnë një organizatë të madhe, si dhe një kuptim i qartë i rrethanave mbizotëruese, në mënyrë që ai të jetë në gjendje të përshtatet siç duhet si dhe të përballet me sfidat e reja (shumë më e mirë është aftësia për t'i parashikuar ndryshimet)
- Ndjeshmëria dhe në rastin më të mirë, karizma, në mënyrë që të bindë dhe të mbledhë përkrahje të qytetarëve për vendimet politike, të cilat janë në proces zbatimi apo që tashmë janë përcaktuar.
- Faktorët personalë, gjithashtu, luajnë një rol specifik, siç është njohja e natyrës së njeriut, arsyetimi praktik, kontaktimi personal, aftësitë komunikuese dhe një qasje strategjike, mundësia që të marrë veprime të shpejta dhe të jetë i durueshëm etj.

Këto karakteristika janë kërkesat kryesore për të udhëhequr partinë nga brenda, si dhe jashtë saj, për të fituar përkrahjen e qytetarëve dhe të votuesve, si dhe për të ushtruar pushtetin politik.

Lidershipi politik përfshin shumë më tepër sesa njohurinë dhe kontrollin funksional mbi procedurat legjislative; në veçanti, udhëheqësit politikë kanë nevojë të ushtrorjnë nga njëra anë “ndjekjen e vazhdueshme dhe afatgjatë të koncepteve politike si dhe integrimin dhe bindjen e institucioneve dhe qytetarëve nga anë tjetër.”¹³

Në të njëjtën kohë, lidershipi politik kërkon fleksibilitet ndaj “formave të komplikuar të votimit”¹⁴. Pragu strategjik për partitë është rritur, ndaj duhet t'i adresohen grupeve të ndryshme të votuesve. Si rezultat i këtij ndryshim, liderëve politikë u kërkohet të jenë fleksibël lidhur me përmbajtjet e programet politike, por pa humbur përcaktimet kryesore të partisë së tyre, pasi kjo mund të frenojë votuesit tradicionalë të saj.

Çështja e lidershipit politik rishfaqet vazhdimisht, - jo më pak edhe në kohën e globalizimit, - kohë e cila ka efekte të konsiderueshme në organizimin e politikave kombëtare dhe, prandaj edhe në udhëheqësit e politikës kombëtare. Në përgjithësi mund të vërejmë se nevoja për lidership është rritur ndërkombëtarisht. Kjo është pasojë e presioneve të ndryshme të problemeve përballë të cilave është ekspozuar demokracia e përfaqësuar dhe liberale. Kjo u provua përsëri edhe gjatë krizës ekonomike të vitit 2008/2009. Në situata të tilla, kërkohet nga lidershipi politik që ai të marrë vendime me përgjegjësi demokratike.

Megjithatë, nuk është vetëm rritja e presionit politik, social dhe ekonomik që apelon për nevojën për lidership politik. Përmes efektit të saj të personalizimit, mediat masive gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në vlerësimin e individëve që kanë pozitat kryesore në parti apo në qeveri, duke i portretizuar ata si aktorët kryesorë të vendimmarrjes.

Interesimi i medieve lidhet edhe me përfitime personale nga ngritja e individëve në pozita të larta politike dhe ekzekutive. Kjo është në veçanti e lidhur me rritjen e nevojës për koordinim midis ekzekutivit në politikat sektoriale. Kryesisht kjo ndodh nëpërmjet formimit të një sistemi të ngjashëm me samitet e diplomacisë ndërkombëtare.

5. 1. Dilema të lidershipit politik

Roli i udhëheqësve politikë është diskutuar shumë herë në filozofi, në shkencë politike dhe në historiografi në kontekste të ndryshme kulturore. Sociologu Maks Weber, i cili e ka studiuar këtë temë në detaje, i fokusuar në veçanti në dilemat etike midis “etikës të qëllimeve përfundimtare” dhe të “etikës të përgjegjësisë”, me të cilat udhëheqësit politikë përballen herë pas here. Etika e “qëllimeve përfundimtare” i referohet një sjellje politike, e cila koncentrohet ekskluzivisht mbi pozitën etike dhe morale të aktorëve, pa marrë në konsiderim pasojat e veprimeve politike të bazuara në sjellje të tilla. Në anën e kundërt, “etika e përgjegjësisë” e konsideron një vendim politik gjithashtu të lidhur me pasojat etike dhe morale. Max Weber vjen në përfundim që udhëheqësit politikë demokratikë nuk duhet të udhëhiqet nga “etika e qëllimeve përfundimtare”, por nga etika e përgjegjësisë. Politika e përgjegjshme kërkon instinkt për pushtet, sens të përgjegjësisë dhe të masës, por gjithashtu kërkon edhe dedikim me plot pasion ndaj çështjeve të vetë-imponuara dhe jashtë interesave personale, si dhe kërkon karizëm që të jetë në gjendje të përmbushë nevojat emocionale të mbështetësve.

“Politika është një shpim i fuqishëm dhe i ngadaltë i dërrasave të forta. Ajo i kërkon të dyja, pasionin dhe perspektivën. Sigurisht, e gjithë përvoja historike e konfirmon të vërtetën, - që njerëzimi nuk do të realizonte të mundshmen nëse nuk do të kërkonte të pamundurën. Por, për të bërë këtë, personi duhet të jetë lider dhe jo vetëm një lider, por edhe një hero gjithashtu, në një kuptim maturues të fjalës. Madje edhe ata që nuk janë as liderë dhe as heronj duhet të pajisin veten e tyre me durimin e zemrës, e cila do të mund të trimërojë edhe shpresat e rrënuara. Kjo është e nevojshme tani ose përndryshe njerëzit nuk do të jenë të aftë që të arrijnë edhe atë që është e mundur sot. Vetëm ai ka talentin për politikë, ai i cili është i sigurt se nuk do të thyhet, kur nga këndi i tij i vështrimit bota është shumë e marrë apo shumë bazike për atë që ai dëshiron të ofrojë. Vetëm ai, i cili në përballje të kësaj situatë mund të thotë ‘në dritën e gjithçkaje’, vetëm ai e ka talentin për politikë” (Max Weber në esenë e tij të famshme “Politika si Profesione”) ¹⁵

Mësimet për lidërsnipin, nga Nelson Mandela

Nelson Mandela ishte një militant i shquar kundër regjimit të apartheidit në Afrikën e Jugut dhe për këtë, ai kaloi 27 vjet në burg. Pas liritimit të tij në vitin 1990 ai u zgjodh President i Republikës së Afrikës së Jugut (prej vitit 1994 deri në vitin 1999). Përvoja e tij



si një udhëheqës politik na ofron disa mësimet të rëndësishme, të cilat janë mbledhur si "8 mësimet e Mandelës mbi lidërsnipin"¹⁶

Guximi nuk është mungesa e frikës – është motivimi i të tjerëve për të lëvizur përtej saj.

Një lider nuk mund të shtiret se është i guximshëm, por ai nuk mund t'i lejojë njerëzit të njohin frikën e tij. Ai "duhet të vendosë një front". Përmes aktit të paraqitjes si i patrembur, Mandela ka frymëzuar të tjerët. Duke e ditur se ai është model për të tjerët kjo i ka dhënë forcë Mandelës që të triumfoj mbi frikën e tij.

Drejto nga fronti – por mos e lini prapa bazën tuaj

Një udhëheqës e merr bazën e tij përkrahëse me vete dhe pasi të arrijë në pozitë drejtuese, i lejon ata të vazhdojnë përpara.

Drejto nga prapa – dhe lejo të tjerët të besojnë se ata janë në front

Sekretari i lidërsnipit është të lejojsh vetveten që gjithashtu të udhëhiqet. Mandela ka thënë se është mençuri që t'i bindësh njerëzit të bëjnë gjëra dhe më pas t'i lejojsh ata të besojnë se ishte ideja e tyre.

Njihe armikun tënd – dhe mëso se cili është sporti i tij i preferuar

Një udhëheqës i kupton fuqitë dhe dobësitë e armiqve të tij dhe i formon taktikat e tij në varësi nga kjo. Ai e lidh vetveten me armikun e tij.

Mbaji afër miqtë – kurse rivalët mbaji edhe më afër

Mandela e ka çmuar besnikërinë, por nuk ka qenë kurrë i fiksuar me të, duke thënë, "njerëzit veprojnë sipas interesave të tyre". Mandela ka besuar

se përqaftimi i kundërshtarëve është një mënyrë e kontrollimit të tyre; ata janë më të rrezikshëm kur janë vetëm sesa brenda rrethit të tij të ndikimit. Ai e ka pranuar që rruga për tu përballur me personat, të cilëve nuk iu ka besuar, ishte neutralizimi i tyre me anë të sharmit.

Paraqitja ka rëndësi – por mos harro të buzëqeshësh

Mandela e ka kuptuar se si paraqitja e tij mund të ndihmonte kauzën e tij. Avokati i tij e kujton atë si Afrikan Jugori i parë i zi i veshur me kostum modern që ai kishte parë. Megjithëse nuk ishte një folës publik i mirë, ai gjithmonë ka bërë vallëzimin lokal toyi-toyi që ishte emblemë e luftës. Buzëqeshja e tij verbuese, e bekuar dhe gjithëpërfshirëse “ishin mesazh”; - për jug-afrikanët e bardhë mungesa e zemërimit të tij; për votuesit e zi ai ishte luftëtari i lumtur dhe tregues se ai do të triumfojë.

Asgjë nuk është bardh apo zi

Jeta nuk është kurrë “ashtu ose kështu”. Vendimet janë komplekse dhe ka gjithmonë faktorë konkurrues. Është tendencë e trurit njerëzor që të kërkojë shpjegime të thjeshta, por kjo nuk korrespondon me realitetin. Mandela ndihet rahat me kontradiktat. Si politikan, ai ishte një pragmatist që e pa botën me shumë nuanca. Llogaritja e tij ishte gjithmonë: “cili është përfundimi që unë e kërkoj?” dhe “cila është rruga më praktike për të arritur aty?”

Edhe dorëheqja tregon lidërsip

Mandela e ka pranuar me përlësi se të dish sesi të braktisë një ide, detyrë apo marrëdhënie të dështuar është shpesh vendimi më i vështirë që një udhëheqës duhet të bëjë. Trashëgimia e tij më e madhe si president i Afrikës së Jugut ishte mënyra sesi ai vendosi të largohet. Njeriu që i dha jetën vendit të tij refuzoi që ta mbajë atë peng. “Puna e tij ishte që të vendos kursin, jo të drejtojë anijen.” Ai e dinte se udhëheqësit drejtojnë gjatë nga ajo që ata zgjedhin të mos e bëjnë sesa me atë që e bëjnë.


Parimet e Rudy Giulianit për lidërsipin politik

Rudi Giuliani ka qenë një kryetar i suksesshëm i New York-ut (1994-2001) dhe është bërë i njohur botërisht për aftësinë e tij për të menaxhuar krizat pas sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001. Ai gjithashtu ka arritur të përmirësojë imazhin e qytetit, i cili ishte i karakterizuar si qytet i paqeverisshëm për shkak të problemeve ekonomike dhe dhunës kriminale. Edhe pse nuk pati sukses me kandidaturën presidenciale në vitin 2008, ai ka formuluar disa parime për lidërsipin politik, të cilat mund të merren në konsideratë nga udhëheqësit politik. Parimet e mëposhtme janë marrë nga libri i Rudy Giulianit “Lidërsipi”.

1. Duhet të dini në çfarë besoni, çfarë mbroni, çfarë është e rëndësishme për ju dhe se cili është qëllimi juaj.

2. Për të qenë lider duhet të jesh optimist

Duhet ta njohësh problemin dhe të dish si ta kalosh me optimizëm. Duhet të jeni në gjendje të "ëndërroni" për një situatë më të mirë dhe ta zgjidhni në atë mënyrë. Udhëhiqni njerëzit me shpresë dhe jepini atyre shpresë se, ajo çfarë ata janë duke bërë tani, mund të bëhet realitet. Duhet të bëheni personi më i qetë në dhomë kur jeni në një situatë emergjente. Kjo ju ndihmon që të kuptoni zgjidhjen më të mirë për situatën.



3. Që të bëheni udhëheqës duhet të keni guxim të merrni rrezikun përsipër

4. Përgatitja e vazhdueshme - zvogëlon rrezikun

Gjithmonë parashikoni skenarët e mundshëm, megjithëse, pa marrë parasysh sesi ju përgatiteni dhe si e parashikoni, gjithmonë do të ketë diçka që mund të ndodh dhe për të cilën ju nuk jeni përgatitur. Menaxhimi i krizave është shumë i rëndësishëm, sepse ndihmon në reduktimin e gjërave për të cilat ju nuk jeni i përgatitur.

5. Puna në ekip

Një nga gabimet e mëdha që një udhëheqës mund të bëjë është të mendoj se ai apo ajo janë të pagabueshëm. Cilat janë dobësitë e mija? Si mund të gjej njerëzit që mund të më ndihmojnë mua të kompensoj dobësitë e mija?

6. Për të qenë një udhëheqës i mirë duhet të komunikoni

Bëhu njëherësh i dyfishtë: një mësues dhe një motivues. Nuk është e mjaftueshme të dish se çfarë do të bësh, por duhet edhe të jesh në gjendje ta komunikosh atë. Nëse e keni qëllime me ndikim të gjerë, duhet të keni standarde (statistika) që të dini nëse keni arritur aty. Por statistikat nuk janë të mjaftueshme: duhet të dini se si të kujdeseni për njerëzit.



**Sfidat për
Partitë Politike
në Sistemet
Demokratike**



6.

Demokracia ka pamje të ndryshme në çdo shtet dhe në çdo shoqëri.

Forma konkrete e rendit demokratik varet nga historia, tradita, dhe kultura kombëtare si dhe nga veçoritë shoqërore, etnike dhe fetare të një shoqërie, potenciali i saj ekonomik, peshë e faktorëve rajonalë, etj. Megjithatë, ekzistojnë disa elemente bazë, të cilët duhet të jenë të pranishme në çdo sistem demokratik.

Elementet themelore të demokracisë

- organet qeverisëse duhet të përbëhen nga autoritete të zgjedhura, të cilët janë përgjegjës para zgjedhësve.
- zgjedhjet e lira dhe të ndershme duhet që të bëhen rregullisht.
- të gjithë të rriturit duhet të kenë të drejtën për të votuar dhe për tu zgjedhur në poste politike.
- liria e mendimit duhet të mbretërojë dhe askush nuk duhet të përndiqet për shprehjen e mendimit të tij të lirë.
- aksesit i lirë në burime alternative dhe pluraliste të informacionit duhet të garantohej.
- e drejta për të formuar shoqata, grupe të interesit dhe parti politike duhet të ekzistojë në mënyrë që të drejtat e përmendura më lart të mund të realizohen.

Pavarësisht organizimit të demokracisë në vende të ndryshme, demokracia ka nevojë për institucione që sigurojnë konsolidimin e saj, stabilitetin dhe projektimin, dhe që mbrojnë demokracinë e "reja" nga kontestimi apo nga pengesat e mëdha. Shansi për stabilizim dhe konsolidim të demokracisë varet shumë nga mënyra se si janë institucionalizuar rregullat specifike demokratike dhe, nga niveli i potencialit që ofrojnë institucionet demokratike për të përmbushur sfidat e ndryshimeve politike dhe sociale, si dhe sesi ato sigurojnë legjitimitet në sistemin politik.

Pa marrë parasysh sesi demokracia është organizuar në çdo formë individuale apo në çdo sistem politik, partitë politike janë institucionet kryesore të demokracisë. Pa parti politike nuk mund të ketë demokraci.

Funksionet themelore të partive politike tashmë janë shtjelluar. Megjithatë, partitë nuk kanë monopol në kryerjen e këtyre funksioneve dhe, në ditët e sotme, më shumë se në të kaluarën, - janë në konkurrencë me organizatat e tjera, të cilat gjithashtu kryejnë këto funksione të paktën në fusha të caktuara, dhe që mbi këtë bazë ato konkurrojnë me partitë. Për këtë arsye, karakteristika thelbësore që identifikon një parti është dhe mbetet pjesëmarrja e saj në zgjedhje.

Edhe pse partitë përmbushin funksionet e tyre thelbësore për sistemin politik dhe demokracinë, ato gjithashtu përballen me sfida të veçanta në demokracitë moderne. Ndryshimi social dhe efikasiteti (ose joefikasiteti) i përballjes me pasojat e ndryshimit në fushën e politikës janë arsye të kryesore në këto sfida të reja për partitë politike.

- Një dilemë klasike për partitë politike është pamundësia për të përmbushur në të njëjtën kohë të gjitha pritshmëritë ndaj tyre. Pasi ato zënë postet vendimmarrëse politike, qytetarët presin propozime dhe vendime për problemet dhe kërkesat e tyre. Grupe të ndryshme, megjithatë, do të ndjehen gjithmonë jo të avantazuara ose do të paraqesin kërkesa të reja, të cilat zakonisht nuk janë asnjëherë tërësisht të realizueshme. Dikush mund të mendojë për pritshmërinë se shteti duhet të sigurojë të mirat publike dhe në të njëjtën kohë, edhe sigurinë e brendshme dhe të jashtme, edhe një rrjet rrugor të zhvilluar, edhe shkolla publike, spitale dhe qendra strehimi publike ose edhe përfitime pa rritur taksat dhe pa e rritur borxhin kombëtar. Pra partitë, kapen në marrëdhënie të vazhdueshme konfliktuale ndërmjet pritshmërive të papërmbushura dhe zgjidhjeve që perceptohen të papërshtatshme.

- Një numër sfidash të reja shfaqen nga ndryshimi social dhe nga zhvillimi i shoqërive të fragmentuara, sfida, të cilat janë të karakterizuara nga shpërndarja e ambienteve tradicionale, erozioni i sistemeve të vlerave të qëndrueshme të mëparshme dhe premtimet e bazë në të, niveli më i lartë i arsimimit, pluralizmi i burimeve informative, si dhe organizimi individual i marrëdhënieve personale. “Zhvendosja e vlerave”, “individualizimi”, “veprimtaria shoqërore”, dhe “fragmentimi i interesave” janë nocione për të përshkruar fenomene sociale që reflektohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në qëndrimin e qytetarëve kundrejt partive politike. Kur marrëdhëniet shoqërore humbin, angazhimi me partitë politike gjithashtu bëhet më i dobët. Partitë e ndjejnë këtë efekt jo vetëm me anë të rënies së anëtarësisë, por gjithashtu edhe me rënieën e votuesve dhe zonave të qëndrueshme zgjedhore, mjedisin elektoral të paparashikueshëm si dhe rezultatin e zgjedhjeve.
- Ndryshimi në mediat masive dhe në mënyrën e raportimit, rritja e konkurrencës për vëmendje dhe audiencë, si dhe zgjerimi i gazetarisë “hulumtuese”, kanë çuar në një formë të re të raportimit për politikën, në të cilën idetë, vlerat dhe rezultatet janë më pak të rëndësishme se emocionet, morali, skandali dhe personaliteti në formën e një emisioni “informativ-argëtues”. Skandalet politike,



sjelljet personale dhe sjelljet jo korrekte të politikanëve bëhen të njohura me shpejtësi të madhe në ditët e sotme. Kjo është, sigurisht, një rritje e dukshme e transparencës dhe e kontrollit demokratik, por gjithashtu, mund të kontribuojë në zhgënjimin qytetar dhe nganjëherë, edhe në degradimin e politikës dhe aktorëve të saj. Të parët që ndjejnë pasojat negative për këtë janë vetë partitë politike.

- Dilema “moderne” e partive politike buron nga globalizmi. Në nivel kombëtar, globalizmi dhe pasojat e tij kanë ulur hapësirën për manovra politike dhe kanë zhvendosur fuqinë e vendimmarrjes dhe aftësinë e menaxhimit tek lojtarët mbinacionalë dhe ndërkombëtarë. Edhe pse qytetarët presin që aktorët politikë kombëtarë të vendosin mbi kërkesat dhe pritshmëritë e tyre, çështje të rëndësishme nuk mund të zgjidhen më nga vendimmarrësit politikë kombëtar. Si pasojë, partitë politike përballen me një humbje të besimit në aftësinë e tyre për të vendosur mbi çështje të rëndësishme me interes kombëtar.

Këto zhvillime kanë pasojat serioze për partitë dhe sistemet partiake:

- Në ditët e sotme sistemet partiake janë më të prira për modifikime dhe janë më të fragmentuara.
- Koha e partive të mëdha popullore duhet të ketë përfunduar. Të paktën, edhe pse disa parti mund të kenë anëtarësime të mëdha, sot është shumë e vështirë të organizohen mitingje masive.
- Monopoli virtual i partive në të kaluarën, si burim dhe vend për informacione politike dhe reflektim është humbur në epokën e sotme të mediave masive, të teknikës moderne të informacionit, të tilla, si interneti dhe të aspekteve alternative për pjesëmarrje politike jashtë partive.
- Partitë e kanë shumë të vështirë të mbajnë të ashtuquajturit votues besnikë në zona të caktuara dhe në periudha afatgjata.
- Niveli i përgjithshëm i besimit të qytetarëve në parti dhe në politikanë ka rënë dhe gatishmëria për t'u angazhuar politikisht ka rënë, veçanërisht në mesin e të rinjve.

- Mediat masive publikojnë raporte rreth skandaleve politike dhe mangësitë e vërteta apo të supozuara të partive dhe liderëve më të lartë për të menaxhuar dhe për të zgjidhur probleme. Në të njëjtën mënyrë, siç janë rritur vështirësitë e menaxhimit politik në epokën e globalizmit financiar, politik ose ekologjik, gjithashtu janë rritur mundësitë teknike për raportim kritik. Rritja e konkurrencës në mesin e kanaleve televizive dhe mediave të shkruara ka kontribuar edhe me tendencën për të raportuar më shumë rreth gabimeve reale apo të supozuara të politikanëve.
- Rolet përkatëse të luajtura në të kaluarën nga partitë qeverisëse dhe atyre të opozitës nuk janë më aq të qarta, pasi partitë e mëdha opozitare jo detyrimisht përfitojnë nga pakënaqësitë e votuesve, por në vend të kësaj, ato humbasin votat për partitë e vogla apo partitë e reja që burojnë nga lëvizjet protestuese.

Megjithatë, nuk janë vetëm partitë që preken nga zhvillimet e fundit të shoqërisë. Në fakt, ekziston edhe një humbje e përgjithshme e besimit në institucionet e tjera dhe organizata të mëdha shoqërore, të tilla si sindikatat e punëtorëve. Megjithatë, ndryshimet reflektohen sidomos te partitë, pasi ato janë më së shumti të ekspozuara ndaj perceptimit publik. Këto zhvillime që përfshijnë dobësimin e partive të veçanta nuk janë domosdoshmërisht një krizë e demokracisë, por tregojnë kalimin në një



formë tjetër të demokracisë, në të cilën partitë ende mund të përmbushin funksionet e lartpërmendura, por organizatat e tjera shoqërore, si dhe media, kanë më shumë ndikim në procesin e ndërtimit të opinionit politik sesa në periudhat e mëparshme kohore.

Përkundër kësaj humbje të ndikimit kundrejt lojtarëve të tjerë, një faktor thelbësor nuk ka ndryshuar: partitë janë ende institucione, nga të cilat priten propozimet dhe zgjidhjet për adresimin e problemeve të shoqërisë, kur ato marrin pushtet në organet vendimmarrëse politike. Gjithashtu partitë janë institucionet e vetme që marrin pjesë në zgjedhje dhe përfaqësimi i tyre matet nga rezultatet e zgjedhjeve.

Dobësimi dhe fragmentimi i sistemeve partiake në terma të përgjithshëm është problematik, sepse nuk ka asnjë alternative për shtetin partiak demokratik. Shoqatat, iniciativat e qytetarëve dhe lëvizjet sociale mund të jenë rritur në numër, por ndikimi i tyre politik duhet të rritet ende. Ky zhvillim është pjesërisht tregues i konsolidimit të demokracisë. Megjithatë, me të gjithë legjitimitetin e shqetësimeve mbi organizata të tilla, rritja e ndikimit të tyre ka gjithashtu aspekte problematike, sepse ato nuk mund të mbështetën përfaqësimin e tyre dhe të adresojnë të gjitha kërkesat e publikut. Vetëm partitë mund të legjitimojnë veten e tyre përmes zgjedhjeve demokratike.

Fuqia e mediave gjithashtu po vazhdon të rritet. Megjithatë, duke marrë parasysh konsolidimin e shtypit dhe të kompanive televizive, si dhe dominimin e disa kompanive të IT-së ky evolucion duhet të shoqërohet me një zgjerim të kontrollit demokratik dhe të transparencës, gjë që është e mundur vetëm brenda kontekstit të institucioneve të demokracisë përfaqësuese.

6. 2. Kriteret për qëndrueshmëri dhe sukses të rolit të partive

Partitë vazhdimisht duhet të përpiqen të kryejnë funksionet e tyre edhe në kushtet e ndryshimit të rrethanave shoqërore. Pavarësisht nga veçantitë shoqërore rajonale dhe kombëtare ose të sistemit elektoral dhe qeverisë, ekzistojnë disa kritere që çdo parti duhet t'i respektojë dhe t'i përmbushë, në mënyrë që ajo të marrë pjesë me sukses në garën politike¹⁷.

- Një parti ka nevojë për një bazë elektorale të mjaftueshme dhe të identifikueshme. Ajo duhet të përpiqet që të thellojë lidhjet me grupet zgjedhore dhe të interesit që dëshiron t'i përfaqësojë, natyrisht, në përputhje me vlerat themelore dhe profilin e saj programor.
- Një parti duhet që të ketë një organizim të gjerë, në mënyrë që të krijojë afërsi me qytetarët dhe të jetë e aftë për të mobilizuar votuesit.
- Një parti duhet të ndërtojë një organizatë të hapur për anëtarësim. Anëtarësimi është thelbësor për përzgjedhjen e udhëheqësve të saj të ardhshëm dhe duhet të jetë element me rëndësi për mbështetjen e saj financiare. Një organizatë aktive për anëtarët kërkon demokraci brenda partisë, d.m.th që anëtarët të marrin pjesë politikisht dhe të jenë në gjendje të përcaktojnë lidhshipin e partisë, si dhe të caktojnë kursin politik të partisë.
- Një parti duhet të komunikojë, si brenda ashtu edhe jashtë saj. Ajo ka nevojë për një sistem funksional të brendshëm për të gjitha nivelet e saj dhe database në të gjitha nivelet dhe për të gjithë anëtarët e saj. Gjithashtu është e nevojshme një lidhje e vazhdueshme me mediat. Ata janë "kujdestarë" të sistemit politik në zhvillimin e demokracisë mediatike, duke gjeneruar vetëdije publike.
- Një parti duhet të zhvillojë profilin e saj programatik, duke bërë dallimin e saj nga të tjerët, duke formuluar objektivat dhe mënyrat e zgjidhjes dhe mbajtjes e problemeve reale të kohës. Qëllimi i programit të punës është që t'i mundësojë partisë integrimin e pritshmërive dhe kërkesave publike, si dhe të promovojë identifikimin e partisë nga qytetarët.
- Një parti duhet të jetë në gjendje të tregojë një shkallë të lartë të qeverisjes së brendshme të saj. Kjo është aftësia për të gjetur një balancë midis natyrës së saj të bashkuar përballë publikut dhe dialogut të brendshëm kundërshtues. Pjesë e kësaj qeverisjeje brenda-partiake është përzgjedhja dhe mbështetja e brezave të rinj të anëtarëve të partisë dhe e liderëve të partisë.

- Një parti duhet që të jetë e aftë të integrohet. Ky është çelësi i vërtetë i suksesit dhe i rritjes së një partie. Kjo nënkupton përpjekjet konstante për zgjerimin e bazës së saj elektorale, fitimin e votuesve të rinj që kanë interesa të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të jetesës, si dhe për të ndërtuar një lidhje të vazhdueshme me këta votues.
- Një parti duhet të jetë në gjendje të kryejë fushata elektorale. Ajo duhet të jetë në gjendje të paraqesë në mënyrë efektive në publik tema të rëndësishme dhe profilin e saj politik, si dhe duhet të udhëheqë fushata zgjedhore të suksesshme me disa tematike thelbësore dhe një mesazh të qartë për “komunikim të fokusuar”.
- Një parti duhet të jetë në gjendje që të formojë koalicione. Për shkak se është e vështirë për një parti, veçanërisht në sisteme të caktuara konkurruese, - për të marrë shumicën absolute në parlament, - një parti duhet që të jetë në gjendje të formojë koalicione të qëndrueshme me parti të tjera që të demonstrojnë aftësi qeverisëse. Problemet e mirëqeverisjes reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë reputacionin e partive. Në formimin e koalicioneve mund të jetë i nevojshëm kalimi i përçarjeve të thella programatike/ose personale. Ky është një moment ku liderët politikë mund të tregojnë aftësitë e tyre.



- Një parti duhet që të dëshmojë aftësitë qeverisëse të saj dhe kapacitetin për zgjidhjen e problemeve në nivel lokal. Në të gjitha vendet, qytetarët duhet që të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me palët dhe përfaqësuesit e tyre në politikën lokale. Vetëm nëse partitë mund të dëshmojnë kompetencë dhe lidhje të afërta me qytetarët në këto nivele, ato mund të presin të fitojnë besim edhe në nivel kombëtar.
- Një parti duhet të jetë e aftë për të kuptuar pritshmëritë dhe zbatimin e programeve politike, për të plotësuar kërkesat brenda shoqërisë. Duke marrë parasysh rritjen e rëndësisë së organizatave shoqërore jo-qeveritare dhe grupeve të interesit, partitë duhet të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të qenë në kontakt me këto organizata ndërmjetëse, për të kuptuar pritshmërinë e njerëzve, dhe për t'i përkthyer ato në politika.

**Konkluzion:
nuk ka
Demokraci pa
Parti Politike**

7.

Pavarësisht dobësive të partive dhe sfidave me të cilat partitë duhet të ballafaqohen, një gjë mbetet e sigurtë: pa parti politike nuk mund të funksionojë demokracia. Në demokraci partitë vijnë të jenë hallka më e rëndësishme lidhëse midis shtetit dhe shoqërisë. Megjithatë, ato duhet të përshtaten me ndryshimet shoqërore, në mënyrë që të mbijetojnë me sukses në rrethana të reja.

Formimi i mendimit politik dhe i konsensusit në demokracinë masive është pafundësisht i mundimshëm, pjesërisht i pakënaqshëm dhe një proces vazhdimisht i rrezikuar, duke përfshirë edhe mungesën e gjallërisë në jetën e përditshme të komiteteve, komisioneve dhe të kuvendeve. Formimi i mendimit politik, ndërtimi i konsensusit dhe i qeverisë në të mirë të gjithë shoqërisë nuk mund të anashkalojë ose të jetë kundër partive politike, por realizohet vetëm duke i përfshirë ato. Aq sa janë të nevojshme iniciativat qytetare dhe lëvizjet sociale për ndryshim politik, opozita dhe kritikën tek e fundit varen shumë nga partitë, të cilat kryejnë funksione afatgjata dhe duhet të përballen me qytetarët periodikisht në kontekstin e proceseve zgjedhore.



Konrad Adenauer

Partitë kryejnë rolin e një udhëheqësi politik për shkak se në një demokraci moderne nuk mund të bëjnë pa to. Veçanërisht në kohën e ndryshimeve ky leadership politik duhet që të jetë i përgjegjshëm dhe i dukshëm për qytetarët lidhur me interesat dhe kërkesat e tyre. Ashtu siç ka theksuar Konrad Adenauer, Kancelari i parë dhe Kryeministri i Republikës Federale të Gjermanisë pas Luftës II Botërore: “çdo parti politike ekziston për të mirën e njerëzve dhe jo për veten. Partive politike, anëtarëve të saj dhe udhëheqësve të tyre u kërkohet më shumë se kurrë të përballen me këtë përgjegjësi.”

Partitë Politike në Shqipëri

8.

Partitë politike janë një institucion thelbësor dhe i pazëvendësueshëm për jetësimin e demokracisë, baza mbi të cilat ngrihet dhe funksionon pluralizmi politik. Ato jetësojnë procesin përfaqësues dhe legjitimues, janë subjekt kushtetues, kanë nivel të lartë mobiliteti qytetar dhe aftësi udhëheqjeje, si dhe ndikojnë në formësimin e funksionimit demokratik të shoqërisë dhe shtetit. Përmes programeve politike, kandidatëve, garës elektorale dhe pjesëmarrjes aktive ato ndihmojnë në përmbushjen e parimit kushtetues të qeverisjes së bazuar në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike. Partitë përfaqësojnë alternativa dhe ofrojnë zgjidhje të ndryshme të problemeve për qytetarët, shoqërinë dhe shtetin.

Historia e partive politike dhe sistemit partiak në Shqipëri ndahet në pesë faza: periudha e parë formësimit të shtetit dhe sistemit përfaqësues (1920-1924), periudha e qeverisjes pa parti politike (1925-1939), periudha e partive politike të luftës (1939-1944), periudha e sistemit njëpartiak (1944-1990), si dhe periudha e vendosjes dhe funksionimit të pluralizmit politik (pas 1990 dhe në vijim). Periudha e fundit karakterizohet nga nënndarje që lidhen me formësimin e partive, pluralizmit dhe sistemit konkurrues politik (1991-1995), periudha e transformimit programor dhe organizativ të partive politike (1996-2005), si dhe periudha e kalimit të partive nga modeli i partive popullore në modele "presidencialiste" dhe elektorale (pas 2005 dhe deri më sot).

Në fazën e parë historike partitë politike ndryshonin shumë nga modelet e sotme partiake: ato ishin më shumë bashkime individësh rreth një pikëpamje politike ose projekti politik sesa institucione me organizim të qëndrueshëm, me struktura të zgjedhura dhe me aktivitet të rregullt partiak. Duke mos pasur identitet programor apo ideologjik, strukturë dhe aktivitet funksional, dy partitë e para politike, Partia Përparimtare dhe Partia Popullore u shpërbënë më 1923, duke ia lënë vendin dy partive të reja të mëdha dhe disa partive më të vogla lokale. Në këtë fazë nevoja për demokraci funksionale injoroi nevojën për stabilitet politik. Zgjedhjet politike 1921 dhe 1923 ishin zgjedhjet e vetme politike të shekullit të kaluar në Shqipëri, bazuar në konkurrencë midis partive dhe platformave të ndryshme politike.

Në fazën e dytë (1925-1939) Shqipëria kaloi nga sistemi monarkist në republikë dhe më pas, nga republika në monarki, duke eksperimentuar në dy rastet me sisteme pa parti politike. Organizimi politik u ndalua me ligj, zgjedhjet periodike bazoheshin në konkurrencën midis individëve. Në këtë fazë nevoja për stabilitet injoroi nevojën për demokraci funksionale.

Në fazën e tretë (1939-1944) Shqipëria ishte e pushtuar, por lëvizjet politike në shoqëri krijuan disa parti politike, të dominuara nga organizimi dhe agjenda ushtarake. Ato ishin Partia Komuniste, Balli Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, si dhe disa grupime të vogla. Dallimet programore ishin ideologjike dhe kishin të bënin me pasluftën dhe çështjet kombëtare. Nevoja për luftën dhe kontrollin e pushtetit pas saj injoroi rregullat e funksionimit dhe dominoi konfliktin e ashpër politik dhe ushtarak mes tyre.

Në fazën e katërt (1944-1990) sistemi qeverisës bazohej në modelin e partisë – shtet, një parti e vetme dominuese në çdo aspekt të organizimit shoqëror e shtetëror. Praktikrat e funksionimit të saj minuan edhe elementët e traditës demokratike dhe e personalizuan shtetin në funksion të diktatorit. Ky model përbën rastin e vetëm kur emri dhe ideologjia e një partie (Partia e Punës së Shqipërisë, PPSH), sanksionohen si subjekt dhe parim kushtetues.

Në fazën e katërt, nga 1990, kur u lejua pluralizmi politik lindën dhe kryen aktivitetet rreth 126 parti politike, por vetëm 3-4 parti politike ruajtën përfaqësim të rregullt parlamentar në zgjedhje. Pjesa më e madhe e partive politike është fiktive, shumica absolute e tyre veprojnë si parti elektorale, vetëm në periudhën e fushatave, si dhe në tërësi ato kontrollohen nga themeluesit e tyre, pra identifikohen me emrin e individit krijues të tyre.

Në fillim të viteve '90 dhe gjatë dekadës së parë të tranzicionit partitë dominuese në jetën politike ishin PS (Partia Socialiste) dhe PD (Partia Demokratike). Disa parti të vogla politike arritën suksese të pjesshme zgjedhore por pa arritur të shndërrohen në parti relevante me ndikim në krijimin dhe ndryshimin e qeverive/mazhorancave. Në dekadën e dytë të tranzicionit sistemi partiak u shndërrua në dy plus një (2+1), ku një parti e tretë, LSI (Lëvizja Socialiste për Integrim) mbetet në dy legjislatura partneri kryesor i dy partive tradicionale në krijimin e shumicave parlamentare.

Gjatë viteve 1991-1995 partitë politike bënë përpjekje të mëdha për të jetuar pluralizmin politik, - morën pjesë rregullisht në zgjedhje, zhvilluan aktivitet permanent politik, dominuan jetën politike, zhvilluan zgjedhje të brendshme, ndryshuan programe dhe struktura, krijuan partneritete

të reja ndërkombëtare, si dhe u orientuan nga koncepti i reformave në sistemin qeverisës, në shtet dhe në vetë partitë politike. Gjatë viteve pasuese (1996-2005) partitë politike u karakterizuan nga procese intensive brenda tyre, pati konkurrencë dhe fraksione të ndryshme, brenda tyre u kryen ndryshime strukturore dhe organizative, vendimmarrja politike dhe pritshmëria publike kaluan nga selitë politike tek parlamenti, partitë krijuan profile ideologjike dhe identitete konkurruese. Gjatë periudhës pasuese (nga 2005) dhe sidomos vitet e fundit partitë politike kryesore kanë pësuar ndryshime thelbësore në identitetin, aktivitetin dhe raportet e tyre me shoqërinë, - ato kanë marrë gjithnjë e më shumë tipare presidenciale, me vendimmarrje vertikale, janë të prirura të funksionojnë si parti elektorale dhe kanë ngushtuar në maksimum diferencat midis tyre në identitetin, ideologjinë dhe programin politik.

Partitë politike janë subjekte kushtetuese (Kushtetuta e RSH, 1998), veprojnë sipas ligjit organik mbi partitë politike (2000, ndryshuar më 2011 dhe 2014). Në Shqipëri ligji ndalon partitë politike që kanë organizim të brendshëm në kundërshtim me parimet demokratike, që janë krijuar jashtë territorit shqiptar, që kanë qëllim përdorimin e dhunës për marrjen e pushtetit, që nxisin ose përkrahin urrejtjen fetare, krahinore ose etnike, që mbështeten në metoda totalitariste, etj. E vetmja parti e ndaluar me ligj pas vitit 1990 është Partia Komuniste (1992) për shkak se Dispozitat Kryesore Kushtetuese ndalonin partitë me bazë ideologjike komuniste dhe enveriste. Me Kushtetutën 1998 kjo dispozitë është hequr. Përpara vitit 2000 ndaloheshin edhe partitë fetare dhe lokale, me legjislacionin e ri mbi partitë, ato lejohen.

Partitë kryesore politike kanë arritur të anëtarësohen në familjet partiake në nivel evropian (Partia Popullore Evropiane dhe Partia Socialiste Evropiane, etj), për shkak të legjislacionit zgjedhor tendenca e shumicës absolute të partive është konkurrimi në koalicion me njërin nga dy partitë e mëdha, si dhe vitet e fundit ka pasur dhe vijon të ketë përpjekje për krijim të partive të reja politike, kritike me nivelin e deritanishëm përfaqësues të partive tradicionale. Në sondazhe të ndryshme mbështetja publike e partive politike ka rënë ndjeshëm (nga 75% më 1992 në 15% në 2015), dhe se partitë vijnë të ruajnë dominimin mbi vendimmarrjen politike, mbi sistemin përfaqësues, mbi promovimin në administratën publike dhe në poste drejtuese publike, si dhe mbi jetën politike dhe debatin në shoqëri.

8. 2. Partitë politike më të rëndësishme në Shqipëri

Në Shqipëri, ndryshe nga shumica e vendeve të rajonit të Evropës Juglindore, nuk ka problematikë etnike dhe as fetare me ndikim edhe në profilin dhe aktivitetin e partive politike. Në dallim nga Kosova, Bosnja, Maqedonia, Mali i Zi, etj, partitë në Shqipëri janë parti kombëtare, konkurrojnë në çdo zonë dhe për çdo votë. Bazuar në rezultatet zgjedhore partitë e mëdha kanë pasur dominim permanent në zona bastioni në jug dhe veri, tregues që i përgjigjet origjinës krahinore të liderëve politikë dhe jo identitetit social e partiak të votuesve. Në fillimet e tyre partitë politike premtinin sjellje të ndryshme nga modeli i trashëguar i partisë – shtet, por përgjatë viteve ato reflektuan mentalitete e akte me ndikim nga formimi i asaj trashëgimie.

Në dallim nga premtimi dhe prishmëria për parti me natyrë qytetare, partitë shqiptare bazohen kryesisht tek militantët besnikë dhe klientela elektorale. Ato nuk kanë dallime në çështje thelbësore siç janë interesat kombëtarë, përcaktimi pro perëndimor, mbështetja e reformave të integritimit në BE dhe NATO, natyrën laike të shtetit, marrëdhëniet me fqinjët, zhvillimi ekonomik dhe reformat strukturore. Fillimisht ka pasur dallime të dukshme lidhur me proceset e privatizimit, rolin e shtetit në ekonomi, çështjet e pronësisë mbi tokën, reformat arsimore, shëndetësore, sociale, etj. Gjatë dekadës së fundit këto dallime janë minimizuar dhe aktualisht, dallimet mes tyre gjenden vetëm në çështje periferike, siç janë raporti me të kaluarën komuniste, trajtimi i shtresave sociale me bazë periudhën komuniste, si dhe sistemi i taksave. Në spektrin politik ka parti politike të vogla, të cilat kanë dallime dhe prioritete specifike, por pa ndikim thelbësor në axhendën politike të mazhorancave qeverisëse. Të tilla janë PBDNJ (parti me bazë minoritetin grek në Shqipëri), PDIU (parti me bazë komunitetin çam), PR (parti me bazë shtresat e ish pronarëve), etj.

Partia më e madhe politike në vend mbetet PS (Partia Socialiste). Ajo ka qeverisur vendin gjatë viteve 1991, 1997-2005 dhe 2013 e në vijim). PS u krijua më 1991 pas ndryshimit të emrit dhe programit të PPSH. Ajo është parti me bazë sociale, me qëndrime liberale ndaj të kaluarës komuniste, me mbështetje tek grupmoshat e mëdha dhe brezi i ri. PS është partia më e rëndësishme e të majtës në Shqipëri dhe partia me numrin më të lartë të anëtarësisë. Ajo ka zhvilluar dy procese të brendshme reformuese, fillimisht në fillim të viteve 90 për ndarjen nga PPSH dhe më vonë pas viteve 2005-2009 për reformimin programor dhe identitar të saj “përtej të majtës dhe të djathtës”. Figurat dominuese të saj janë ish kryetari Fatos

Nano (1991-2005) dhe kryetari e kryeministri aktual Edi Rama (2005 dhe në vijim). PS ka arritur të zgjedhë një President të Republikës (R.Meidani), një President konsensual (A.Moisiu), si dhe disa kryeministra (Nano, Ahmeti, Fino, Majko, Meta, Rama).

Partia e dytë më e madhe në vend është PD (Partia Demokratike). PD ka qeverisur vendin gjatë viteve 1992-1997 dhe 2005-2013. PD u krijua në dhjetor 1990 nga Lëvizja Studentore antikomuniste, ishte opozita e parë demokratike në vend, partia e parë me bazë qytetare, është parti e qendrës së djathtë, kritike ndaj të kaluarës komuniste dhe me mbështetje tek grupmoshat e mesme. PD është partia më e rëndësishme e të djathtës në Shqipëri dhe partia e vetme konkurreuese ndaj PS. Ajo ishte partia e parë me demokraci funksionale brenda saj (fillimi i viteve 90), proces që u ndalua në vitet pasuese për tu tentuar përsëri në zgjedhjet e reja 2013. Figura dominuese e saj është ish kryetari Sali Berisha (1991-2013), dhe aktualisht kryetari Lulzim Basha. PD ka arritur të zgjedhë tre Presidentë të Republikës (S. Berisha, B.Topi, B.Nishani), një President konsensual (A.Moisiu), si dhe dy kryeministra (Meksi dhe Berisha).

Partia e tretë relevante është LSI (Lëvizja Socialiste për Integrim) krijuar si fraksion nga PS më 2004 nga ish kryeministri Ilir Meta, i cili mbetet figura dominuese dhe simbol i saj. LSI është parti e spektrit të majtë, me organizim solid sidomos në disa qarqe. Në programin e saj nuk ka diferenca me PS. Megjithatë më 2009-2013 ajo hyri në bashkëqeverisje me PD dhe koalicion e djathtë, kurse nga 2013 është në bashkëqeverisje me PS dhe koalicionin e majtë. Suksesi i saj është kushtëzimi i shumicës dhe hyrja në qeveri me dy partitë e mëdha politike.

Partitë e treta politike përbëhen nga dy lloje partish: në fazën e parë të tranzicionit ishin partitë historike me bazë Luftën II Botërore, kryesisht e djathta nacionaliste (PLL, PBK, DBSH, etj), grupet e djathta e të majta liberale, PAD (e dalë nga PD) dhe PSD (e dalë nga PPSH), si dhe parti me orientim drejt komuniteteve/çështjeve të caktuara, si PBDNJ (parti me bazë minoriteti grek), (parti e djathtë republikane), PDK (parti demokristiane). Në dekadën e fundit vendin e partive të treta me bazë nacionaliste, ideologjike, etj, e kanë zënë parti të reja politike me bazë të caktuar komunitare e sociale. Aktualisht të tilla janë PDIU (parti e komunitetit çam), PAA (parti agrare), etj, ndërkohë që komunistet dhe nacionalistët nuk kanë më përfaqësim parlamentar dhe as lokal.

Krahas tyre ekzistojnë parti të tjera të shumta politike (11 parti të tjera kanë pasur edhe përfaqësim parlamentar në legjislatura të ndryshme midis

1991-2016), të cilat kanë dështuar të mbijetojnë për shkak të humbjes së identitetit, identifikimit me lider të veçantë politikë, mungesës së ofertës politike e elektorale, si dhe veprimi si shtojca të partive të mëdha politike. Legjislati shqiptar nuk ka krijuar mekanizëm verifikimi të aktivitetit të partive dhe shpalljes së pushimit të aktivitetit në rastet e kushteve të mosveprimit, gjë që ka çuar në rritjen fiktive të numrit të subjekteve ligjore elektorale dhe politike. Për shkak të sistemit politik e zgjedhor diskriminues ndaj prurjeve të reja politike, edhe partitë e reja të krijuara viteve të fundit, përballen me sfidën e mbijetesës dhe identitetit.

8. 3. Koalicionet politike në Shqipëri

Gjatë viteve 1991-2005 dy partitë e mëdha politike, PS dhe PD, kanë arritur të fitojnë të vetme mazhorancën qeverisëse. Në funksion të mazhorancës absolute ato kanë krijuar koalicione me parti të tjera aleate, kryesisht brenda spektrit politik. Në zgjedhjet 2005, 2009, 2013 partia fituese nuk mund të krijonte qeveri e vetme, ndaj koalicioni ishte jetik për mazhorancat. Rënia e mbështetjes për dy partitë e mëdha dhe shpërndarja e votave për partitë e treta është një tendencë e cila do të vijojë edhe në vitet e ardhshme, duke e shndërruar institucionin e koalicionit, në një dukuri politike të nevojshme dhe përcaktuese për mazhorancat qeverisëse.

Tipari kryesor i koalicioneve politike në Shqipëri është ndërtimi i tyre parazgjedhor, kalimi nga modeli i koalicioneve brenda spektrit politik me koalicione jashtë spektrit politik, marrëdhëniet e personalizuara për ndarje pushteti midis individëve drejtues të partive në koalicion, fragmentarizmi i ushtrimit të pushtetit mbi bazën e koalicionit, natyra joformale e aleancave, si dhe mungesa deri tani e modeleve të koalicionit para dhe post-zgjedhor mbi bazën e programit politik të shkruar dhe legjitim. Në nivel qendror nevoja për koalicion dhe përdorimi i tij nga partitë e mëdha për mandatin qeverisës dhe nga partitë aleate për mandate parlamentare ka çuar në humbjen e dukshme të identitetit dhe diferencave programore të partive, deri edhe në përfshirjen e politikanëve aleatë në listat shumë-emërore të partive të mëdha. Nga 2005 kalimi nga e majta drejt të djathtës në koalicion post-zgjedhor, dhe anasjelltas, u bë fenomen dominues, tendencë që pritet të vijojë masivisht edhe në të ardhmen.

Në qeverisjen lokale koalicionet kanë qenë më të gjëra dhe më specifike, në varësi nga sistemi zgjedhor dhe specifikat lokale. Votimi në mazhoritar për kryetarët e njësive vendore prej 24 vitesh ka qenë i dominuar nga

tendenca e koalicioneve të mëdha rreth kandidatëve të caktuar, si dhe kalimi nga një numër i madh kandidatësh në kryesisht dy kandidatë, nga dy koalicionet e mëdha. Në votën proporcionale vendore koalicionet kanë qenë përcaktuese dhe masive, në varësi nga interesat lokale dhe vota në mazhoritar për kandidatët nominalë.

8. 4. Ideologjitë e partive në Shqipëri

Partitë politike në Shqipëri në fillimet e tyre shfaqën kujdes për identifikim ideologjik. Brenda viteve 1991-1995 u krijuan parti socialiste, konservatore, liberale, nacionaliste, monarkiste, republikane, demokristiane, ekologjike, etj, duke pasuruar spektrin politik. Ato vendosen në programet e tyre politike përcaktimin ideologjik dhe, sidomos partitë e mëdha, PS e PD, promovuan teza dhe ide me përmbajtje ideologjike.

Pas dekadës së parë të tranzicionit identifikimi ideologjik e humbi rëndësinë e tij dhe prej 2005 partitë preferuan më shumë qasje pragmatiste sesa ideologjike në koalicione, në programe dhe në fushata elektorale. Në partitë parlamentare diferencat programore janë minimale, dhe se rendja pas pushtetit, pavarësisht shtresimit dhe traditës ideologjike, i ka bërë partitë gjithnjë e më të ngjashme, sidomos kur ato ushtrojnë pushtet. Kalimet e partive të vogla majtas e djathtas, kryesisht për interesa afatshkurtra, është tipar i dekadës së fundit dhe një tregues tjetër i paqëndrueshmërisë në identitet ideologjik. Agjendat e qeverive të majta dhe të djathta në opozitë kanë prirje identifikuese me shtresat identitare, por në qeverisje janë në tërësi të njëjta, dhe vetëm sigla, individët drejtues dhe ligjërimi politik i bën ato të duhen të ndryshme nga njëra tjetra.

Në përcaktimet e saj statusore¹ PD identifikohet si parti që *“ka hedhur themelet e të gjitha proceseve modernizuese post-komuniste: të drejtësisë, pronës, sipërmarrjes, lëvizjes së lirë, rilindjes përëndimore të Shqipërisë. Ne besojmë se mirëqenia, e drejta, liria dhe demokracia janë të mira publike për të gjithë. Ne besojmë se liria e qytetarëve, liria më e madhe në familje, në institucione, në sipërmarrje, në punë, në shkollë e kudo tjetër, është çelësi i suksesit tonë kombëtar”*. Sipas statutit PD² *“bashkon në gjirin e saj shtetasit shqiptarë që besojnë, respektojnë e mbrojnë lirinë, dinjitetin e personit, vlerat themelore të familjes në shoqëri, drejtësinë dhe shtetin ligjor, humanizimin e solidaritetin shoqëror. Ajo synon të promovojë në interes të Shqipërisë dhe*

1 Partia Demokratike: <http://www.pd.al/kush-jemi-2/>

2 Statuti i Partisë Demokratike, <http://www.pd.al/statuti/>

shqiptarëve, të drejtat qytetare dhe politike të tyre, zhvillimin e nismës së lirë e barazinë në shanse, tregun e lirë e konkurrencën si mjet të zhvillimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit, sigurinë e individit e të pronës, drejtësinë shoqërore e dialogun social, ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit, autoritetin e shtetit dhe vetëqeverisjen e lirë të komuniteteve lokale". Midis të tjerash ajo angazhohet "të garantojë të drejtën e pronës private, paprekshmërinë e saj dhe të drejtën e pronarëve për ta disponuar atë lirisht, trashëguar apo dëmshpërblyer me vlerë të plotë tregu; të zhdukë privilegjet dhe pabarazitë që nuk përlligjen as nga puna e prona, as nga talenti e as nga shërbimet e kryera ndaj vendit, si dhe të integrojë Shqipërinë si anëtare dinjitoze në Bashkimin Evropian".

Në përcaktimet programore PS angazhohet³ për promovimin e "vlerave e të interesave kombëtare, të parimeve të socialdemokracisë moderne dhe të konsolidimit të shtetit të së drejtës", "zhvillimin e pronës private si bazë e ekonomisë së tregut, shprehje e iniciativës së lirë të çdo individ, faktor kryesor për progresin ekonomik të vendit dhe të mirëqenies individuale". Ajo angazhohet gjithashtu për "mbështetjen e modernizimit të ekonomisë kombëtare, krijimin e një administrate publike qendrore dhe vendore të efektshme në shërbim të qytetarëve dhe konkretizimin e rolit të shtetit si forcë ekuilibruese në shoqëri, përgatitjen dhe mbështetjen e programeve të cilat sigurojnë realizimin e reformës ekonomike dhe sociale, të barazisë sociale të shprehur përmes barazisë së shanseve për të gjithë shtetasit dhe promovimit e afirmimit të vlerave njerëzore, përgatitjen dhe mbështetjen e programeve të mbrojtjes sociale për kategoritë shoqërore të pambrojtura dhe promovimin e solidaritetit njerëzor, promovimin e zhvillimit të arsimit, shkencës, kulturës, sporteve dhe të lirisë e harmonisë së besimeve fetare e të traditave të tyre, si kushte për progresin e përgjithshëm të vendit dhe pasurimin e vlerave shpirtërore të individit dhe të shoqërisë, mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të individit, respektimin e të drejtave themelore të individëve që u përkasin pakicave kombëtare apo grupeve të ndryshme shoqërore larg çdo lloj ekstremizmi, racizmi apo diskriminimi, mbështetjen e strategjisë së integritetit të plotë e përfundimtar të Shqipërisë në strukturat euroatlantike", etj.

Parti me natyrë ideologjike kanë mbetur partitë historike (Balli Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, Partia Komuniste, etj), disa parti me drejtues me formim ideologjik (socialdemokratë, socialistë, monarkistë, etj), si edhe disa parti përfaqësuese të komuniteteve të caktuara etnike (PBDNJ, MEGA, PAMIE) ose shoqërore (partitë me bazë ish të përndjekur politikë gjatë diktaturës, partitë e veteranëve, etj). Sistemi zgjedhor konkurrues dhe

³ Rregullore e Partisë Socialiste, <http://ps.al/new/familja-jone/rregullore/>

nevoja për vota nga çdo burim i mundshëm ligjor, ia ka shtyrë partitë të kërkojnë vota tej votuesve ideologjikë dhe të jenë pragmatiste në varësi nga ofertat për koalicion në qeverisjen qendrore dhe lokale. Elementët ideologjikë shfaqen kryesisht në debatet mbi çështje të së kaluarës në periudhën komuniste dhe zhvillimet politike gjatë Luftës II Botërore, edhe këto, kryesisht për interesa elektorale.

8. 5. Demokracia brenda-partive në partitë shqiptare

Kushtetuta e Shqipërisë (neni 9) dhe ligji “Për partitë politike” përcakton norma e parime demokratike të organizimit. Sipas nenit 7 të ligjit⁴, një parti ndalohet të regjistrohet kur *“organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t’u zgjedhur”*. Parimet ligjore gjejnë zbatim edhe në dokumentet kryesore të partive (program, statut, rregullore), por në zbatimin praktik, demokracia e brendshme partiake mbetet po aq e brishtë sa demokracia në tërësi në shoqërinë shqiptare.

Në fillim të viteve ‘90 partitë treguan kujdes të veçantë për vendosjen e standardeve demokratike të organizimit, konkurrencës së brendshme dhe vendimmarrjes përfshirëse me natyrë kolektive. Fillimisht partitë e mëdha toleruan ekzistencën e fraksioneve dhe debatet e brendshme imponuan edhe debate publike mbi ngjarjet brenda partive politike. Në fillimet e partive dhe në fundin e dekadës së parë të tranzicionit partitë e mëdha përjetuan konkurrencë të fortë brenda tyre në nivel lokal e qendror, ku u sfiduan përmes votës edhe kryetarët historikë të tyre. Pjesë e debatit dhe vendimmarrjes së shumicës ishin edhe aktet më të rëndësishme politike, programet, rregullat e funksionimit, etj.

Pas viteve 2000 partitë morën gjithnjë e më shumë formë të personalizuar me liderin politik, vendimmarrja u përqendruar në lidhshëm qendror dhe nuk pati më tolerancë ndaj grupeve apo zërave të brendshëm kritikë. Pas viteve 2005-2009 sistemi i funksionimit të brendshëm i partive politike është bërë në tërësi vertikal dhe nominal, një formë presidencializmi brenda partive, ku kryetarët gëzojnë pushtet absolut dhe kanë rol thelbësor në përcaktimin e listës për kandidatët për deputetë, emërimin e

⁴ Ligj nr.8580, datë 17.2.2000, Ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011 ligjin nr. 17/2014, date 20.2.2014 ligjin nr. 25/2014, datë 25.9.2014 “Për partitë politike”.

ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të lartë, si dhe preferencat për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive dhe drejtuesve politikë lokalë.

Shembujt janë të shumtë: gjatë viteve 2009-2013 PD në qeveri nuk zhvilloi as formalisht mbledhje të strukturave drejtuese kombëtare dhe nuk pati kuvend kombëtar periodik zgjedhor. Gjatë viteve 2009-2015 as PS nuk zhvilloi zgjedhje të rregullta për postin e kryetarit dhe ekipit drejtues, madje më 2016 ajo zhvilloi një referendum në anëtarësi për të mos votuar sipas statusit kryetarin kur ai është kryeministër. Gjithashtu, edhe LSI, parti relativisht e re politike (2004) vijon të ketë të njëjtin kryetar me më shumë se katër mandate, pa pasur zgjedhje reale konkurruese.

Secila nga palët, PD, PS, LSI, etj, ndërkohë kanë përjashtuar ose mënjanuar nga postet dhe karriera politike individët brenda tyre kritikë ndaj kryetarit të partisë. Nga 126 parti politike vetëm në një rast ka ndodhur që përmes votimit të jetë kryer rotacion në krye të një partie, (PLL), edhe ai, një rast i kontestuar prej të vetmit kryetar humbës në garë. Të gjitha partitë parlamentare në 26 vite kanë pasur përjashtime të kritikëve të tyre dhe më tej, ndarje në më shumë se dy fraksione – parti të reja, duke fragmentarizuar dhe formalizuar sistemin politik e partiak në vend.

Tendenca e personalizimit të partive dhe kontrollit personal mbetet dominuese dhe pengesë thelbësore për demokratizimin dhe modernizimin e partive politike. Mungesa e demokracisë së brendshme dhe konkurrencës mbi meritën i ka bërë partitë më të mbyllura ndaj prurjeve të reja cilësore, më pak të votuara dhe më të ngjashme në perceptimin publik. Lindja e partive të reja politike kryesisht në shenjë proteste për mungesën e demokracisë së brendshme në partitë e mëdha politike, përbën vetëm një prej pasojave të kësaj gjendjeje. Demokracia e brishtë brenda partive i ka privuar ato nga funksioni edukues demokratik në shoqëri dhe ka penguar reformat cilësore për forcimin e shtetit së drejtës, krijimit të administratës së pavarur publike, si dhe rritjes së nivelit të kulturës politike.

8. 6. Organizimi i brendshëm i partive shqiptare

Sistemi organizativ i partive politike shqiptare është uniform dhe i trashëguar nga modeli i PPSH: shtrirje kombëtare mbi bazë komuniteti, njësisht vendore, profesioni dhe moshe. Partitë kanë pasur ndryshime eksperimentale të njëjta në ndarjen e përgjegjësive midis kryetarit – kryesisë – asamblesë- grupit parlamentar.

Gjithsesi, skema organizative mbetet klasike: organizim në bazë seksioni, më tej në bazë grup seksioni, në bazë bashkie, dhe në bazë kombëtare (kryesi, sekretariat, Asamble Kombëtare/Këshill Drejtues/Këshill Kombëtar). Secila parti ka edhe organizatë të gruas dhe të rinisë, partitë e mëdha kanë edhe gazeta zyrtare partiake (PS, PD, LSI), secila ka fondacione partiake, ka institute mbështetëse, akademik politike dhe rrjet të drejtuesve në pushtetin vendor.

Nuk ka asnjë rast të vetëm kur vendime të rëndësishme politike (aleanca parazgjedhore, koalicion pas-zgjedhore, ndryshim programesh politike, zgjedhje konkurruese të kandidatëve, etj) janë marrë përmes votimit të anëtarësisë. Strukturat organizative mbeten pa rol vendimmarrës dhe më shumë me funksion mobilizues për aktivitetet politike dhe elektorale të partisë dhe sidomos kryetarit të saj.

8. 7. Perspektiva të ardhshme e partive shqiptare

Sistemi partiak në Shqipëri ndodhet edhe në fazën e tranzicionit nga modeli eksperimental drejt një modeli të konsoliduar dhe stabil. Sistemi zgjedhor proporcional dhe rënia e mbështetjes për partitë e mëdha, ka kushtëzuar krijimin e mazhorancave parlamentare vetëm përmes koalicioneve politike. Kjo situatë e re, në kontrast me numrin e votave, u jep më shumë hapësirë veprimi partive të treta politike, të cilat janë dhe do të jenë akoma më shumë përcaktuese për mazhorancat dhe vendimmarrjet e rëndësishme politike.

Modeli i partive “të ngjashme” në program dhe ushtrim të qeverisjes nuk mund të jetë i përhershëm. Për një kohë të gjatë nuk pritet të ketë një forcë të re konkurruese reale ndaj dy partive të mëdha politike, dhe as lëvizje të mëdha që të mund të rrezojnë sistemin dominues dypartiak në vend. Por nevoja për alternative konkurruese dhe zhgënjimi ndaj sistemit aktual partiak do të ketë ndikim afatgjatë tek vetë partitë e mëdha për t’i detyruar ato të reformohen në program dhe identitet politik.

Skena politike shqiptare pritet që në vitet e ardhshme të pasurohet më shumë me parti të vogla me profil komunitar apo etnik, të partive me natyrë fetare dhe nacionaliste, të grupeve të reja populiste dhe atyre liberale. Trendi nacionalist dhe i partive qytetare, përfaqësuar aktualisht nga PDIU e AKZ nga njëra anë dhe partive të reja "Sfida", "Libra" e FRD nga ana tjetër, do të forcohet në vitet e ardhshme, kryesisht me bazë votuesit e rinj dhe ata të papërfaqësuar. Shqipëria nuk ka ende një parti anti-BE, por me siguri, do të ketë lëvizje edhe në këtë drejtim në të ardhmen.

Sistemi i partive të patronazhit dhe partive klienteliste, i forcuar gjatë dekadës së fundit, gjithashtu mbetet një tipar afatshkurtër i sistemit partiak shqiptar. Në të ardhmen partitë do jenë nën presion të jashtëm (nga shoqëria, votuesit, institucionet), për të kufizuar pushtetin e tyre dominues në shtet e shoqëri, si dhe nën presion të brendshëm për tu reformuar dhe për të krijuar alternativa të votuesve për ushtrim pushteti.

Zgjerimi i të drejtës së votës duke përfshirë shtetasit shqiptarë që jetojnë në vende të tjera (numri i shtetasve me të drejtë vote brenda dhe jashtë vendit është përafërsisht i njëjtë) do ketë ndikimin e vet mbi sistemin aktual partiak dhe mënyrën vertikale dhe të personalizuar të organizimit të partive politike. Pjesëmarrja e tyre aktive në zgjedhje mund të përshpejtojë procesin reformues brenda partive dhe ta pasurojë spektrin politik.

Reformimi i legjisllacionit mbi partitë politike dhe legjisllacionit zgjedhor do të ketë ndikim të fortë në ndryshimin e gjendjes brenda partive dhe ndërveprimin midis tyre, në kufizimin e burimeve informale të financimit dhe rritjen e standardeve të demokracisë funksionale dhe llogaridhënies. Aplikimi i sistemit të primareve dhe konsultimit të anëtarësisë në vendimmarrje të rëndësishme janë reforma thelbësore për hapjen e partive dhe rritjen e betimit publik tek sistemit përfaqësues.

Procesi i reformimit dhe modernizimit të partive politike reflekton procesin e reformimit dhe modernizimit të shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Janë procese paralele që ndikohen dhe që nuk mund të veprojnë veças. Partitë dhe elitat politike kanë përgjegjësinë të mos lejojnë që, me standardet e tyre minimale të funksionimit dhe me oferta të pamjaftueshme politike për zgjedhësit, të vijojnë të sjellin zhgënjim të qytetarëve tek sistemi pluralist dhe demokratik. Qytetarët shqiptarë kanë nevojë për një demokraci funksionale, standarde të larta dhe një model të shtetit të së drejtës të krahasueshëm me vendet e BE, - diçka që nuk e kanë pasur në 104 vitet e historisë politike dhe që përbën misionin, përgjegjësinë dhe sprovën më të madhe të elitave politike të sotme e të nesërme. Partitë politike kanë dhe do të kenë aty një rol thelbësor.

Shënimet

9.

1 Anthony Downs, *An Economic Theory of Democracy* (New York: Harper & Brothers, 1957), 25.

2 Cf. për shembull, Russell J. Dalton dhe Martin P. Wattenberg, "Unthinkable Democracy: Political Change in Advanced Industrial Democracies", në *Parties without Partisans: Political Change in Advanced Industrial Democracies*, eds. Russell J. Dalton and Martin P. Wattenberg (Oxford and New York: Oxford University Press, v000), 3-18.

3 Me më shumë detaje cf. Arend Lijphart, *Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries* (New Haven and London: Yale University Press, 1999), Kapitulli 5.

4 Francis Fukuyama, *The End of History and the Last Man* (New York: Harper Perennial, 1992).

5 Figure based on Peter Lösche, *Parteiensystem der Bundesrepublik Deutschland* (Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 2006), 27.

6 Gerd Langguth, *Machtmenschen*. München: Deutscher Taschenbuch-Verlag (2009) 483ff.

7 Otfried Jarren dhe Patrick Donges, *Politische Kommunikation in der Mediengesellschaft: Eine Einführung* (Wiesbaden: Verlag für Sozialwissenschaften 2. überarbeitete Auflage, 2006), S. 236.

8 Karl-Rudolf Korte dhe Manuel Fröhlich, *Politik und Regieren in Deutschland* (Paderborn: Schöningh, 2. Aufl., 2006), S. 188.

9 Hans Mathias Kepplinger dhe Marcus Maurer *Abschied vom rationalen Wähler: Warum Wahlen im Fernsehen entschieden werden* (Freiburg/München: Verlag Karl Alber, 2005), S. 188.

10 Robert Michels, *Zur Soziologie des Parteiwesens in der modernen Demokratie* (Stuttgart: Kröner, 1911/1989).

11 Lidhur me këtë Konrad-Adenauer-Foundation ka mbledhur disa informacione në një doracak: KAS (Hrsg.), *Handbuch Politische Kommunikation*, (Beograd, 2006).

12 Për lexim shitesë mbi çështjen e marrëdhënieve në mes të partive politike dhe grupeve të interesit, shih : Arend Lijphart, *Patterns of Democracy. Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries* (New Haven and London: Yale University Press, 1999) and Ulrich U.A.

Alemann, Interessenverbände. Informationen zur Politischen Bildung (Heft 253) (Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 1996).

13 Wolfgang Jäger, Fernsehen und Demokratie. Scheinplebiszitäre Tendenzen und Repräsentation in den USA, Großbritannien, Frankreich und Deutschland (München, 1992), S. 81

14 Karl-Rudolf Korte, "Wie Parteien auf komplexe Wählermärkte reagieren", in Blätter für deutsche und internationale Politik 6/2000, S. 707-716.

15 Politika si profesion, http://www.ne.jp/asahi/moriyuki/abukuma/weber/lecture/politics_vocation.html

16 Richard Stengel, "Mandela: His 8 Lessons of Leadership", Time Magazine, July 9, 2008, <http://www.time.com/time/world/article/0,8599,1821467,00.html>

17 Lista e tetë prej njëmbëdhjetë kriterëve është e cituar pjesërisht fjalë për fjalë tek Hans Joachim Veen, "Die Bedeutung politischer Parteien für Demokratie und Demokratisierung" ["The significance of political parties for democracy and democratization"] in Parteien und Demokratie: Beiträge der Internationalen Fachkonferenz zum KAS-Demokratiereport edited by Gerhard Wahlers and Karsten Grabow (Berlin-Sankt Augustin: Konrad-AdenauerStiftung), 33f

REFERENCAT

Alemann, Ulrich u.a.. Interessenverbände. Informationen zur Politischen Bildung (Heft 253). Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 1996.

Dahl, Robert. Polyarchy: Participation and Opposition. New Haven, 1971.

Dalton, Russell J. dhe Martin P. Wattenberg. "Unthinkable Democracy: Political Change in Advanced Industrial Democracies". In Parties without Partisans: Political Change in Advanced Industrial Democracies, botuar nga Russell J. Dalton dhe Martin P. Wattenberg. Oxford and New York: Oxford University Press, 2000.

Downs, Anthony. An Economic Theory of Democracy. New York: Harper & Brothers, 1957.

Finer, Herman. The Theory and Practice of Modern Government. Westport: Greenwood Press, 1950/1970.

Fukuyama, Francis. The End of History and the Last Man. New York: Harper Perennial, 1992.

Heywood, Andrew. Politics. Houndmills: Palgrave Macmillan, 2002.

Jäger, Wolfgang. Fernsehen und Demokratie: Scheinplebiszitäre Tendenzen und Repräsentation in den USA, Großbritannien, Frankreich und Deutschland. München: Beck, 1992.

Jarren, Otfried dhe Patrick Donges. Politische Kommunikation in der Mediengesellschaft: Eine Einführung. 2nd edition. Wiesbaden: VS-Verlag für Sozialwissenschaften, 2006.

Kepplinger, Hans Mathias dhe Marcus Maurer. Abschied vom rationalen Wähler: Warum Wahlen im Fernsehen entschieden werden. Freiburg/München: Verlag Karl Alber, 2005.

Konrad-Adenauer-Stiftung, ed. Handbuch Politische Kommunikation. Beograd, Berlin dhe kudo tjetër, 2006 (e disponueshme në gjuhën Gjermane, Angleze, Shqipe dhe gjuhë të tjera).

Karl-Rudolf Korte. "Wie Parteien auf komplexe Wählermärkte reagieren". In Blätter für deutsche und internationale Politik 6/2000, pp. 707-716.

Korte, Karl-Rudolf dhe Manuel Fröhlich. Politik und Regieren in Deutschland. Paderborn: Schöningh, 2006.

Langguth, Gerd. Machtmenschen. München: Deutscher Taschenbuch-Verlag, 2009.

Lijphart, Arend. Patterns of Democracy. Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries. New Haven dhe Londër: Yale University Press, 1999.

Lösche, Peter. Parteiensystem der Bundesrepublik Deutschland. Bonn: Bundeszentrale für politische Bildung, 2006.

Michels, Robert. Zur Soziologie des Parteiwesens in der modernen Demokratie. Stuttgart: Kröner, 1911/1989.

Müller, Wolfgang C. dhe Kaare Strøm, eds. Policy, Office or Votes? How Political Parties in Western Europe Make Hard Decisions. Cambridge: Cambridge University Press, 1999.

Olson, Mancur. Aufstieg und Niedergang von Nationen: Ökonomisches Wachstum, Stagflation und soziale Starrheit. Tübingen: Mohr Siebeck, 2. Aufl, 2004.

Sartori, Giovanni. Parties and Party Systems. A Framework for Analysis. Cambridge: Cambridge University Press, 1976.

Stengel, Richard. "Mandela: His 8 Lessons of Leadership". In Time Magazine, July 9, 2008.

Strøm, Kaare. "A Behavioral Theory of Competitive Political Parties". In American Journal of Political Science, Vol. 34, No. 2, 1990. pp. 565-598.

Veen, Hans-Joachim. "Die Bedeutung politischer Parteien für Demokratie und Demokratisierung". In Parteien und Demokratie: Beiträge der Internationalen Fachkonferenz zum KAS-Demokratiereport, edited by Gerhard Wahlers and Karsten Grabow, 25-36. Berlin/Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2007.

Weber, Max (1988). "Politik als Beruf", In ders.: Gesammelte Politische Schriften, edited by Johannes Winkelmann), 5th edition. Tübingen: Mohr, 1988.

LEXIMETË TJERA (PËRZGJEDHJE)

Beyme, Klaus von. *Parteien im Wandel: Von den Volksparteien zu den professionalisierten*

Wählerparteien. Wiesbaden: Westdeutscher Verlag, 2000.

Diamond, Larry J. and Richard Gunther, eds. *Political parties and democracy*. Baltimore: The Johns Hopkins University Press, 2001.

Duverger, Maurice. *Les Partis Politiques*. Paris: Armand Colin, 1951.

Grabow, Karsten and Gerhard Wahlers, eds. *Parteien und Demokratie*. Berlin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2007.

Grabow, Karsten and Patrick Köllner, eds. *Parteien und ihre Wähler. Gesellschaftliche Konfliktlinien und Wählermobilisierung im internationalen Vergleich*. Berlin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2008.

Katz, Richard S. and Peter Mair. "The Evolution of Party Organizations in Europe: The Three Faces of Party Organization". In *The American Review of Politics*, 14, pp. 593-617. 1993.

Katz, Richard S. und Peter Mair. "Changing Models of Party Organization and Party Democracy. The Emergence of the Cartel Party". In *Party Politics*, Vol. 1, No. 1, pp. 5-28. 1995.

Kirchheimer, Otto (1966). "The Transformation of the Western European Party Systems". In *Political Parties and Political Development*, edited by Joseph LaPalombara and Myron Weiner, 177-200. Princeton: Princeton University Press, 1966.

Kitschelt, Herbert. *The Logics of Party Formation. Ecological Politics in Belgium and West Germany*. Ithaca: Cornell University Press, 1989.

Kitschelt, Herbert et al.. *Latin American Party Systems*. Cambridge: Cambridge University Press, 2010.

Konrad-Adenauer-Stiftung. *Parties and Democracy. The KAS Democracy Report 2007*. Bonn: Bouvier, 2007.

Konrad-Adenauer-Stiftung. Parteien und Parteienkooperationen der KAS in Lateinamerika. Berlin/Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2008.

Konrad-Adenauer-Stiftung. Parties and Democracy, Vol. II. The KAS Democracy Report 2009. Berlin/Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2009.

Konrad-Adenauer-Stiftung. Parteiendialoge und -kooperationen der KAS in Asien. Berlin/Sankt Augustin: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2010.

Liang Fook Lye and Wilhelm Hofmeister, eds. Political Parties, Party Systems and Democratisation in East Asia. Singapore: World Scientific Publishing, 2010.

Mainwaring, Scott and Timothy R. Scully, eds. Building Democratic Institutions: Party Systems in Latin America. Stanford: Stanford University Press, 1995.

Mair, Peter, ed. The West European Party System. Oxford: Oxford University Press, 1990.

Merkel Wolfgang und Eberhard Sandschneider, eds. Systemwechsel 3: Parteien im Transformationsprozeß. Opladen: Leske & Budrich, 1997.

Panbianco, Angelo. Political Parties. Organization and Power. Cambridge: Cambridge University Press, 1988.

Webb, Paul D., David M. Farrell and Ian Holliday, eds. Political parties in advanced industrial democracies. Oxford: Oxford University Press, 2002.

Weissenbach, Kristina. Political Parties and Party Types. Conceptual Approaches to the Institutionalization of Political Parties in Transitional States: Case of the Philippines. Manila: Konrad-Adenauer-Stiftung, 2011. Available at: <http://www.kas.de/philippinen/en/publications/21710/>.

AUTORËT

Dr. Wilhelm Hofmeister është drejtor i projektit rajonal “ Dialogu Politik me Azinë” i Konrad Adenauer Stiftung (KAS), i vendosur në Singapor. Ai ka qenë përfaqësues i KAS-it në Kili, zëvendës drejtor i departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në selinë e saj, dhe nga viti 1999 deri më 2009, ai ishte drejtor i Qendër së Hulumtimeve KAS në Rio de Zhaniero, Brazil.

Kontakt: Wilhelm.Hofmeister@kas.de.

Dr. habil. Karsten Grabow është koordinator për studime politike dhe hulumtime të partive në ekipin e politikave të brendshme në KAS në Berlin. Deri në fund të vitit 2010 ai ishte hulumtues i lartë në departamentin për Bashkëpunim Evropian dhe Ndërkombëtar (BEN) dhe përgjegjës për bashkëpunim ndërkombëtar partiak të KAS-it.

Kontakt: Karsten.Grabow@kas.de.